



ISSN 2309 3455

Social Studies

Studime Sociale

Vol. 18, No. 3 (67), 2024



- Ledian RUSTA • Juljan MYFTARI • Valmora GOGO
• Ermal SPAHIU • Edlira BEJKO
• Florian ÇULLHAJ • Nadia GUNI • Pjereta AGALLIU
• Lindita CIPA • Klajdi LOGU
• Doreta KUÇI (TARTARI) • Alban TUFA
• Fatbardha BUSHI • Gentian DUKA
• Murat ALIU • Max CHARNEY

www.sociology.al



ALBANIAN
INSTITUTE OF
SOCIOLOGY

“Social Studies” Journal is classified ‘Scientific’ by ANVUR

The journal “Social Studies” is classified as Scientific Journal by ANVUR, the National Agency for the Evaluation of the University System and Scientific Research of Italy - Ministry of Education, Universities and Scientific Research of Italy (MIUR), by decision no. 298, dated 21 December 2021.

The application was made in 2020 by Romina GURASHI (PhD) - from “Sapienza” University of Rome, Deputy Editor of the journal “Social Studies”.

Since 2020, ANVUR has monitored the journal “Social Studies” with international experts, and the official response has been returned by Dott. Marco Malgarini, director of ANVUR, on 19 January 2022.

La rivista “Studi Sociali” è classificata ‘Scientifica’ dall’ANVUR

La rivista “Social Studies” è classificata ‘scientifica’ dall’ANVUR, Agenzia Nazionale per la Valutazione del Sistema Universitario e della Ricerca Scientifica d’Italia - Ministero dell’Istruzione, dell’Università e della Ricerca Scientifica d’Italia (MIUR), con decisione n. 298, del 21 dicembre 2021.

La richiesta è stata presentata nel anno 2020 da Romina GURASHI (PhD), dell’Università La Sapienza, Vicedirettore della rivista “Studi Sociali”.

Dal 2020 ANVUR segue con esperti internazionali la rivista “Social Studies” e la risposta ufficiale è stata data dal Dott. Marco Malgarini, il Dirigente Area Ricerca ANVUR, il 19 gennaio 2022.

Revista “Studime Sociale” klasifikohet si revistë shkencore nga ANVUR

Revista “Studime Sociale” është klasifikuar si revistë shkencore nga ANVUR, Agjencia Kombëtare e Vlerësimit të Sistemit Universitar dhe Kërkimit Shkencor të Italisë - Ministria e Arsimit, Universiteteve dhe Kërkimit Shkencor (MIUR), me vendim no. 298, datë 21 dhjetor 2021.

Aplikimi është bërë në vitin 2022 nga Romina GURASHI (PhD), Universiteti La Sapienza Romë, njëherësh Deputy Editor e revistës “Studime Sociale”.

Nga viti 2020, ANVUR ka monitoruar me ekspertë ndërkombëtarë revistën “Studime Sociale” dhe përgjigja zyrtare është kthyer nga Dott. Marco Malgarini, drejtor i ANVUR, më 19 janar 2022.

SOCIAL STUDIES [STUDIME SOCIALE]

Vol. 18, No. 3 (67), 2024

Editorial Team

Editor:

Leke SOKOLI – Tirana, ALBANIA

Deputy Editors:

Sejdin CEKANI – Tirana, ALBANIA

Besim GOLLOPANI – Pristine, KOSOVO

Ali PAJAZITI – Skopje, North MACEDONIA

Romina GURASHI – Roma, ITALY

Deputy Editor for Management, Membership and Finance:

Elda SOKOLI KUTROLI

International Editorial Board

Servet PËLLUMBI – Chair, Albanian Institute of Sociology, ALBANIA

Aida GOGA – University of Tirana, ALBANIA

Agri SOKOLI – St. Louis International School Milan, ITALY

Apostolos G. PAPADOPOULOS – Harokopio University, GREECE

Besnik PULA – Center for the Study of Social Organization; Princeton University, USA

Blerina XHAKOLLI REÇI – University Aleksander Moisiu Durres, ALBANIA

Borut RONČEVIĆ – University of Ljubljana, SLOVENIA

Brunilda ZENELAGA – University of Tirana, ALBANIA

Doreta KUÇI – University Aleksander Moisiu Durres, ALBANIA

Enis SULSTAROVA – University of Tirana, ALBANIA

Erenestina GJERGJI HALILI – University of Tirana, ALBANIA

Ferdi KAMBERI – University Fehmi Agani of Gjakova, KOSOVO

Goran BASIC – Department of Sociology, Lund University, SWEDEN

Irena NIKAJ – Universiteti Fan Noli of Korca, ALBANIA

Jasminka LAŽNJAK – University of Zagreb, CROATIA

Jola KEPI – Center for School Leadership, CSL-AADE, ALBANIA

Jonida LAMAJ – Albanian-American Development Foundation, ALBANIA

Klea FANIKO – University of Geneva, SWITZERLAND

Klejda MULAJ – University of Exeter, ENGLAND
Konstantin MINOSKI – Ss. Cyril and Methodius University in Skopje, North MACEDONIA
Kseanela SOTIROFSKI – University Aleksander Moisiu Durrës, ALBANIA
Ledia KASHAHU – University Aleksander Moisiu of Durrës, ALBANIA
Monika HASANI - University Ismail QEMALI of Vlora, ALBANIA
Pjereta AGALLIU - University of Tirana, ALBANIA
Rando DEVOLE – Researcher AIS Roma, ITALY
Sergiu BALTATESCU – University of Oradea, ROMANIA
Shaban SINANI – Albanian Academy of Science, ALBANIA
Shkëlzen HASANAJ – University of Siena, ITALY
Svetla KOLEVEA – Institute for the Study of Societies and Knowledge, BULGARIA
Tonin GJURAJ – European University of Tirana, ALBANIA
Venera LLUNJI – AAB College, KOSOVO

© Albanian Institute of Sociology / Instituti Shqiptar i Sociologjisë

Design: **Orest Muça**

“Social Studies”, Scientific Journal, certified by the Highest Scientific Committee, Ministry of Education and Science of Albania

Decision no. 170, date 20th of December 2010

Contacts:

Mobile: ++355692044722; ++355694067682

E-Mail: albsa@sociology.al; studime.sociale@gmail.com

www.sociology.al

Contents:

Ledian RUSTA	<i>Tautologjia e sistemit social nën pushtetin e virtualitetit semiotik në mendimin e Baudrillard.....</i>	5
Juljan MYFTARI	<i>Ideologjia e majtë dhe kufijtë e dialektikës</i>	13
Valmora GOGO Ermal SPAHIU	<i>Podkasti dhe karakteristikat e reja multimediale në Shqipëri</i>	21
Edlira BEJKO	<i>Gjenerata e dytë e emigracionit dhe perspektivat e reja edukuese.....</i>	31
Florian ÇULLHAJ	<i>Authoritarianism and Democratization in Albania: The Role of Social Movements</i>	43
Nadia GUNI Pjereta AGALLIU	<i>Evolution of a healthy environment from a social right to a fundamental right.....</i>	53
Lindita CIPA Klajdi LOGU	<i>The Role of Physiotherapy in Social Role Reinstatement: How Physical Recovery Influences Reintegration into Social Life.....</i>	61
Doreta KUÇI (TARTARI)	<i>The Importance and Role of Social Workers in Educational Institutions</i>	69
Florian ÇULLHAJ	<i>State Mobilization and Media Control in Albania: A Study of Hybrid Regime Protest Dynamics</i>	77
Valmora GOGO Alban TUFA Fatbardha BUSHI Gentian DUKA	<i>Memet në mediat sociale dhe efekti i tyre mbi audiencat në Shqipëri</i>	85
Murat ALIU	<i>Orientalizmi dhe ballkanizmi: Ballkani si tjetërsi fetare e Evropës dhe auto-orientalizmi shqiptar.....</i>	95
Max CHARNEY	<i>Vaccination Patterns: Can Flu Testing Nudge COVID-19 Vaccine Behavior?.....</i>	113

TAUTOLOGJIA E SISTEMIT SOCIAL NËN PUSHTETIN E VIRTUALITETIT SEMIOTIK NË MENDIMIN E BAUDRILLARD

Ledian RUSTA
Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Shkencave Sociale
Email: ledianrusta@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Krahas konsideratave të ndryshme filozofike, ndryshimi i politikës dhe realitetit të shoqërisë nuk shërben thjeshtë si vektor për të prodhuar një kritikë të re por edhe për të skicuar epistemikisht një metakritikë. Në këtë gjurmë, mendimi i Baudrillard vjen si një thyerje radikale ndaj kritikave klasike të sistemit të socialës dhe politikës. Sipas tij, realiteti i sotëm dëshmon për një mbyllje pa kthim të kritikave ekzistuese të socialës. Ontologjikisht realiteti ka ndryshuar natyrën energjitime, entropinë sistemike, trajtën dhe parimet e shfaqjes së tij nën gjurmën e shenjave dhe virtualitetit. I gjithë realiteti dhe trupi social është kthyer në sistem shenjash virtuale që riprodhohen pafundësisht dhe paracaktohen nga sistemi sipas një parimi tautologjik: riprodhimi i pafundëm i së njëjtës. Sistemi i sotëm është bërë vetadresues duke mos prodhuar dallime dhe kontradikta reale për t'i dhënë zgjidhje. Simulakri apo vektori i realitetit social është ai i virtualitetit dhe simulacionit, i ndërtuar në formë abstrakte dhe formale, ku çdo dallim dhe individualitet shfaqet si iluzor dhe i parafabrikuar. Në këtë kuptim, shpresa për një revolucion social duket e pakuptimtë dhe e pamundur.

Fjalët kyçe: *simulacion, kod, masë, shenjë, virtualitet, tautologji.*

Dr. **Ledian RUSTA** është lektor në Departamentin e Filozofisë në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Ai ka marrë pjesë në shumë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ka botuar artikuj në revista kombëtare dhe ndërkombëtare me faktor impakti. Fushat e tij të interesit janë filozofia dhe komunikimi. Është autor i monografisë “Kështu foli Nietzsche”.

Fazat e zhvillimit të shoqërisë përmes simulakrit

Në këndvështrimin e mendimit të Baudrillard, i gjithë zhvillimi i shoqërisë njerëzore që zë fill që Rilindja europiane, mund të klasifikohet dhe hierarkizohet në tre faza që shquhen nga një veçori mbizotëruese. Kjo veçori cilësohet si simulakër, koncept që vlen mbi historinë dhe shprehet si një arketip që karakterizon një fazë të caktuar të zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Në thelb, simulakra është diçka që zëvendëson realitetin me paraqitjen e tij dhe në çdo fazë të caktuar të shoqërisë njerëzore duhet kuptuar përmbajtja dhe logjika e shfaqjes së kësaj paraqitje (përfaqësimi). Sipas Baudrillard, tre rendet e shfaqjes, përbri ndryshimeve të ligjit të vlerës, kanë pasuar njëra-tjetrën që nga Rilindja: -Kundërfabrikimi përbën skemën sunduese të periudhës “klasike”, nga Rilindja tek revolucioni industrial...bazuar në ligjin natyror të vlerës; - Prodhimi përbën skemën sunduese të epokës industriale... [bazuar] në ligjin tregëtar të vlerës; - Simulimi përbën skemën mbretëruese të fazës së tanishme që kontrollohet nga kodi...[bazuar] në ligjin strukturor të vlerës (Baudrillard, 1983a).

Në shekujt e parë të epokës moderne, shoqëria karakterizohej nga mbizotërimi i kapitalit në formën e tij tregëtare por vlera e përdorimit të një produkti ende nuk kishte fituar ende terren kundrejt vlerës së shkëmbimit të tij. Në këtë fazë, simulakra që mbizotëronte ishte kundërfabrikimi. I gjithë realiteti shoqëror por edhe ai artistik, nga vitet ‘500 e më pas, shfaq përpjekjet për të imituar natyrën në të gjitha fushat e prodhimit material dhe shkencor.

Më pas vjen simulakri i dytë, ai i prodhimit, që lidhet ngushtësisht me revolucionin industrial. Realiteti social përqëndrohet në proceset sociale me karakter prodhues të bazuar tek energjia, në përpjekje për tu konkretizuar ose materializuar përmes makinerive në sistemin prodhues

të produkteve materiale. Me ardhjen e këtij simulakri të ri, ndryshojnë vlerat e drejtimit socio-ekonomik, ato të komunikimit dhe mënyrës së të menduarit e të vepruarit në përgjithësi. Lindin marrëdhënie të reja sociale, objekte të rinj dhe shenja të reja që e kanë origjinën e tyre nga teknika. Në këtë fazë, raporti mes objekteve nuk është ai mes origjinal/falsifikimit pasi gjithçka prodhohet në një varg serial të pandërprerë në nivel industrial. Simptomë e kësaj situate janë kritikrat e adresuara nga Shkolla e Frankfurtit lidhur me kthimin në industri të riprodhimit të veprave të artit. Në këtë fazë të shoqërisë, vlera e shkëmbimit nis të fitojë përherë e më tepër terren mbi vlerën e përdorimit dhe procesi i mallëzimit të realitetit nis të zhvillohet. Në epokën e prodhimit në seri të objekteve nuk ekziston asnjë dallim mes tyre pasi teknika bën të mundur riprodhimin e tyre në masë. I tërë prodhimi material hyn në sferën e riprodhimit e kështu prodhimi humb çdo kuptim: nuk ekziston asnjë qëllim social pasi gjithçka humb në riprodhimin seri. Por në këtë zhvillim të vrullshëm, stadi i prodhimit industrial, i punës së mekanizuar dhe zinxhirit të prodhimit shfaqet kalimtar e fluturak dhe shumë shpejt i lë vendin një simulakri të ri pasi çdo rend i nënshtrohet rendit të mëparshëm. Ashtu si rendi i falsifikimit u mbërtheje nga ai i prodhimit në seri, kështu edhe i tërë rendi i prodhimit është i yshtur të shfaqet në simulimin veprues (Baudrillard, 1993). Nëse më parë shoqëria moderne karakterizohej nga dallimet, lindja e fazës së tretë të zhvillimit të shoqërisë (postmoderne) karakterizohet nga një shembje e dallimeve. Tek veprat Symbolic exchange and death dhe Simulations, Baudrillard artikulon parimin e një thyerje themelore mes shoqërisë modene dhe asaj postmoderne. Ndërsa shoqëria moderne organizohej përreth prodhimit dhe konsumimit të të mirave, ajo postmoderne organizohet përreth simulacionit dhe aktivitetit të

imazheve dhe shenjave që përcakton një situatë ku kodet, modelet dhe shenjat përbëjnë format organizuese të një rendi të ri social ku sundon simulimi. Por simulimi nuk përbën një territor, një prani e adresuar, apo një substancë. Përbën prodhimin përmes modeleve të reales pa një fillësë apo realitet: hiperrealja (Baudrillard, 1983a). Kështu, ky rend i ri social i situatës postmoderne bazohet tek informacioni në përpjekje për të ushtruar kontroll tërësor të reales dhe trupit social. Në këtë mes, imagjinaria nuk ekziston më si instancë e trupit social pasi modelet nuk kërkojnë t'i përngajnë reales pasi kjo e fundit simulohet nga modelet e virtualitetit, pa një adresim konkret. Në këtë kuptim, simulacioni kërcënon dallimin mes “të vërtetës” dhe “të rremes”, “reales” dhe “imagjinares”. Jo, realja nuk përbën më ëndërrën ose fantazinë, e një përtej ose e një brenda, është ajo e ngjashmërisë halucinante të reales me vetveten (Baudrillard, 1983a).

Ontologjia e simulacionit dhe lindja e idealizmit semiologjik

E gjithë metakritika e Baudrillard për sistemin dhe format e tij bazohet në një kritikë të kritikës që lidhet me të kuptuarit e vërtetë të realitetit në kushte të ndryshuara tashmë. Prandaj ndryshimi i natyrës dhe shfaqjes ontologjike të realitetit në kushte e reja të krijuara kërkon një kritikë të re. Tani më, jemi dëshmitar të një epoqe ku të gjithë instrumentet, format dhe marrëdhëniet sociale kanë pushuar së qeni si më parë. Edhe koncepti i punës që më parë përbënte kategorinë kryesore të strukturimit, prodhimin dhe kritikës sociale, sot shfaqet si një shenjë e zakonshme mes shenjave të tjera. Tani më, prodhimi bashkohet në sistemin konsumerist të shenjave (Baudrillard, 1993). Në kuptimin social, kemi një zhvendosje nga shoqëria e prodhimin të mallrave te ajo e prodhimin të kodeve dhe shenjave. Pra, ontologjikisht bëhet fjalë për një kalim

nga fizikja te virtualja që nuk personifikon thjeshtë shpirtëroren e cila i bindet logjikës së epokës së modernitetit. Nuk bëhet fjalë thjeshtë për një idealizëm objektiv por për një idealizëm semiologjik virtual. Logjika e virtualitetit si kod i sistemit social bën që entitetet si forca e punës, energjia, dëshira, seksualiteti, e pandërgjegjshmja etj, të mos jenë më forca prodhuese por variabla veprimi të kodit që shprehen të simuluar në institucione dhe praktika sociale. Logjika e simulacionit, hiper-realitetit të pamjeve dhe spektaklit të shenjave zëvendëson logjikën e prodhimin dhe konfliktin klasor social. Nëse më parë fjalët i drejtoheshin objekteve dhe ripërfytyrimet nënkuptonin adresimin të realja (materiale), tashmë janë vetë shenjat që përbëjnë e ndërtojnë realen dhe realitetin. Në këtë situatë të re, shenjat e fitojnë kuptimin duke u çtrupëzuar referencialisht pasi janë absolutisht të pavarura nga objektet dhe kanë si synim të prodhojnë vetëm shenja të tjera: të njëjtën. Si pasojë, shenjat e fitojnë kuptimin dhe ekzistencën reale ngaqë i drejtohen shenjave të tjera, ashtu si pamja, vetë pamjeve të tjera e jo realitetit fizik që pretendon se i përfaqëson vizualisht. Kjo “nënkupton simulimin në sensin, ku që tani e tutje, shenjat do të shkëmbehen tërësisht mes tyre, pa ndërvepruar me realen.... Emancipimi i shenjës: e çliruar nga ai detyrim “arkaik” që duhej të përcaktonte diçka, shenja është më në fund e çliruar nga një lojë strukturore apo çiftuese që shkon në përputhje me indiferencën dhe papërcaktueshmërinë tërësore që pason rolin e mëparshëm të barazvlershmërisë përcaktuese” (Baudrillard, 1993). Kështu, individit duke i qenë i burgosur në këtë mbretëri të shenjave dhe pamjeve të simuluar nuk ndesh realitetin fizik si adresim referencial e kuptimor por imagjinaren e simuluar të shenjës të shfaqur si reale, madje më reale se vetë realja. Për këtë arsye, sipas Baudrillard tashmë është e pamundur të veçosh procesin e reales apo të provosh realen (Baudrillard, 1983a).

Në këtë situatë të virtualitetit të shenjave ku riprodhohen pamjet, bëhet e pamundur të dallosh kuptimet e kundërta pasi gjithçka ndërshkëmbehet mes tyre. E njëjta e “gjenezës së simulakrës” është e dukshme kudo: ndërshkëmbyeshmëria e të bukurës dhe të shëmtuarës në modë, e Majta dhe e Djathta në politikë, e vërteta dhe e rremja në çdo mesazh të medias, e dobishmja dhe padobishmja te objektet, natyra dhe kultura në çdo nivel të kuptimit (*Baudrillard, 1993*). Pra, në këtë situatë radikalisht të re, në realitetin e papërcaktueshmërisë radikale, bëhet edhe më e pamundur (në mos e pamundur) të dallohet realja nga jorealja, e mira nga e keqja: pra, të perceptohet ajo që përcakton apo përbën ngjarjet dhe proceset e ndryshme sociale. Në këtë fazë të shoqërive globaliste na shfaqet një spektakolarizim kozmopolit, transformimi i saj në imazhe dhe shenja virtuale. Gjithçka bëhet imazh, një shenjë, një spektakël, një objekt ndër-estetik në masën ku gjithçka bëhet ndër-politike ndër-ekonomike, ndër-seksuale etj. Për këtë arsye, ky materializim i estetikës shoqërohet nga një përpjekje e dëshpëruar për të stimuluar e krijuar imazhe më të shpeshta.

Logjika tautologjike dhe implozioni i sistemit të virtualitetit

Sipas Baudrillard, realiteti në situatën postmoderne vërtitet përreth simulakrit të simulacionit të shenjave. Megjithatë simulakrat nuk përbëjnë vetëm një lojë e luajtur me shenjat; ato përfshijnë raportet sociale dhe pushtetin social (*Baudrillard, 1983a*). Prandaj analizimi i parimit dhe mënyrës sesi shpaloset dhe vepron ky simulakër i veçantë në trupin social përbën elementin kryesor për të kuptuar simptomat e realiteti social dhe lidhjeve të tij. Në këtë realitet të ri social, virtualiteti si simulakër buron nga utopia e parimit të barazvlershmërisë (*Baudrillard, 1983a*). Në këtë perspektivë, krijohet

një determinizëm semiologjik ku shenjat paracaktojnë dhe plazmojnë realitetin përmes një sundim tërësor e të integruar të sociales. Sipas Baudrillard, logjika e simulakrit të virtualitetit bazohet tek sistemi i shenjave që prodhon nevoja të homogjenizuara të paracaktuara e të paraprogramuara paraprakisht. E tërë dinamika dhe trajektorja e sistemit social mbërthehet në një parim tautologjik. Nga ana e logjikës, tautologjia përbën një skemë ku fillimi dhe fundi i procesit janë në thelb e njëjta gjë. Në këtë dinamikë të zhvillimit social nuk krijohet asnjë element i ri por riprodhohet pa mbarim e njëjta gjë. Edhe dallimet sociale dhe nevojat heterogjene të shoqërisë përbëjnë diçka iluzore pasi ato krijohen dhe paracaktohen brenda regjimit virtual dhe simulacionit të shenjave që prodhojnë të njëjtën gjë, pafundësisht. Pra, është sistemi që i krijon dhe kultivon nevojat njerëzore e po vetë ky, që kënaq të njëjtën nevojë. Qëllimësia e vërtetë e individit nuk bëhet diçka e dallueshme pasi ajo krijohet, realizohet dhe paracaktohet artificialisht nga vetë sistemi virtual i shenjave në zinxhirin e konsumit. Në këtë kuptim, individët tkurren në një sistem nevojash të krijuar artificialisht nga sistemi dhe kënaqja në dukje e tyre, krijon iluzionin e zgjidhjes së kontradiktave sociale. Për këtë arsye, tëhuajtësimi i individit në kushtet e simulacionit virtual (jo përgjatë punës fizike) shfaqet si më apokaliptik dhe i një lloji më të vështirë për tu kuptuar e për tu zgjidhur. Simulacioni është pafundësisht më i rrezikshëm pasi përherë lë të hapur supozimin se, mbi dhe përtej objektit të tij, vetë ligji dhe rendi nuk janë gjë tjetër veçse simulim (*Baudrillard, 1983a*). Në sistemin e virtualitetit, individualiteti, e shumëllojshmja, heterogjeniteti dhe veçantësia përbëjnë shfaqjen formale dhe iluzone të krijuara nga sistemi i paraprogramuar i virtualitetit dhe jo një produkt spontan i kontradiktave mes individit dhe shoqërisë. Në realitetin social, riprodhimi i të njëjtës gjë maskohet duke krijuar iluzionin e

risisë dhe kundërshtive sociale përmes aspiratave, dëshirave, shpresave, ëndrrave, gjesteve dhe shije të shumëllojshme. Por, këta elementë social të individit nuk janë krijime spontane të tij por momente të fabrikuaru preparakisht nga vetë sistemi i virtualitetit. Në këtë dinamikë sociale, nuk prodhohet asgjë e re në fund të procesit nga sa ishte projektuar dhe paramenduar në fillim të tij. Asgjë nuk humbet apo zhduket por vetëm transformohet në modalitetet e ndryshme sipas të njëjtit parim. Në një logjikë të barazvlerëshmerisë, objektet funksionojnë njëllor si shenjat dhe zotërojnë përdorime, vlera dhe qëllime të njëjta përsa individët bartin të njëjtat nevoja sociale. Është pikërisht krijimi dhe shfaqja e rreme e diferencave sociale që prodhon sistemi i virtualitetit çka e bën më të vështirë (në mos të pamundur) të kuptuarit dhe realizuarit e një emancipimi shoqëror. Për Baudrillard, kjo strukturë e re ideologjike që luan me hieroglifet e kodit është shumë më tepër e palexueshme sesa ajo luan me energjinë prodhuese. Ky manipulim që luan me fakultetin e prodhimit të kuptimit dhe diferencës është më radikal se ai që luan me fuqinë e punës (Baudrillard, 1975). Krejt ndryshe nga më parë ku fuqia punëtore kanalizohet në prodhim, shenjat dhe kodet e kanalizojnë ndërgjegjen në shtigje të paracaktuara si konsumi, magjepsja, joshja etj. në formën e pavetëdijes. Formashenjë zbatohet ndaj të tërë procesit social dhe është gjërësisht e pavetëdijëshme (Baudrillard, 1975). Pikërisht edhe për shkak të pavetëdijes së kësaj situatë, kjo betejë është edhe më e vështirë për tu luftuar. Themelimi i sistemit tek shenjavlerë e jo më tek procesi i prodhimit sjell një zhvendosje epistemike të sociale dhe politikes, e rrjedhimisht edhe të kritikës. Nga pushteti dhe kontrolli i mallrave te pushteti dhe kontrolli i shenjës, nga një ekonomi politike te një semiologji politike. Tashmë, të gjithë format e shfaqjes (sjellje, ëndërr, dëshirë, impuls etj) janë të integruara

e të shkrira në një mënyrë të re strategjike kontrolli ku nuk shfaqen kontradiksione reale. Duke qenë se shenja nuk i drejtohet objektit por vetë shenjave të tjera, siç ndodh në realitetin virtual, atëherë ajo nuk bart asnjë domethënie adresuese duke humbur në zinxhirin e pafund të shumëfishimit të vetvetes. I vetmi kufi që njih shenja është pikërisht riprodhimi i një shenje tjetër e kështu me rradhë, në një shumëfishim të së njëjtës, në një formulë tautologjike. Për këtë arsye, realiteti nuk përfaqëson më një manipulim material por një manipulim semiotik virtual. Prandaj i tërë sistemi bëhet i pa peshë, nuk është më në vetvete asgjë veçse një simulakër gjigant - jo i pavërtetë, por një simulakër, domethënë kurrë i këmbyer me të vërtetën, por i këmbyer me vetveten, në një qark të pandërprerë pa adresues ose perimetër (Baudrillard, 1983a).

Rrethi vicioz dhe tëhuajtësimi i legjitimitetit të trupit social

Teknologjia përveç rolit si emetues, transmetues dhe vlerësues së shenjë-vlerës së realitetit bë që tipologjia e arkitekturës së saj të mundësojë një shkallë të paprecedentë ndërdepërtimi social. Për këtë arsye, Baudrillard rreket të kryej një analizë të thellë vertikale të realitetit që replikohet deri në përditshmërinë dhe në instancat më lokale të hapësirës sociale. Rrjedhimisht ky hipersemiotizim i reales e shtyn vetë atë të kryejë një ‘analizë estetike dhe sintaktike të realitetit’ duke analizuar jo vetëm hierarkinë e modeleve të mallrave por edhe organizmin, kuptimin dhe rangun social të zotëruesve të tyre. Sipas Baudrillard, objektet asnjëherë nuk e kanë shterur vetveten në funksionin që ata shërbejnë dhe në këtë tepri të pranisë që përftojnë në domethenien e tyre të prestigjit. Ata nuk ‘përshkruejnë’ më botën, por të qenit dhe rangun social të zotëruesve të tyre (Baudrillard, 1981). Kjo situatë nënkupton një arrati nga analiza materiale e shuarjes së kënaqësive dhe nevojave

pasi të mirat nuk përbëjnë më lokusin e kënaqësisë (siç mendonte ekonomia politike klasike), por shenja që bartin kuptimin social dhe prestigjin e individit: pra kemi të bëjmë më tepër me një semiologji politike të sociale. Në këtë premisë, semiologu shndërrohet në një semiolog social ku jo vetëm shenja i drejtohet objektit por vetë objekti është bërë një shenjë që shënjon, rendit dhe hierarkizon socialen. Në kuptimin e politikës është pikërisht ky rend dhe dinamikë frenetike e konsumit që apelon për njohje dhe legjitimitet publik. Por në këtë proces, ky qëndrim social tëhuajtëson veten pasi kërkon t'i përgjigjet ekonomikisht (përmes konsumit), një akti politik siç është legjitimiteti. Pikërisht këtu qëndron elementi i tëhuajtësimit pasi nevojën dhe apelin për një legjitimitet politik, shoqëria kërkon ta zgjidhin përmes një konsumi frenetik përherë e më të madh, çka në nivel material mbetet përherë e më i kufizuar dhe i pamundur për tu arrirë. Prandaj kjo etikë e konsumit shënjon sipas Baudrillard edhe "kufirin e mundësive të tyre sociale" (*Baudrillard, 1981*). Siç vihet re, e gjithë kjo panoramë e sociale ndërhytet tek fakti se kapitalizmi përvijon sundimin social përmes plazmimit të një sistemi shenjash virtuale dhe ku individët e përftojnë (edhe pa vetëdije) përmes aktivitetit të konsumit. Në këtë mes, krijohet një iluzion sistemik ku modelet konsumeriste të kapitalizmit krijojnë ndjesinë e rreme për vetrealizim, vetvlerësim, kënaqësi. Por të gjitha këto nuanca janë iluzore pasi nuk lindin spontanisht tek individë por janë të kontrolluara, shpërndara dhe mundësuar paraprakisht nga vetë konsumizimi i sistemit të virtualitetit. Në këtë kuptim, mundësia për emancipim individual apo kolektiv për një integrim të të mirave në një projektion individual të vetrealizimit, është i pamundur. Pikërisht ky përfundim i hidhur shfaqet më pesimist pasi nuk janë më individët apo shoqëria që organizon jetën e saj përreth objekteve por janë këta

të fundit që organizojnë dhe strukturojnë nevojat e tyre. Në këtë mes, edhe elementët e utopive të ndryshme sociale që lindin nga ky rezultat (ëndrrat, shpresat, ndjenjat, instinktet) etj, shfaqen të pafuqishme për një ndryshim social pasi edhe këto të fundit janë të parafabrikuara.

Nga ana tjetër, fenomenologjikisht, është parimi i implozionit që mund të shpjegojë konceptin e sociale përmes masës sociale ose më saktë, konceptin e sociale përmes gjendjes së masës. Një nga përgjigjet tipike e më të përhapura që masat sociale artikulojnë ndaj politikës është pasiviteti. Por ky fenomen në fakt nuk përbën thjeshtë një reagim aktiv por shfaq simptomën psikologjike të gjendjes së mbijetesës. Në fakt kjo përfaqëson një kundër-reagim i prodhuar paraprakisht nga vetë sistemi çka e bën masën të mos ketë më kuptim politik jo vetëm si mjet rezistence por edhe si legjitimitet i vetë politikës: si përfaqësim. Tani më, masat nuk janë më referues pasi nuk i përkasin më rendit të ripërfytyrimit. Ata nuk shprehin veten e tyre, ata janë thjeshtë statistika në anketat e matjes së opinionit publik. Ata nuk reflektojnë mbi veten e tyre, ata janë kampionë testimi. Referendumi dhe mediat përbëjnë një apel konstant ndaj pyetjeve dhe përgjigjeve të drejtuara si i vetmi adresues i politikës. Tashmë, anketimet, testet, referendumet, media janë mjete që nuk i përkasin më përmasës së ripërfytyrimit, por asaj të simulimit (*Baudrillard, 1983b*). Në këtë situatë, këto instrumenta politike i vënë individët jo përballë njëri-tjetrit por përballë modeleve të simuluar. Por, megjithatë loja e legjitimitetit e kërkon politikisht përgjigjen e masës pasi i jep themel ekzistencës së pushtetit. Për këtë arsye, në mënyrë dëshpëruese, sistemi kërkon vazhdimisht të prodhojë regjimin social por në fakt krijon praktikën sociale të mos-përfaqësimit të ky legjitimitet. Pra, sistemi në vend që ta shndërrojë masën në energji, informacioni i sistemit prodhon edhe më shumë masë inerte njerëzish. Në

vend që të informojë, siç ai pretendon, në vend që t'i jap formë dhe strukturë, informacioni asgjëson edhe më tej “fushën sociale”, përherë e më tepër krijon një masë inerte të papërshkueshme nga institucionet klasike të sociale dhe përmbajtjes së vërtetë të informacionit (*Baudrillard, 1983b*).

Nga ana tjetër, në këtë krizë të sociale si mospërfaqësim politik, Baudrillard nuk mendon se mediat manipulojnë apo në të kundërt, socializojnë masat, pasi realisht ato asgjësojnë vetë socialen. Si nevojë për legjitimitet, pushteti prodhon socialen e zbratur tërësisht nga përmbajtja, duke krijuar të vetmin efekt social: atë të simulimit. Në këtë kuptim, trupi social shfaqet thjeshtë si një strukturë e zbrazët që i duhet të rikrijohet vazhdimisht e formalisht për të mbajtur gjallë arsyen se ‘përse ekziston pushteti apo politikja’. Kështu, në një skenar ekstrem, ky konformizëm hiperreal që përbën formën ekstreme të mospjesëmarrjes simbolizon një “fatkeqësi” për shoqërinë që kërkon pjesëmarrje dhe bindje, përbën gjithashtu një “fatkeqësi të revolucionit” dhe socializimit që kërkon një shtim dhe zhvillim të sociale... ky revolucion përmes regresit

nuk është i tyre; nuk është kritik-shpërthyes, është imploziv dhe i verbër. Vijon përmes incercisë dhe jo nga një negativitet i ri e gazmor. Është i heshtur dhe joevolutiv-saktësisht e kundërta e të folurit dhe rritjes së vetëdijes. Nuk ka kuptim. Nuk ka asgjë për të na thënë (*Baudrillard, 1983b*).

Përfundime

Realiteti i sotëm dhe trupi social, karakterizohet nga simulakri i shenjave dhe virtualitetit. Çdo objekt dhe marrëdhënie sociale është ndërtuar dhe parafabrikuar nga logjika e sistemit që bazohet në riprodhimin e pafundëm të shenjave virtuale. pa një adresues fizik real. Në këtë kuptim, diferencat sociale, individualiteti dhe kontradiktat krijojnë iluzionin e kundërvënies ndaj sistemit por në të vërtetë përbëjnë gjurmë jo spontane e të krijuara artificialisht nga sistemi i virtualitetit. Si rrjedhojë, sipas Baudrillard, shpresat për ndryshim të thellë social janë të pamundura, prandaj e gjithë veçantësia e kritikës sociale qëndron vetëm në të kuptuarit e këtij pesimizmi teorik dhe social.

REFERENCAT

- Wolf, L. K. A. (2015). *Effects of Peer Influence in Adolescence* (Doctoral dissertation, UCL (University College London)).
- Baudrillard, J. (1983a). *Simulations* New York: Semiotext(e)
- Baudrillard, J. (1983b). *In the Shadow of the Silent Majorities: Or, the End of the Social and Other Essays*. New York: Semiotext(e)
- Baudrillard, J. (1993). *Symbolic exchange and death*. London: Sage
- Baudrillard, J. (1981). *For a Critique of the Political Economy of the Sign*. St. Louis: Telos Press.
- Baudrillard, J. (1975). *The mirror of production*. St. Louis: Telos Press.

ABSTRACT

In addition to various philosophical considerations, the change in politics and in the reality of society serves not only as a vector for constructing a new critique, but also for epistemically sketching a metacritic. In this trace, Baudrillard's thought comes as a radical rupture versus the classical criticisms of the social and political system. According to him, today's reality testifies to an irreversible closure of the existing social criticism. Ontologically,

reality has changed the energetic nature, the systemic entropy, the form and the principles of its manifestation under the trace of signs and virtuality. The whole reality and the social body has been transformed into a system of virtual signs that are infinitely reproduced and predetermined by the system according to a tautological principle: the infinite reproduction of sameness. Today's system has become self-referential without producing real differences and contradictions to provide solutions. The simulacrum or vector of social reality is that of virtuality and simulation constructed in an abstract and formal form, where every difference and individuality appears as illusory and prefabricated. In this sense, the hope of a social revolution seems meaningless and impossible.

Keywords: simulation, code, mass, sign, virtuality, tautology

IDEOLOGJIA E MAJTË DHE KUIJTË E DIALEKTIKËS

Juljan MYFTARI
Universiteti i Tiranës
E-mail: julian.myftari@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

E majta shqiptare pati një impakt të padiskutueshëm gjatë luftës së dytë botërore. Ajo mori përkrahjen e shtresave të shoqërisë të cilat besuan premtimin e saj për liri dhe zhvillim. Për komunizmin historia ishte lëvizje dhe ndryshim. Në thelb të historisë ishte ndryshimi dhe jo identiteti. Në këtë mënyrë komunistët premtuan ndryshime të pangjara më parë në Shqipëri. Këtë e mundësonte dialektika si ligjësi shoqërore dhe si mjet ideologjik për të ndryshuar realitetin. Shpejt, premtimi i komunistëve për të ndryshuar realitetin mori formën e një diktature që mohonte çdo formë të arsyeshme lirie. Në këtë punim do të mëtojmë arsyet e mundshme të këtij transformimi. Në pikëpamjen e këtij punimi diktatura komuniste nuk ishte vetëm një rastësi rrethore e një ideologjie çliruese. Përkundrazi, ajo e ka gjenezën e saj pikërisht në pamundësinë e pushtetit për të përdorur kategori të vazhdueshme dialektike dhe nevojën e saj për ta përcaktuar vetëm si realitet përfundimtar, formal.

Fjalë kyçe: *dialektikë, marksizëm, logjikë formale, diktaturë*

Juljan MYFTARI është lektor në Universitetin e Tiranës. Ai ka botuar tre monografi dhe një sërë artikujsh shkencorë të publikuar në shtëpi botuese prestigjioze si “Springer Nature”. Juljan Myftari është diplomuar në Shkencën Politike dhe ka marrë gradën shkencor po në këtë fushë. Fushat e tij kryesore të studimit janë Filozofia Politike dhe Metodologjia e Kërkimit Shkencor.

Ideologjia marksiste u shfaq në Shqipëri gjatë luftës së dytë botërore. Ajo e shpalli veten si çliruese të historisë. Kjo ideologji propagandonte dialektikën historike si rrugën drejt lirisë për pjesën dërrmuese të shoqërisë. Marksizmi premtonte ndryshim, ndriçim dhe përparim për ata që ishin lënë në errësi shekullore. Kjo ideologji pretendonte se ishte e kundërt me ideologjitë e tjera, të cilat akuzoheshin nga marksistët se kishin lënë pjesën më të madhe të Shqipërisë në skllavëri dhe mjerim. Sipas saj, ideologjitë tradicionale apo edhe ato moderne të djathta, bazoheshin në

formalizëm dhe nuk mund të ndryshonin gjendjen për pjesën dërrmuese të popullsisë. Mjeti kryesor i komunistëve ishte vizioni dialektik i realitetit. Për marksizmin realiteti është i ndërtuar nga të kundërtat. Përplasjen dhe të kundërtën kjo ideologji e përdorte si mjet për të avancuar shoqërinë.. Nëpërmjet përplasjes së vazhdueshme kjo ideologji do të sillte përparimin që shumë kishte munguar në një vend që në pjesën më të madhe të tij kishte ngelur dukshëm prapa fqinjëve të tij më të zhvilluar. Partia Komuniste premtonte se ky përparim do të përfshinte pjesën më të madhe të shoqërisë dhe jo për një pakicë elitare.

Megjithatë, Partia Komuniste dhe ideologjia që ajo mbartte, në vend të çlironte vendin ndërtoi një diktaturë të ashpër, ku kontrolli mbi individin dhe shtypja e çdo lirie u bë sinonim i politikës. Kontrollin tradicional mbi individin, i cili ishte gjysmak për nga intensiteti dhe hapësira, kjo parti e zëvendësoi nga një i tillë modern, shumë më qelizor se i pari. Për shkaqet e lindjes së kësaj diktature është diskutuar gjerësisht. Shumë studiues krijimin e diktaturës komuniste ia atribuojnë disa karakteristikave kontigjente të individëve të caktuar udhëheqës të partisë komuniste. Të tjerë rrethanave specifike të Shqipërisë. Ne do të argumentojmë se një rol thelbësor në ngritjen e diktaturës dhe tradhtisë së idesë së lirisë e ka vetë ideologjia komuniste e majtë. Ose më mirë fakti që ajo nuk arrin të jetësojë botëkuptimin e saj dialektik. Komunistët përdornin një përzierje konceptesh të fiksuara metafizike dhe kritike dialektike për të shtypur përfundimisht kundërshtarët dhe për të mbajtur nën terror anëtarët e saj.

Kështu lind pyetja nëse ndërmarrjet e majta, apo disa forma kryesore të tyre si marksizmi, krijojnë kushtet për despotizma të cilat kufizojnë individin deri në mohim të individualitetit të tij apo çdo veprimtarie të lirë. Apo në të kundërt, nëse duhet të mendojmë se këto shfaqje despotike nuk

janë thelbësore për të majtën dhe dialektika që ajo premtonte mund të realizohet sipas premisave të ideologjisë. Do të ishte reduksioniste që të konstatoje se ideologjia e majtë marksiste ka një formë ideale të cilën individë të korruptuar të pushtetit nuk donin, apo nuk mundën ta zbatonin. Do të ishte naive ta konsideroje ideologjinë si “ideale” dhe individët apo historinë konkrete si mbartëse të gjithë mëkateve të cilat patën si pasojë dështimin. Fillimisht për këtë do të bëjmë një krahasim midis logjikës formale dhe asaj dialektike, për të hulumtuar konceptet kryesore të tyre. Më tej do të shikojmë se si këto koncepte janë materializuar menjëherë pasi komunistët morën pushtetin. Më konkretisht do të fokusohemi në Plenumet e katërt dhe atë të pestë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste shqiptare për të parë se si brenda një viti nga marrja e pushtetit, tentativa për të çliruar historinë me anë të dialektikës ia la vendin përdorimit të dialektikës në shërbim të pushtetit që buronte nga metafizika formale e Partisë.

Aparatet logjike

Logjika dialektike dhe ajo formale kanë një histori të gjatë dhe gjeografikisht të gjerë si aparate rregullues së mendimit. Nuk ka dyshim që midis tyre ka një themel të kundërt. Për logjikën formale mendja njerëzore operon me dikotominë “e vlefshme” - “e pavlefshme”, e cila sjell më tej dikotominë tepër të rëndësishme, “e vërtetë”-“e pavërtetë”. Për logjikën formale një subjekt i caktuar ose e zotëron, ose nuk e zotëron një tipar të caktuar. Ose mund të kategorizohet si nën një rend të caktuar, ose nuk mund të kategorizohet në atë rend. Këto përbëjnë ligjet themelore të logjikës formale; ligji i identitetit dhe ligjit i së tretës së përjashtuar. Sipas ligjit të identitetit “A=A”, çdo gjë është e barabartë me vetveten dhe nuk mund të jetë ndryshe nga vetja e saj. Në dy pohime të kundërta

për të njëjtin objekt, të paktën njëri është gabim. Diçka ose është e vërtetë ose nuk është e vërtetë. E pavërteta eliminohet tërësisht nga sistemi si e pavlerë dhe nuk mund të ketë asnjë marrëdhënie me të vërtetën. Një pohim i tretë pra, që diçka është edhe e vërtetë edhe e pavërtetë, nuk është i mundur. Në bazë të këtij qëndrimi është besimi realist se atje jashtë ka një realitet objektiv të rregullt të fiksuar dhe të dallueshëm. Kjo qartësi e logjikës formale sjell probleme të saj në trajtimin e njohurive të reja të cilat kanë një status të ndërmjetëm. Ky problem nuk ishte vënë re në periudhën skolastike sepse asokohe një rëndësi më të madhe i kushtohet vërtetimit të dijeve të cilat konsideroheshin si të padiskutueshme. Kjo gjë ndryshoi me zhvillimin e shkencave në shekujt XVII-XVIII dhe lindjen “e nevojës për të zhvilluar metoda për përfitim të dijeve të reja (Kopnine, 1967: 90).

Logjika dialektike na paraqet një “logjikë” tjetër, por dhe një univers tjetër. Logjika dialektike e tradhton sigurinë e logjikës formale, sepse raporti i saj me konceptin e identitetit është i ndryshëm nga ai i logjikës formale. Për të, identiteti i pranon të kundërtat brenda qenësorisht. Të jesh nuk do të thotë të jesh qenie pa të kundërta, madje nuk do të thotë as që kundërtia është një situatë për tu shmangur me ngut, apo një e keqe ndaj së cilës duhet të marrim masat. Forma më e njohur e dialektikës është triada hegeliane (ndon`se vetë Hegeli nuk e ka përmendur emrin triadë) e cila jepet me anë të termave të tezës, antitezës dhe sintezës. Kjo dialektikë na jep një përfytyrim zhvendosjeje të qenies nëpërmjet të kapurit pas vetes së saj. Njëfarë “sherri” që qenia bën me veten, duke u përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme por pa e ditur asnjëherë, ndoshta vetëm në fund, atë që është. Qenia bëhet mohim dhe bërje. Lëvizja është gjendja e rëndomtë e realitetit. Realiteti “sprapsët përpara” për hir të gjendjeve të paarritura më parë.

Sipas Pavel Kopnine, për marksistët termi i dialektikës përdoret në tri kuptime të ndryshme. Ai shprehet se:

së pari, dialektika është një grup faktesh të cilët zhvillohen sipas një ligji objektiv. Së dyti, dialektika është një metodë tekniko-shkencore në mendjen njerëzore. Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me ligjësi objektive, por që përdoren në mënyrë pak a shumë të ndërgjegjshme në mendim. Së fundi, dialektika është shkencë e metodës dhe fakteve objektive që përputhen me një ligj në të cilin është bazuar metoda (Kopnine, 1967: 86).

Në këtë dritë Marks i përdori logjikën dialektike në ndërtimin e vizionit të tij të realitetit material dhe atij social. Duke qenë se interesi (dhe bindjet) e Marksit ishin në fushën e filozofisë sociale dhe historike, dialektika e Marksit mori një trajtë materialiste. Ajo i mundësonte Marksit të akomodonte qasjen e tij universaliste me dëshirën e tij për ndryshim të realiteteve konkrete historike. Si të thuash, një qasje që lejonte të kishte raport edhe me të përgjithshmen ashtu edhe me konkretin. Ajo i bënte thirrje në të njëjtën kohë atij punëtorit përballë, po ashtu dhe punëtorit universal. Dy “njerëz” të kundërt që mund t’i bashkojë vetëm pranimi i kundërshtisë si kategori jo problematike. Teza e II e Marksit përbënte një thirrje të qartë për këtë. Megjithatë, ndryshimi, ashtu si dialektika, nuk janë procese të cilat duhet marrë lehtësisht. Komunistët e fund luftës duhet të pranonin disa rrafsh të realitetit të cilat nuk ishin bukuri të përputhshme. Ata duhet të dallonin dhe pastaj të ndryshonin realitetin. Logjika dialektike me gjasë është mjet i mirë për të ndryshuar realitetin, por ka një problem me procesin e dallimit të tij. Dallimin e bën logjika formale, ajo është ose nuk është, ajo dallon atë që është sepse ajo që është krejtësisht e përjashtuar nga ajo që nuk është. Logjika formale dallon të kundërtën dhe e jashton atë. Ajo është mjeti

i për të dalluar armiqtë. Ose je kapitalist, ose jo!. Je armik ose jo!

Jo pa shkak, Sipas autorit të njohur Boeselager “në mendimin sovjetik ka pasur dy shkolla, ajo e aristotelianëve (formalistëve) dhe ajo e dialektikëve” (Boeselager, 1966, p. 96). Kjo është e kuptueshme sepse komunistit i duhej të dallonte dhe pastaj ta ndryshonte realitetin. Të dallonte që të asgjësonte për të ndryshuar atë që ngelte. Logjika dialektike i duhej pikërisht për të trajtuar atë që ngelej. Të ngelur nga operacioni i asgjësimit të identiteti të kundërt. Megjithatë, “ka dyshime se logjika dialektike ndiqej për arsye ideologjike dhe nuk zbatohet vërtetë” (Boeselager, 1966: 95). Vetë Lukasi artikulon një akuzë për Engelsin dhe mendon se Engelsi ka çuar dialektikën marksiste tej rendit social dhe kjo ka rrezikon një konceptim determinist të historisë (Lukács, 2017). Kjo është e rrezikshme pasi raporti midis objektit dhe subjektit ndryshon dhe bëhet i palitshëm. Nëse e shikojmë dialektikën si dialektikë të natyrës, subjekti e ka të pamundur emancipimin e tij. Kështu dallimi midis objektit dhe subjektit nuk mund të tejkalohet. Problemi këtu qëndron në rolin vëzhgues të subjektit, i cili pretendon për një natyralitet të proceseve shoqërore (shiko Emil Zola) tek i cili ai është i pafuqishëm. Ai nuk mund të shndërrojë realitetin pasi është spektatorë i një përplasjeje ku dhe ai kthehet në objekt.

Përpjekjet për dialektikë

Në këtë raport midis dialektikës dhe formales gjendet një nga shkaqet e dështimit të regjimit komunist. Sepse edhe pse komunistët propagandonin botëkuptimin dialektik gjatë historisë së tyre ndërtuan paralelisht mënyrë të vazhdueshme referenca formale të pandryshueshme. Kjo sillte një kontradiktë të papranueshme me vetë logjikën dialektike e cila propagandonte lëvizje përpara dhe partisë si një ent i fiksuar

metafizik nga i cili s'mund të ndryshonte. Megjithatë në vitin e parë të marrjes së pushtetit kjo siguri metafizike nuk ishte shfaqur në plotësinë e saj. Në vitin 1945 kur Partia Komuniste sapo kishte fituar pushtetin e saj dhe në raportin hyrës së Plenumit të katërt lexojmë se:

“Duhet të vendosim shpirtin e kritikës dhe te autokritikës së drejtë në të gjithë Partinë dhe kjo të bëhet edukatë për çdo anëtar. kritika dhe autokritika duhet të bëhet armë korrigjimi për gabimet dhe të metat tona. kritika është e drejtë kur bëhet me arsye dhe jo me autoritet. pse vetëm kështu shoku bën ndryshimin që duhet. kritika konstruktive duhet të aplikohet në të gjithë punët. kritika duhet të edukojë dhe të bindi njerëzit. në të kundër është kritikë destruktive” (KQ, 1945: 2/61).

Asokohe pushteti ishte akoma i pasigurte dhe e gjente sigurinë te vet-rregullimi me anë të kritikës. Fillimisht, me gjasë, kjo duhet të jetë kuptuar si një mjet për përmirësimin e Partisë. Sipas këtij qëndrimi realiteti akoma problematik mund të përmirësohej edhe me ane të përplasjes brenda vetes Megjithatë kjo ishte më e lehtë për tu thënë se për tu bërë. Në të njëjtin referat të paraqitur në plenumin e katërt të vitit 1945 disa nga përfaqësuesit e partisë komuniste akuzohen se: “Këta janë shkëputur nga problemet e fshatit nga hallet e popullit. Nuk janë seriozë në punën e tyre në lidhje me popullin” (APOU 1945 d.2, 65) dhe kjo bie në kontradiktë me sa lexojmë disa faqe më poshtë ku shkaqet për problematikat e vëna re vihet te mos-specializimi i kuadrove:

Në përgjithësi, përgjegjësit e Komiteteve, janë fshatarë. Këta nuk kanë eksperiencë dhe zotësi që të drejtojnë. Këta nuk janë në krye që të udhëzojnë. Nëpunësit dhe teknikët e ndryshëm. Këta u shtypin iniciativën përgjegjësve teknikë, kështu që në aparatit pushtetit tonë lokal, nëpunësit nuk japin

kontributin e duhur, kjo gjë ngjet sepse është gjendja e katundarëve e tij dhe me sistemin tonë të vetëqeverimit, ku qeverisin njerëzit e vendit. Kemi mungesë drejtuesish dhe për njerëz me eksperiencë (KQ, 1945: 2/64).

Nëse më parë kritikoheshin funksionarët e partisë se po largoheshin nga problemet e popullit tani shikojmë se në krye të një pjese të mirë të këtyre komiteteve të partisë janë vetë fshatarë të pashkolluar pa ndonjë aftësi për të zgjidhur problemet.

Këtë raport midis të vërtetave dhe qenieve në bërje, fshatarëve të do bëheshin drejtues të aftë, e dinte mire Sejfulla Malëshova, ideologu komunist i periudhës së luftës dhe një nga drejtuesit më me ndikim të fillimeve të pasluftës. Ai mendonte se klasa të tjera shoqërore si kleri, intelektualët e pavarur, apo dhe industrialistët edhe pse ishin klasa me interesa të kundërta mund të shërbenin për të ndryshuar situatën në të cilën gjendej Shqipëria në pasluftë. Sejfulla Malëshova pranonte rolin e tyre ne Ekonomi. Dialektika sipas tyre e pranonte qenien e tyre ne atë fazë. Ata edhe pse ishin fetari, intelektual i jo komunist, apo dhe industrial i aspak komunist, nuk ishin të “këqij”, as të “mirë”. Nga përplasja e punës dhe interesit të tyre me të mirën e përgjithshme, mund të arrihej përparimi dialektik i shoqërisë. . Po në Plenumin e katërt të Partisë Komuniste, në këtë vijë, disa muaj pas luftës mbarimit të luftës Enver Hoxha, pranon se klasat dhe grupimet e ndryshme shoqërore luajnë një rol në progresin ekonomik të vendit. Edhe pse të kundërta, këto klasa dhe këta faktorë do të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendi. Ai shprehet se:

Duhet forcuar sektori i shtetit, por sektori i shtetit nuk mund të përforcohet në këto kondita pa nuk u aktivizua dhe kapitali privat, dhe industria e vogël private. Sektori shtetëror do të forcohet në konkurrencë sektorin privat në konkurrencës e prodhimit të sektorit shtetëror dhe privat dhe ky proces

nuk do të jetë I menjëhershëm Duhet të krijojmë besimin e tregtarëve të mëdhenj dhe të vegjël dhe qe ata te hedhin kapitalin privat ne lëvizje, te fitojnë pa abuzuar (KQ, 1945: 2/34).

Për ta konfirmuar këtë Ministri i Ekonomisë së asaj kohe, Medar Shtylla, mendonte se për përmirësimin e gjendjes së vendit duhej angazhimi i të gjithëve, Medar Shtylla mendonte se dialektika midis këtyre shtresave nënkuptonte se te gjithë këto kategori duke përmirësuar kushtet e tyre dhe zgjeruar aktivitetin e tyre, punonin për të mirën e të gjithëve. Në fakt ishin fillimet e pushtetit dhe ai kishte nevojë për aktivitetin e përgjithshëm. Të gjitha këto kategori të popullsisë komunizmi i kishte gjetur aty. Në një raport ti botuar në gazetën Bashkimi po në shkurt të vitit 1945:

Fetari, zanatçiu, profesionisti, intelektual i, tregtari, industrial i, nëpunësi, bujku fshatari të gjithë e kudo qofshin me punën e tyre duke e zhvilluar dhe zgjeruar aktivitetin dhe punën e tyre, ndikojnë në konsolidimin ekonomik të vendit” (Shtylla, 1945).

Megjithatë Malëshova nuk a pati të lehtë të kuptonte se ai do të ishte një nga viktimat e para të për të kuptuar dhe zbatuar ligjësitë e dialektikës. Kjo sepse vetë marksizmi, të cilin Malëshova e njihnte ndoshta, më mirë se të gjithë kolegët e tij të partisë, kërkon të japë një pikëpamje mbi natyrën e marrëdhënies dhe kjo i shket marrëdhënies konkrete. Kjo bie ndesh me dialektikën dhe i kapërcen kufijtë e saj. Një tentativë për ta zgjidhur këtë problem të realitetit kontradiktor mund ta gjejmë te Narksi. Sipas Narksit logjika dialektike duhet te tejkalojë materializmin dialektik, edhe pse duhet të respektojë parimet e tij kryesore. Kjo sepse n.q.s. logjika dialektike do të kufizohet tek materializmi dialektik atëherë ajo do të kthehej në një, kopje te saj (Narskii, 1981: 2). Pra logjika dialektike

do të kthehej në një përsëritëse të ligjeve të përgjithshme të materializmit dialektik tek procesi i njohjes. Kur paraqesim një problem në mënyrë dialektike, problemi paraqitet në atë mënyrë në të cilën ai ka dy formulime të kundërta p.sh. A ka si shkak një B dhe një C (ku B dhe C) janë kontradiktore me njëra tjetrën dhe zgjidhja e kontradiktës jepet si unitet i këtyre të dyjave, por jo unitet eklektik. Kjo vërtetësi nuk qëndron në mes të (Narskii, 1981: 4) të dy të kundërtave. Nuk është në mes. kur flasim për epistemologji dialektike nuk mund të zërthejmë realitetin në dy pjesë dhe të themi pasoja pjesërisht varet nga një faktorë dhe pjesërisht nga tjetri. P.sh. problemet shkaktohen nga largësia e zyrtarëve nga populli apo nga fakti që vetë zyrtarët janë “katundarë” të pashkolluar po ashtu si masa e gjerë e popullit. Për logjikën dialektike problemi zgjidhet vetëm nëse ne gjejmë burimin e problemit në tërësi dhe jo të pjesëve të tij. Një burim i cili për nga thelbi i tij do të shprehë unitetin organik-dialektik midis tyre. Kështu Dialektika paraqet një unitet e cila nga ana e saj kërkon një vlerë vërtetësie përballë një bote materiale. Ky unitet shihet si gjendje përfundimtare e së tashmes, si një sintezë.

Por duke parë problematikat e kohës, mungesa e fiksimit nëpërmjet konceptit, rezultojnë problematik pasi nuk e mbron aktorin që lexon realitetin. Sipas Narskit, është pikërisht metoda e materializmit dialektik ajo që jep atë sqarim të koncepteve mbi realitetin dhe të shtron mundësinë e kuptimit të lëvizjes së mëtejshme. Logjika dialektike dallon nga ajo formale sepse ajo nuk përdor konjunksione, por përdor sinteza. Asaj i duhet të gjej një realitet i cili nuk është bashkim mekanik i faktit që fajin e kanë dhe zyrtarët që largohen nga populli edhe populli i cili është injorant dhe zyrtar njëherësh. Konjunksioni “është dhe nuk është” dallon nga sinteza dialektike sepse i pari është bashkim të vërtetash ndërsa e dyta presupozon ndryshim gjendjeje, Dialektika, si të thuash, nga një “katundar” i pashkollë dhe nga një zyrtar

indiferent ndaj popullit premtion të nxjerrë një zyrtar që në të njëjtën kohë është shumë më i aftë se populli por dhe krejt i shtrirë në problemet e popullit.

Partia si entitet formal

Megjithatë, kjo dialektikë duhet të kishte një udhëheqëse. Siç përcakton Sejfulla Malëshova në një artikull në gazetën Bashkimi: “Për herë të parë vendi ynë po hyn në radhën e vendeve të qytetëruara, dhe hyn duke pasur një regjim politik shumë të përparuar siç është pushteti ynë popullor” (Mal`shova, 1945). Nga ana tjetër, sipas autorit, shoqëria shqiptare nuk ishte e përparuar. Sistemi politik marksist me në krye Partinë Komuniste ishte shumë më i avancuar se shoqëria shqiptare. “Kjo shkëputje kolosale në mes të regjimit politik dhe të gjendjes reale ekonomike e kulturore, sjell shumë probleme”, vazhdon Malëshova. Kështu që pushtetit të Partisë Komuniste i takonte ta drejtonte këtë lëvizje dialektike. Partia dhe pushteti i saj sipas komunistëve dhe Malëshovës ishin forma më e përparuar e organizimit politik në mund të gjendej. Madje, sipas tyre, edhe më e përparuar se demokracitë perëndimore. Partia ishte aq e përparuar sa dukej se ishte entiteti i palëvizshëm në një shoqëri që duhet të ndryshonte.

Kështu një vit më vonë komunistët e kuptuan se ishte e kot dhe e dëmshme që në dialektikën e zhvillimit të përfshinin kategori të tjera shoqërore. Kjo sepse Partia aq e përparuar sa ishte, u kthye në një entitet metafizik drejt të cilit duhet të synonin të gjitha lëvizjet e dialektikes. Pikërisht në Plenumin e pestë të Partisë komuniste mbajtur në shkurt të vitit 1946, pikërisht personazhe si Sejfulla Malëshova do të konsideroheshin oportunistë dhe deri në armiq të partisë. Më së shumti për shkak se ata kishin dashur të përfshinin në dialektikën historike kategori dhe shtresa të kundërta me partinë. Kjo edhe sepse

për komunistët njeriu nuk ka vlerë në vete por e rëndësishme është vlera sociale. Vlera e individit varet nga dobishmëria shoqërore e tij dhe shoqëria përcaktohej nga Partia. Nga qenie dhe histori dialektike ku ngjarja ndodh në njeriun dhe kategoritë që përmirësohen, komunistët nxituan të përdornin kategori tashmë formale ku njeriu ishte tërësisht i përcaktuar. Ai ishte qenie në dobi të shoqërisë me një fjalë Partisë. Sipas një autori shumë të njohur Sovjetik Vasili Tugarinov, “subjekti njerëzor është refleksioni i shoqërisë në një formë individuale”. Ne variantin sovjetik të marksizmit njeriu i nënshtrohet krejtësisht rrethanës. Ai do të nënshtrohet objektivitetit të ligjit. Objektiviteti do të thotë pavarësi nga vullneti, mendimi dhe dëshirat.

Në Plenumin e pestë i cili u zhvillua në shkurt të vitit 1946, shihej një qëndrim krejt tjetër në lidhje me rolin dialektik që mund të kenë aktorët dhe kategoritë e ndryshme shoqërore. Roli që mund të kishte e kundërta, grupet dhe klasat e tjera shoqërore nuk konsiderohet si dialektik, ato nuk mund t'i shërbejnë më progresit. Menjëherë Enver Hoxha në referatin e tij hyrës të Plenumit të pestë hodhi akuza se kishte pasur qëndrime të forta oportuniste brenda partisë. Këto qëndrime e kishin dëmtuar veprimtarinë e saj. Për ta mbështetur Hoxhën, Dali Ndreu, i cili vite më pas do ta pësonte personalisht si armik i saj, theksonte se “Shfaqjet e oportunitizmit ishin të kudondodhura, në ngritjen e administratës publike, në shkolla apo ushtri.” (AQSH, F.14. D1, f. 1).

Megjithatë dukej se shumë nga personat që udhëhiqnin asokohe Partinë Komuniste as nuk e kishin kuptuar se veprimtaria e tyre ishte në kundërshtim me linjën e duhur apo me diçka tjetër. Kiço Ngjela theksonte se: “Sot është meritë e atyre shokëve që e panë gabimin e vijës. Tani ne shohim si ka qenë gabimi vijës” (AQSH, F.14. D1, f. 3). Ngjela e kishte fjalën këtu për Enver Hoxhën. Me sa duket ai i kishte kuptuar gabimet vetëm pas dëgjimit të fjalët së Enver Hoxhës. Në fakt

edhe vetë Ngjela vite më vonë do ta pësonte nga gabimet që më vonë nuk do të arrinte t'i kuptonte aq shpejt sa duhej. Megjithatë në atë kohë ishte radha e Malëshovës i cili ishte ideologu kryesor i Partisë Komuniste. Ai ishte i akuzuari kryesor i Enver Hoxhës. Sipas Hoxhës Malëshova kishte ndjekur një linjë tepër të butë dhe paqutese me entitet e kundërta të partisë. Sipas akuzës Malëshova kishte vepruar kundër interesave të Partisë. Ai kishte “bërë pis” identitetin e saj duke përfshirë në një marrëdhënie dialektike grupe shoqërore të gjenetikisht të kundërta me të.

Sejfullai pranon se kishte dashur të fuste në front njerëz nga klasa të tjera madje armiq të cilit nuk kishin qenë aktiv kundër tyre. Këto në punë neutrale dhe jo me rëndësi domethënëse për luftën. Këtu Sejfullai po rendit gabimet e tij. Dhe kryesorja është pranimi se mund të kishte një zgjerim për të bashkëpunuar me elementë të tjerë. Madje në fjalimin e tij më tej ai merr një shembull domethënës se si në atë vit të parë të pushtetit të Partisë komuniste ai kishte afruar njerëz nga kleri katolik duke menduar se ata kishin ndikim në popull dhe duke mbivlerësuar fuqinë e tyre. Ai thotë:

Gabimi më madh që unë e kam kuptuar me keq, ishte çështja me katolikët. Unë mendoja se kleri ishte kundra nesh perse ne mund të përfitonim nga ai, dhe i kisha frike se ai kish lidhje me masat. Unë nënvleftësoja armiqtë e tyre, s'mendoja dot kompletet etj. që ata po organizonin, kjo është! Pike! E dyta se unë vleftësoja shumë forcën e tyre edhe pse tani u pa se ata s'kanë qenë aq të fortë (AQSH, F.14. D1, f. 5)

Më tej një sërë funksionarësh të byrosë politike në fjalimin e tyre përkrahin pa asnjë rezervë mendimin e Enver Hoxhës, duke e akuzuar Sejfulla Malëshovës për oportunitizëm, madje sipas tyre Malëshova i kishte shtyre dhe një pjesë të tyre drejt këtij qëndrimi anti-parti. Tashmë partia do të kishte një qëndrim shumë më të ashpër ndaj grupeve

jo miqësore me të, si klerin, intelektualët e pavarur, industrialistët dhe kategori të tjera. Ndërsa me fshatarët dhe punëtorët të cilët, në përgjithësi nuk e kuptonin kompleksitetin e doktrinës marksiste, kjo parti do të kishte një rol përfundimisht udhëheqës. Kështu, dialektika çliruese që premtonte fillimisht doktrina komuniste u kthye në një realitet ku partia ishte një entitet i pagabueshëm, i fiksuar dhe formal. Individët qoftë dhe ata me pushtet duhet ti raportoheshin me besnikëri vijës së saj. Të kundërtat e saj nuk përdorëshin për ta përmirësuar atë, ashtu si dialektika kërkon, por duhet të mos ekzistonin. Për më tepër Malëshova në disa momente duket se e ka te paqartë ku ka gabuar një veprimtarinë e

tij. Kjo sepse linja e partisë apo vetë Partia nuk ishin një realitet konkret i lexueshëm. Ajo ishte transformuar në një ide abstrakte përmbajtja e së cilës ishte esoterike edhe për shumë prej udhëheqësve të cilët shpesh nuk e kuptonin ku kishin gabuar, dhe prisnin fjalët e Enver Hoxhës për të parë nëse kishin gabuar apo jo. Kjo krijonte një pasiguri të vazhdueshme e cila ushqente diktaturën dhe pushtetin e saj mbi individët. Shumë prej atyre që akuzuan Malëshovën në plenumin e pestë do të përfundonin dhe ata të internuar, në burg apo dhe më keq. Kjo në emër të një partie metafizike që sundonte mbi çdo aspekt të veprimtarisë individuale duke mohuar lirinë e çdo personi konkret nën pushtetin e saj.

REFERENCAT

- KQ. 1945. “Raporti i Plenumit të katërt të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste”, AQSH, F APOU/14, V 1945, D.2.
- KQ. 1946. “Kopje e daktilografuar e procesverbalit të Plenumit të V të KQ të PKSH”, AQSH, F APOU/14, V 1946, D.1.
- Malëshova, Sejfulla. 1945. “Mbi kooperativat”, *Gazeta Bashkimi*, 15 shkurt
- Shtylla, Medar. 1945. “Relacioni i Ministrisë të Ekonomisë, në konferencën e tregtarëve dhe të industrialëve”, *Gazeta Bashkimi*, 15 shkurt
- Boeselager, W. (1966). Soviet dialectical methodology. *Studies in Soviet Thought*, 6(2), 135-144.
- Kopnine, P. V. (1967). Dialectic and Logic. *Diogenes*, 15(60), 87-102.
- Lukács, G. (2017). Reification and the Consciousness of the Proletariat. In *Karl Marx* (pp. 3-25). Routledge.
- Narskii, I. (1981). Contradiction as a Category in Hegel's Science of Logic. *Soviet Studies in Philosophy*, 20(2), 28-50.

ABSTRACT

The Albanian left had an undeniable impact during World War II. It received support from social strata that believed in its promise of freedom and development. For communism, history was movement and change. At the core of history was change, not identity. In this way, the communists promised unprecedented changes in Albania. Dialectics enabled this as a social law and as an ideological tool for altering reality. Quickly, the communists' promise to change reality took the form of a dictatorship that denied any reasonable form of freedom. This paper aims to explore the possible reasons for this transformation. From the perspective of this paper, the communist dictatorship was not merely a detailed accident of a liberating ideology. Instead, it had its origins precisely in the inability of the power to use continuous dialectical categories and its need to define itself solely as a final, formal reality.

Keywords: *dialectics, Marxism, formal logic, dictatorship*

PODKASTI DHE KARAKTERISTIKAT E REJA MULTIMEDIALE NË SHQIPËRI

Valmora GOGO
Kolegji Universitar Bedër
E-mail: valmoragogo@gmail.com

Ermal SPAHIU
Kolegji Universitar Bedër
E-mail: spahiuermal12@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Ky studim konsiston në hulumtimin e praktikave që janë ndjekur në zhvillimin e podkasteve dhe eksplorimin e karakteristikave të tyre në hapësirën publike shqiptare. Metodot e përdorura në këtë studim janë: monitorimi i podkasteve, 11 intervistat gjysmë të strukturuar me ekspertë dhe drejtues podkastesh si dhe pyetësi online për audiencat, ku janë përgjigjur 135 të pyetur. Disa nga pyetjet kërkimore të ngritura në këtë studim janë: çfarë quajmë podkast dhe si mund ta dallojmë atë (1); pse podkasti mund të konsiderohet si një alternativë potenciale që audiencat të konsumojnë një përmbajtje më të personalizuar (2); a është podkasti modeli më praktik në të bërit gazetari dhe si mund të klasifikohet për audiencat (3); duke vlerësuar zhvillimet që ka pësuar media përmes teknologjisë, a është podkasti një dëshmi që praktika e komunikimit po kanalizohet përmes mediave sociale si një hapësirë ku informacioni filtrohet më shpejt (4) dhe (5) ku do të jetë e ardhmja e gazetarisë dhe e komunikimit në tërësi, në rast se podkasti vazhdon të krijojë popullaritet, në masë të barabartë me radion, televizionin si dhe shtypin e shkruar? Si përfundim rezultoi se podkasti, si ofertë e re mediatike ka revolucionarizuar mënyrën e të shprehurit (tregimin), duke çuar në gjenerimin e ideve novatore dhe nxitjen e të menduarit të lirë. Podkasti është gjeneruar dhe shpeshuar në Shqipëri për shkak të ridimensionimit të formave të komunikimit (audiencat janë në kërkim gjithnjë e më shumë të përmbajtjeve të formave me dinamikë të interaktivitetit, jashtë formave tradicionale audiovizive si televizioni) dhe formatit mediatik siç është radio (audiencat janë në kërkim të formave të komunikimit që ofrojnë një qasje personale në marrëdhënie me audiencën). Podkasti vizual ka bashkuar avantazhet e radios (komunikimi i personalizuar dhe liria) dhe avantazhet e televizionit (video), duke fituar hapësirë dhe në mediat sociale.

Fjalët kyçe: *Podkast, diskurs publik, komunikim multimedial, ndërveprim audiencash, zbanret mediatike*

Dr. **Valmora GOGO** është doktoruar në gazetari dhe komunikim masiv në vitin 2017 në Universitetin e Tiranës. Me një eksperiencë 20-vjeçare, ajo ka qenë pjesë e redaksive të mediave shqiptare si gazetare, redaktore dhe kryeredaktore. Në vitin 2021 Dr. Gogo ka themeluar platformën Gogo.al (www.gogo.al) një media online e fokusuar në gazetarinë investigative. Dr. Gogo është pjesë e stafit akademik të Kolegjit Universitar Bedër dhe ka botuar librin “Editoriali në shtypin shqiptar”.

Msc. **Ermal SPAHIU** është diplomuar për Shkenca Komunikimi në profilin Gazetari, duke përfunduar dy cikle studimi, Bachelor dhe Master Shkencor pranë Kolegjit Universitetit Bedër. Në përfundim të specializimit të tij ai u fokusua në realizimin e një teze studimore duke i dhënë vëmendje një nënloji të ri të medias dhe komunikimit në Shqipëri me titullin e plotë: “Ridimensionimi i Radios si medium në podkast dhe karakteristikat e reja multimediale në Shqipëri”.

Në pesë vitet e fundit, Shqipëria është vënë përballë një oferte të re mediatike, ku figura të rëndësishme publike por edhe individë të thjeshtë angazhohen në masë të madhe për t’i paraqitur audiencës një dritare komunikimi; podkastin. Përmbajtja karakterizohet në një format, ku në fokus është bashëbisedimi i lirë dhe qasja informale e tij. Nisur nga këto faktorë, ky studim merr përsipër të hulumtojë praktikën që janë ndjekur në zhvillimin e podkasteve dhe eksplorimin e karakteristikave të tyre në hapësirën publike shqiptare. Ja disa nga pohimet e të intervistuarve tanë:

Arben Muka, ekspert komunikimi e përshkruan podkastin si një produkt të tematizuar dhe ciklik, i pastrukturuar mediatikisht që u ofrohet ndjekësve në një shkallë më të gjerë përmes mediave sociale si “Instagram”, “Facebook”, “TikTok”, “Youtube”, “Twitter” dhe kudo ku ka audiencë aktive. “Është një përshtatje me peizazhin digjital të medias në tërësi. Fillimisht vjen si produkt audio, por që po vijohet tashmë edhe me produkte audio edhe me produkte audiovizive, podkastet po tërheqin vëmendjen e medias klasike, duke e promovuar si një kontribut efektiv për shpërndarjen e lajmeve, të analizave, të rrëmimit të botës së personazheve të rëndësishme, të kureshtjes, argëtimit e zbavitjes etj. etj.”, thotë ai (Muka, 2024).

Irena Myzeqari, po ashtu eksperte e shkencave të komunikimit, shpjegon se falë formave më të sofistikuara të komunikimit

është krijuar një hapësirë e rëndësishme, jo vetëm për shpërndarjen e informacionit por edhe të formësimit të mendimit duke nxitur audiencën të bëhet pjesë e diskursit publik. “Nga njëra anë, të mundëson të sqarosh në detaje tematika të caktuara..., por...rrit në mënyrë të ndjeshme fragmentarizimin e audiencës”, thekson ajo (Myzeqari, 2024)

Ditmir Bushati që drejton podkastin “Public Square” me në fokus politikën, mendon se ky medium “nuk mund të quhet domosdoshmërisht më popullor se të tjera forma të medias dhe komunikimit, por është një mënyrë efektive për të diskutuar dhe analizuar një fenomen apo politikë të caktuar në mënyrë kritike, çfarë në të shumtën e rasteve i mungon medias tradicionale” (Bushati, 2024).

Ndërkaq, Anila Prethi, drejtuesja e “EchoPodcast” sqaron se “një nga faktorët kryesorë të popullaritetit të podkasteve është larmia e tematikave që përdoren në intervista apo diskutime me të ftuarit.”. Sipas saj faktori i dytë është edhe aksesimi që të jep podkasti për ta dëgjuar në platforma të ndryshme, duke shtuar se “...ai shfaqet i pacensuruar, i vërtetë dhe i përcaktuar për llojin e audiencës” (Prethi, 2024). “Podkastin mund ta përdorë kushdo, thjesht të duhet një mikrofon, një kamerë laptopi dhe të shkarkosh një kanal në “Youtube” pa pagesë, njëjtë si në Facebook dhe Spotify. Nuk ka asnjë kosto dhe kjo e bën podkastin të fitojë popullaritet”, tregon Alice Taylor, e cila drejton podkastin “Inside Albania” në televizionin “Euronews Albania”. (Taylor,

2024). Kurse Ilir Karabrahimi, një nga drejtuesit e podkastit “Table Talk”, thotë se: “Lidhja e podkastit me audiencën mund të jetë efikase në përcjelljen e mesazhit për shkak të natyrës së tij intime dhe personalizimit të përmbajtjes për dëgjuesit. Podkastet në Shqipëri shpesh herë ofrojnë përvojë dëgjimi më të thellë dhe më të përgjegjshme, duke lejuar për një lidhje më të ngushtë me audiencën të ndryshme” (Karabrahimi, 2024).

Anila Hoxha, gazetaria e Top Channel që drejton podkastin “Fol me Anilën” thotë se podkasti e ka ndihmuar të njohë në themel çdo fenomen shqetësues, i cili nuk ka marrë trajtimin e duhur më herët (Hoxha, 2024).

Gazetarja Rose Laedem tregon se “gati 68 milionë qytetarë amerikanë janë ndjekës të rregullt të podkastit dhe nëse marrim për bazë statistikën, një në katër persona. Në këtë hulumtim, rezultoi se pjesa më e madhe e këtij numri, i përkiste kryesisht moshave të reja, 18 deri në 34 vjeç, në masën 44%” (Laedem, 2017). Nic Newman dhe Nathan Gallo kanë zbuluar se “shumë prodhues janë fokusuar në lundrimet të thella me një temë të vetme”, të cilat luajnë me pikat e tyre të forta në analizë dhe shpjegime. Gazetarët e shtypit i kanë përqafuar me entuziazëm këto forma të reja të tregimit, duke i gjetur ato një shtesë të natyrshme për rrjedhat ekzistuese të punës (Newman & Nathan, 2019).

Metodologjia, pyetjet kërkimore dhe hipotezat

Duke u mbështetur në një monitorim 3-mujor është identifikuar numri i podkasteve që realizohen në Shqipëri, shoqëruar dhe me një analizë të detajuar. Ndër metodat e përdorura përveç monitorimit janë: 11 intervistat gjysmë të strukturuar me ekspertë dhe drejtues podkastesh si dhe pyetësi online për audiencat, ku janë përgjigjur

135 përgjigjedhënës. Në këtë studim janë ngritur pyetjet kërkimore:

- 1 Çfarë quajmë podkast dhe si mund ta dallojmë atë?
- 2 Duke vlerësuar angazhimin e medias për një gazetari cilësor, pse podkasti mund të konsiderohet si një alternativë potenciale për të konsumuar një përmbajtje më të personalizuar?
- 3 A është podkasti modeli më praktik në të bërit gazetari dhe si mund të klasifikohet për audiencën?
- 4 Duke vlerësuar zhvillimet që ka pësuar media përmes teknologjisë, a është podkasti një dëshmi që praktika e komunikimit po kanalizohet përmes mediave sociale si një hapësirë ku informacioni filtrohet më shpejt?
- 5 Ku do të jetë e ardhmja e gazetarisë dhe e komunikimit në tërësi, në rast se podkasti vazhdon të krijojë popullaritet, në masë të barabartë me radion, televizionin si dhe shtypin e shkruar?

Dy hipotezat e studimit janë:

(H1) Podkasti, si ofertë e re mediatike ka revolucionarizuar mënyrën e të shprehurit (tregimin), duke ofruar një platformë unike, e cila nxit shprehjen kreative dhe inkurajon pranimin e perspektivave të ndryshme, duke çuar në gjenerimin e ideve novatore dhe nxitjen e të menduarit të lirë.

(H2) Podkasti është gjeneruar dhe shpeshuar në Shqipëri për shkak të ridimensionimit të formave të komunikimit (audiencat janë në kërkim gjithnjë e më shumë të përmbajtjeve të formave me dinamikë të interaktivitetit, jashtë formave tradicionale audiovizive si televizioni) dhe formatit mediatik siç është radio (audiencat janë në kërkim të formave të komunikimit që ofrojnë një qasje personale në marrëdhënie me audiencën). Podkasti vizual ka bashkuar avantazhet e radios (komunikimi i personalizuar dhe liria) dhe avantazhet e televizionit (video), duke fituar hapësirë dhe në mediat sociale.

Gjetjet nga monitorimi

Nga monitorimi gjatë periudhës mars-maj 2024 rezulton se në Shqipëri realizohen 44 podkaste, duke u vënë re një numër i konsiderueshëm podkastesh në fusha si politika, kultura, sporti, shëndetësia, rinia,

investigimi, barazia gjinore, drejtësia, sipërmarrja etj. Një pjesë prej këtyre podkasteve realizohen brenda televizioneve si: “A2 CNN”, “Euronews Albania”, “Top Channel”, “Syri Televizion” etj., duke bërë që këto televizione të brendësojnë formatet e komunikimit të lirshëm.

Tabela 1: Disa nga podkastet ekzistuese në Shqipëri, ndarë në kategori, profile dhe drejtuesit e tyre

Emri i Podkastit	Drejtuesi	Përmbajtja	Profili i drejtuesit të podkastit
		POLITIKANË	
Flasim	Edi Rama	https://open.spotify.com/show/3fs45SbLc1Moau7f0dDmP2	Kryeministër i Shqipërisë
Public Square Podkast	Ditmir Bushati	https://open.spotify.com/show/0dAJVvpZuGIXisLoeL3UaU	Deputet, Ish minister
GaldiniCast	Arian Galdini	Të fokusuar në Facebook, link nuk ka.	Kryetar i Lëvizja e Re
		GAZETARË	
Zë me Mirën	Mira Kazhani	https://open.spotify.com/show/57q7lsftruhvc1hhvdk7e	Gazetare
Table Talk	Roden Hoxha	https://youtu.be/vd4b5pmbily?si=npdu1ocp7rqglxt6	Drejtor ekzekutiv pranë Qendrës Shqiptare për Gazetari Cilësore
Fol Me Anilën	Anila Hoxha	https://podcasts.apple.com/us/podcast/fol-me-anila-hoxh%C3%abn/id1713219382	Gazetare e Top Channel
GogoCast	Valmora Gogo	gogo.al	Gazetare
Gen Z Podkast	Ermelinda Ndoja	pozitivi.org	Gazetare e Tv Klan
Anja Podkast	Anja	https://www.instagram.com/anja.podkast?igsh=MXhheE4yejZ1M2xsOQ==	Pamfleti
Sol89Radio	Vjola Gremi & Egon Loli	https://www.instagram.com/sol89radio?igsh=MË9heXYeYTA0Zm11Më==	Gazetarë
EchoPodkast	Anila Prethi	https://www.youtube.com/@EchoPodkast-93	Specialiste e Marrëdhënieve me Publikun dhe Gazetare
Citizens Podkast	Erisa Kryeziu	Facebook, Instagram	Gazetare e Citizens al
Klo's Friends	Klotilda Harka	https://www.youtube.com/watch?v=2kjrkh6x-u	Gazetare
Elefanti Podkast	Ervin Qafmolla	Instagram	Pjesë e televizionit A2 CNN
Faktoje	Klodiana Kapo	https://www.facebook.com/share/r/VË643XodBwMg3yUn/?mibextid=oFDknk	Gazetare e organizatës mediatike shqiptare për verifikimin e fakteve

NTV Podkast	Eriselda	https://www.youtube.com/c/ntvtelevizion	Gazetare
		PREZANTUES/ MODERATORË	
Inspire PodKlas	Alketa Vejsiu	https://www.youtube.com/playlist?list=PL4zIEHFqKjTLcEXhECAhL3YUjBëANë	Prezantuese/ Moderatore në TV Klan
Jonida Podkast	Jonida Shehu	https://youtu.be/fg6X7thVqaw	Moderatore në Top Channel
Piranj'Cast	Florjan Binaj	https://www.youtube.com/watch?v=jo9gcnmaua	Moderator në Syri TV
Me Dojnë	Dojna Mema	https://www.instagram.com/medojnen/	Moderatore në Syri TV
Inside Albania	Alice Taylor	https://www.youtube.com/ëatch?v=oicYUËJthmM&ab_channel=EuroneësAlbania	Moderatore në Euroneës Albania
Busulla Podkast	Dritan Idrizi	https://www.youtube.com/@busullapod	Pedagog në Universitetin Europian të Tiranës
Tipar Zanor	Elios Kovaçi	https://www.youtube.com/@TiparZanor	Arkitekt
Mbn Podkast	Matias Ndini	https://www.youtube.com/watch?app=desktop&v=pk-4sqrzhk0	Drejtor filmi
Me Kast	Megi Pojani	https://www.youtube.com/	Moderatore në Top Channel
		KËNGËTARË	
Garage Lock	Renis Gjoka & Eugent Bushpepa	https://www.youtube.com/channel/ucv0qckafq-9cëxndju3uëla	Këngëtarë
Rapshtet Podkast	Big Basta	https://www.facebook.com/share/v/ZwVdzgZXzbTfrAkk/?mibextid=ë8EBqM	Këngëtar
		TEOLOG	
Podkast me Elvis Naçin	Elvis Naçi	https://www.instagram.com/reel/C4nTIFXobwF/?igsh=MWk5dXR4dëV4MDfNg==	Imam dhe ligjërues ne Xhaminë e Tabakëve
		LËVIZJE	
Hijet e Fshehura të Feminizmit	Irena Muzeqari & Valbona Sulçe	https://www.youtube.com/watch?v=VWdK3wBS4E8	Inicuese për çështjet e grave
ShpresOn	Altin Goxhaj	Facebook	Avokat
		SIPËRMARRËS	
Supervlera Podkast	Eglent Bici	https://www.youtube.com/channel/UC2pëNQDvQHqCJev-YVKalDA/videos	Sipërmarrës
40 under 40	Bloconomy	https://www.youtube.com/watch?v=10J-Y0bmwFU&t=2013s	Mbështet dhe promovon sipërmarrësit e rinj
Shqiptarët nëpër botë	Blerta dhe Endrit	Nuk rezulton as në Instagram dhe as në Youtube	Kontribues në Business Magazine

		SPORTISTË	
Shah Mat Podkast	Nailir Piri	https://www.youtube.com/channel/UC6dvi8Sg_pGtuXmVgv9oUkQ	Peshëngritës
Soçer Talk Podkast	Skënder Gega	https://www.youtube.com/channel/UCUc2U-	Trajner futbollit
Pjesa e tretë	Andi Kasmir	https://www.instagram.com/pjesaetrete/	Gazetar
Versus Telesport	Denis Hakanaj	Facebook	Gazetar
		TË RINJTË	
N'Rini	Xhensila Sulejmani	https://nrini.al/	Menaxhere mediash sociale, moderuese
Podkast "Your Health Your Choice. Do It Right"	Të rinjtë	https://www.facebook.com/share/v/j4pGbs2CzjN1PHy/?mibextid=è8EBqM	Studentë
		KOMUNITET	
N'kub Podkast	Meti, Sami, Tadi	https://www.instagram.com/reel/Cz9UgYJtY27/?igsh=MTMxNjJxdHk2djg3bQ==	Qytetarë të komunitetit
		MJEDISI	
Ëild Life (Jetë e Egër)	PPNEA	https://ppnea.org/podkast/	Organizatë mjedisi
		DOKTORË	
Podkast me Doktorin	Gentjan Asllanaj	https://www.instagram.com/reel/C5EYRPZKbNE/?igsh=ajFvdGVtbGM1YËlv	Psikiatër, Pedagog
Quantum Satis Podkast	Arbi Mulhaxhia & Arjon Bajramaj	https://www.instagram.com/quantumsatis.podkast/?igsh=MXVuNH Rtc3Q4NjJoYg%3D%3D	Këshillues për shëndetin
		ORGANIZATË	
GenJustice Podkast	Elsa Albania	https://www.instagram.com/p/C5-00pIt1mb/?igsh=b3kyanIxN3B1aWMz	Në bashkëpunim me Qëndresa Qytetare

Gjetjet e pyetësorit me audiencat

Nga rezultatet e disa pyetjeve më kryesore në këtë studim është kuptuar që shumica e pjesëmarrësve kanë faktuar interesin e tyre në masën 91.1% për ndjekjen e përmbajtjeve që ofron podkasti. Ajo që shihet gjithashtu në analizën e të dhënave është se podkasti nuk pritet si përmbajtje me prioritet nga audiencia, por si një alternativë potenciale për të zhvendosur fokusin e informacionit në një

përmbajtje më të thjeshtëzuar.

Nga tabela 2 (n = 135) del qartë interesi masiv të audiencës për të ndjekur një podkast, ku pjesa dominuese shkon në 91.1%. Në pyetjen se çfarë lloj podkasti ndjekin kryesisht të anketuarit, me video apo audio, pjesa më e madhe e tyre në masën 67.4% kanë thënë se e ndjekin podkastin me audio dhe figurë, pjesa tjetër në masën 19.3% e ndjekin vetëm përmes figurës, ndërsa 13.3% e konsumojnë këtë përmbajtje përmes dëgjimit në versionin

Tabela 2: *A keni ndjekur ndonjëherë një podcast dhe të çfarë lloji?*

A keni ndjekur ndonjëherë një podcast?	Përgjigjet e marra (në %)		Ç'lloj podcasti ndjekin kryesisht?
Po, kam ndjekur	91.1	67.4	Me audio
Jo, nuk kam ndjekur	7.9	19.3	Me figurë
Nuk di çfarë është podcast	1.0	13.3	Të dyja bashkë
Gjithsej	100.0	100.0	Gjithsej

Tabela 3: *Ku e ndiqni më shumë podcastin?*

Ku e ndiqni më shumë podcastin?	Përgjigjet e marra (në %)		Si e ndiqni podcastin kryesisht?
Youtube	52.6	36.3	Të plotë
Instagram	20.0	63.7	Vetëm disa pjesë
Facebook	17.0	=	=
Të tjera (Spotify, Tiktok etj.)	10.4	=	=
Gjithsej	100.0	100.0	Gjithsej

audio. Sipas tyre kjo lehtëson përpjekjen e tyre për të kuptuar qartësisht mesazhin e dhënë nga personazhi. Këto të dhëna vërtetojnë rëndësinë e një podcasti në formatin audio dhe video, në të cilin audiencia ka mundësinë të ndjekë, si mesazhin ashtu dhe personazhin përmes kombinimit audio dhe figurë.

Në pyetjen se në cilat media sociale të anketuarit ndjekin podcast, pjesa më e madhe në masën 52.6% kanë thënë se e ndjekin në kanalën e "Youtube", 20% kanë thënë se e ndjekin në profilet e tyre në "Instagram", 17% kanë thënë se e ndjekin në profilet e tyre në "Facebook", 4.4% kanë thënë se dëgjojnë podcast vetëm me audio në platformën "Spotify".

Nga të dhënat e tabelës 3 mbi interesin e audiencës se në cilën platformë e ndjekin më së shumti podcastin, del se dominon "Youtube".

Kur janë pyetur nëse të anketuarit i ndjekin podcastet të plota apo të servitura në rrjete sociale në video të shkurtra, pjesa më e madhe në masën 63.7% kanë thënë

se ndjekin fragmente në video të shkurtra, ndërsa pakica në masën 36.3% kanë thënë se e ndjekin përmbajtjen të plotë.

Një nga pyetjet në pyetësor ka patur si qëllim kuptimin e aftësisë dalluese të audiencave, se çfarë e diferencon një podcast politikani nga ai i një gazetari. Disa nga shpjegimet që jep audiencia janë listuar në tabelën më poshtë.

Në një nga pyetjet më të rëndësishme të pyetësorit, atë të lidhur me tematikën e podkasteve që preferojnë, vëmë re këtë rezultat: Pjesa më e madhe, në masën 23.7%, kanë thënë se priren të ndjekin tema të aktualitetit, ndjekur nga një tjetër pjesë e konsiderueshme me një diferencë minimale (në masën 19.3%) të cilët janë të prirur të ndjekin tema që i përkasin stilit të jetesës. Ndërkaq, kategoritë e tjera vijojnë: 9.6% ndjekin tema që i përkasin shkencës dhe teknologjisë, 8.9% që ndjekin tema të udhëtimeve; 10.4% që ndjekin tema që i përkasin artit; 8.1% ndjekin tema që i përkasin shëndetit; ndërsa në masë minimale,

Tabela 4: *Mendimet e të anketuarve mbi ndryshimin e podkastit të një politikani nga ai i një gazetarit*

PODKASTI I POLITIKANIT	PODKASTI I GAZETARIT
Nuk ka aftësitë e një gazetari në këtë fushë	Nga tematikat që hapin
Nga tematikat që hapin	Janë më të sinqertë krahasuar me politikanët
Nuk ke çfarë u ndjek më.	Objektiviteti dhe larmishmëria
Objektiviteti dhe larmishmëria	Janë të detyruar të ndjekin censurën
Më pak formal	Pasqyron realitetin dhe të synojë drejt vlerave.
Përshtatet sipas interesave të tij politike.	Ka aftësinë të jetë më neutral dhe të trajtojë një temë në të gjitha aspektet..
Ka tendencën të jetë i njëanshëm dhe shpesh ndjek interesin vetjak.	Mund të ftojë këdo që e sheh të përshtatshëm për temën.
Është i kufizuar tek personazhet që fton.	Profesionist dhe ndjek interesin e audiencës
Po nis të kopojë gazetarin dhe kjo e bën të ngjashëm me të.	Informojnë/ Kanë motiv të tyre edukimin.
Ka propagandën dhe artin e manipulimit të mendjes së njerëzve.	Informon.
Advokon.	Formimi dhe audiencia.
Pririje të politikës të cilën bën dhe përfaqëson.	I prirur në shumë drejtime dhe fusha të ndryshme.
Njerëzit janë të brishtë përpara tyre.	Zbulon imazhin e personit që interviston.
Qëllimi dhe drejtimi.	E diferencon manipulimi nga politikani.
Nuk është i specializuar.	Ka bazat e gazetarisë
Ka për qëllim rregullimin e imazhit.	Më profesionist
Fokuset më shumë në promovimin e ideologjive dhe perspektivave politike personale.	Synon të komentojë objektivisht ngjarje nga jeta me ekspertë dhe persona të njohur.
Përkrahje politike për të ndikuar tek audiencia.	Informon dhe promovon te audiencia.
Propaganda.	E vërteta.
PR më të mirë për veten	Më i shtë në atë çfarë transmeton
I lexueshëm në qëllimin e tij, nuk është gjithmonë e mira publike	Neutral në mendime dhe gjykime që mund të ketë rreth pyetjeve që i drejtohen të ftuarit apo ndaj përgjigjeve që mund të marrë mbrapsht prej tij.
Njëanshmëria.	Hulumton
Mundohet të tregohet neutral, por sërish ndjek interesat personale	Servirja e informacionit
Marketim interesh personale dhe partiake	Më pranë përditshmërisë
Shihet në çdo rast si i tillë dhe nuk bie ndesh në asnjë rrethanë të pozicionit të tij për të bërë pastër gazetarin me pyetje.	Është në misionin e tij në funksion të informimit të publikut.
E shfrytëzon për fushatë.	Personazhi
E bën për interesat e veta	50% për pronarin, 50 për vlera.
Duan të përvetësojnë një profil që nuk iu përket, si gjithmonë kopjues, ndjek ambicien	Qëndron gjithmonë neutral
Sharlatanizmi	Profesionalizmi
Manipulojnë realitetin	Pasqyrojnë emocionin e realitetit.

Tabela 5: *Tematika e preferuar e podkastit*

Ku e ndiqni më shumë podkastin?	Përgjigjet e marra (në %)
Tema të aktualitetit	23.7
Tema të stilit të jetesës	19.3
Shkencë/teknologji	9.6
Udhëtime	8.9
Art	10.4
Shëndeti	8.1
Të tjera (showbizzit, politikës, historive aktuale nga jeta e njerëzve, familjes dhe besimit shpirtëror, vlerës dhe eksperiencës, psikologjisë, jetërrëfimit, prindërimit, sportit, biznesit dhe sipërmarrjes)	20.0
Gjithsej	100.0

të anketuarit të tjerë kanë zgjedhur tema që i përkasin showbizzit, politikës, historive aktuale nga jeta e njerëzve, familjes dhe besimit shpirtëror, vlerës dhe eksperiencës, psikologjisë, jetërrëfimit, prindërimit, sportit, biznesit dhe sipërmarrjes.

Përfundime

Nga analiza e gjetjeve në këtë studim arrihet në konkluzionin se fryma e podkastit po ia del të rigjenerojë ide të reja për mënyrën se si mund të përmirësohet komunikimi mes prodhuesve të përmbajtjeve mediatike dhe audiencave, të cilat po ashtu mund të jenë edhe vetë prodhues përmbajtjesh. Karakteristikat e reja multimediale, duke marrë në konsideratë zhvillimet e teknologjisë dhe angazhimin e televizioneve, mediave të vogla si dhe individëve, janë një dëshmi se iniciativa të tilla mbajnë të aktivizuar

audiencën që të përqëndrohet tek një përmbajtje më e personalizuar, e specifikuar dhe e fragmentarizuar. Si përfundim rezulton se podkasti, si ofertë e re mediatike ka revolucionarizuar mënyrën e të shprehurit (tregimin), duke çuar në gjenerimin e ideve novatore dhe nxitjen e të menduarit të lirë. Podkasti është gjeneruar dhe shpeshuar në Shqipëri për shkak të ridimensionimit të formave të komunikimit (audiencat janë në kërkim gjithnjë e më shumë të përmbajtjeve të formave me dinamikë të interaktivitetit, jashtë formave tradicionale audiovizive si televizioni) dhe formatit mediatik siç është radio (audiencat janë në kërkim të formave të komunikimit që ofrojnë një qasje personale në marrëdhënie me audiencën). Podkasti vizual ka bashkuar avantazhet e radios (komunikimi i personalizuar dhe liria) dhe avantazhet e televizionit (video), duke fituar hapësirë dhe në mediat sociale.

REFERENCAT

- Bushati, D. (2024). "Mbi podkastin si medium i ri në media"; Intervistues: E. Spahiu & V. Gogo, Tiranë.
- Hoxha, A. (2024). Mbi podkastin si medium i ri në media; Intervistues: E. Spahiu & V. Gogo, Tiranë.
- Karabrahimi, I. (2024). Mbi podkastin si medium i ri në media; Intervistues: E. Spahiu & V. Gogo, Tiranë.
- Laedem, R. (2017, December 23). Ent

- erpreneurtps://www.google.com/search?q=laedem%2C+r.(2017%2C+december+23).+entrepreneur.&coq=&gs_lcrp=EgZjaHJvbWUqCQgAECMYJxjqAjIjCAAQIxgnGOoCMgkIA RAjGCcY6gIyCQgCECM YJxjqAj IJCAMQIxgnGOoC MggIBBAjGCcY6gIyC QgFEC4YJxjq AjIJCAYQI xgnGOoC MggIBxAjGCcY6gLSAQkxNzII MmowajeoAgiwAgE&sourceid=chrome&ie=UTF-
- Muka, A. (2024). Mbi Podkastin si medium i ri në media Intervistues: E. Spahiu & V. Gogo, Tiranë.
- Myzeqari, I. (2024). Mbi podkastin si medium i ri në media Intervistues: E. Spahiu & V. Gogo, Tiranë.
- Newman, Nick & Gallo, Nathan. (2019, December), News Podcasts and the Opportunities for Publishers; https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/sites/default/files/2019-12/Newman_Gallo_podcasts_FINAL_WEB_0.pdf
- Prethi, A. (2024). “Mbi podkastin si medium i ri në media”; Intervistues: E. Spahiu & V. Gogo, Tiranë.
- Taylor, A. (2024). “Mbi podkastin si medium i ri në media”; Intervistues: E. Spahiu & V. Gogo, Tiranë.

ABSTRACT

This study consists in the research of the practices that were followed in the development of podcasts and the exploration of their characteristics in the Albanian public sphere. The methods used in this study are: podcast monitoring, 11 semi-structured interviews with experts and podcast hosts, as well as an online audience questionnaire, where 135 questions were answered. Some of the research questions raised in this study: 1. What is a podcast and how can we distinguish it? 2. Why can podcasts be considered a potential alternative for audiences to consume more personalized content? 3-Is the podcast the most practical model in doing journalism and how can it be classified for audiences? 4-Assessing the developments that the media has undergone through technology, is the podcast a proof that the practice of communication is being channeled through social media as a space where information is filtered more quickly? 5- Where will be the future of journalism and communication, if the podcast continues to create popularity, to an equal extent with radio, television and the press? As a conclusion, it turns out that the podcast, as a new media offer, has revolutionized the way of expression (storytelling), leading to the generation of innovative ideas and the promotion of free thinking. The podcast has been generated and frequented in Albania due to the re-dimensioning of the forms of communication (audiences are increasingly looking for content in dynamic forms of interactivity, outside traditional audiovisual forms such as television) and media formats such as radio (audiences are in search for forms of communication that provide a personal approach to the relationship with the audience). The visual podcast has combined the advantages of radio (personalized communication and freedom) and the advantages of television (video), gaining space in social media as well.

Keywords: *Podcast, Public Discourse, Multimedia Communication, Audience Interaction, Media Genres*

GJENERATA E DYTË E EMIGRACIONIT DHE PERSPEKTIVAT E REJA EDUKUESE

Edlira BEJKO

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"

E-mail: e.bejko@unizkm.al

PËRMBLEDHJE

Gjenerata e dytë e emigracionit përfaqëson *de - jure* dhe *de - facto* konsolidimin e emigracionit në vendin pritës. Prezenca e fëmijëve të emigrantëve në shkollë, në territor, në mjedise dhe aktivitete të përbashkëta me moshatarët e tyre vendas detyrimisht sinjalizon nevojën për rishikimin e modeleve edukuese monokulturore të cilat rezultojnë të pamjaftueshme për të përfaqësuar pluralizmin kulturor në shoqëritë perëndimore. Si rrjedhojë e fenomenit të emigracionit, prezenca e brezit të dytë të emigracionit përkon me një stad të caktuar të zhvillimit ekonomik, politik dhe social të vendit pritës dhe lidhet me zhvillimin e modeleve të reja edukuese në të gjitha mjediset arsimore. Emigrantët e gjeneratës së dytë janë përfaqësuesit më ekzemplar të botës që ndryshon me ritme shumë të shpejta dhe simbolizojnë urat lidhëse ndërmjet modeleve edukuese të vendit të origjinës dhe vendit pritës. Edukimi ndërkulturor fillimisht i lindur si përgjigje ndaj nevojave gjuhësore të nxënësve të huaj, me kalimin e kohës mori trajtat e një reflektimi të ri pedagogjik, i cili e vendos diversitetin, në qendër të zhvillimit të teorive të reja edukuese. Edukimi ndërkulturor sot përfaqëson një mendësi edukuese në shoqërinë multikulturore dhe përfshin të gjithë faktorët dhe aktorët në ndërveprim dinamik për një kohezion social më të gjerë. Ky artikull ka për qëllim të analizojë disa karakteristika të përgjithshme të brezit të dytë të emigrantëve, sfidat me të cilat përballen në rritjen dhe edukimin e tyre midis dy botëve të përkatësisë dhe nevojën për rishikim të vazhdueshëm të modeleve edukuese në shoqërinë e sotme globale.

Fjalë kyçe: *emigrantë, gjenerata e dytë, edukim, identitet, gjuhë.*

Edlira BEJKO është pedagoge e gjuhës dhe kulturës italiane me kohë të plotë pranë Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", është anëtare e Qendrës Kërkimore për Shkencat Humane (CRISU), - UKZKM, eksperte në fushën e edukimit ndërkulturor dhe me një përvojë 15 vjeçare në fushën e emigracionit: është autore e shumë artikujve shkencorë brenda e jashtë vendit. Doktorante në Pedagogji pranë Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë - Universiteti i Tiranës.

Emigrantët e brezit të dytë – panoramë e përgjithshme

Studimet në fushën e emigracionit e konsiderojnë prezencën e gjeneratës së dytë të emigracionit si konsolidim të emigracionit në vendin pritës. Kësaj, është e rëndësishme të shqyrtohet profili i përgjithshëm i këtij grupimi, karakteristikat dhe nevojat e tyre, roli që mbartin në dinamikën e proceseve migratore dhe në zhvillimin e modeleve të reja edukuese. Cilët janë emigrantët e brezit të dytë dhe çfarë përfaqësojnë ata?

Emigrantët e brezit të dytë, janë ata të rinj që jetojnë kryesisht procesin e rritjes dhe të formimit në mes të dy botëve, botës së familjes dhe atë të shoqërisë, botë që ndryshojnë për nga modelet edukuese, vlerat, normat, traditat, mënyra e jetesës, besimi fetar dhe gjuha. Rritja dhe edukimi i tyre qëndron dhe ndërtohet midis botës së vendit të origjinës dhe të vendit pritës. Emigrantët e brezit të dytë, të lindur apo të ardhur në vendin pritës në moshë të re janë përshkruar shpesh si *"pezull"* mes dy botëve dhe dy kulturave, edhe në rast kur nuk kanë jetuar asnjëherë ose shumë pak në vendin e origjinës. Emigrantët e brezit të dytë mund të konsiderohen si pjesë e kulturës dhe e modeleve edukuese të vendit të origjinës duke pasur parasysh vazhdimësinë dhe lidhjet historike me vendin e origjinës së prindërve, ose mund të konsiderohen si pjesë e kulturës së vendit pritës, duke u fokusuar në të tashmen dhe duke shpresuar në suksesin e një procesi edukues ndërkulturor për t'u anëtarësuar dhe integruar në një mjedis të ri shoqëror. Secila prej këtyre pozicioneve mbetet e diskutueshme pasi e vendos emigrantin në *"kufij"* dhe ndonjëherë duket sikur e përjashton nga njëra prej dy botëve mes të cilave ai gjendet. Sipas Rekomandimit të Këshillit të Evropës (Consiglio d'Europa, 1984), termi *"Gjenerata e Dytë e Emigracionit"*, përfshin kategoritë e mëposhtme:

- fëmijët e lindur në vendin ku kanë emigruar prindërit;
- fëmijët e emigruar bashkë me prindërit;
- fëmijët të cilët janë bashkuar me prindërit në vendin pritës, si rezultat i bashkimit familjar, pas një periudhe emigrimi të njërit ose të dy prindërve.

Shënim: (Ky rekomandim vë në dukje se fëmijët e emigrantëve që kanë kryer në vendin e emigracionit vetëm një pjesë të arsimimit apo të formimit profesional mund të futen në mënyrë të kufizuar në kategorinë 1.5 të gjeneratës së dytë).

Pra, edukimi, rritja dhe formimi i emigrantëve të brezit të dytë në vendet pritëse të emigracionit kalon nëpërmjet dinamikave dhe proceseve të ndërlikuara. Një pjesë e edukimit dhe socializimit primar të tyre është e lidhur dhe kontekstualizuar me gjuhën e origjinës, marrëdhëniet familjare dhe modelet shoqërore të vendit të origjinës ndërsa socializimi dytësor i tyre realizohet kryesisht nëpërmjet gjuhës së vendit pritës dhe bashkëveprimit me moshatarët dhe mësuesit e këtij vendi, ku ata zhvillojnë aftësi të veçanta për të vepruar dhe ndërvepruar brenda kontekstit specifik. Të dyja socializimet influencojnë paralelisht në formimin e personalitetit të tyre. Në këtë kuadër pedagogjia ndërkulturore merr një rol shumë të qenësishëm në edukimin dhe formimin e emigrantëve të brezit të dytë e cila shihet si perspektivë edukuese që reflekton mbi tematikat specifike që lidhen me marrëdhëniet midis kulturave. Në ditët e sotme Pedagogjia Ndërkulturore përfaqëson kërkimin/gjetjen e modeleve edukuese të perceptuar si reflektim, (*si teori*) dhe njëherazi zbatimin e modeleve edukuese dhe specifikat e subjekteve për të edukuar (*si praktikë*).

Gjenerata e dytë e emigracionit – përkufizimet kryesore

Termi "gjenerata e dytë" është një emërtim që përfaqëson një koncept shumë të gjerë, të shtrirë në kohë dhe në vende

të ndryshme të botës dhe simbolizon rrugëtimet, trajektorët dhe historitë e emigracionit së fëmijëve të emigrantëve. Është një emërtim që gjendet shpesh në fushën e emigracionit dhe për karakteristikat komplekse që mbart nuk mund të përmbledhet në një përkufizimi të vetëm. Ky term, në krye të herës u përdor nga studiuesit amerikanë të Shkollës së Çikagos në studimet e tyre në fillim të shekullit të 20-të. Autorët William dhe Znaniecki (1918-1920) janë sociologët që përdorën për herë të parë këtë term për të identifikuar gjeneratën e dytë të emigrantëve si subjekt studimi; sociologët studiuuan fëmijët e emigrantëve në Shtetet e Bashkuara të ndarë në dy kategori: fëmijët që lindën në tokën amerikane dhe ata që erdhën në moshën shkollore ose parashkollore në ShBA (William & Znaniecki, 1927).

Pas Luftës së II-të Botërore, ky term haset dhe përdoret edhe në Evropë, sigurisht me ngjyrimë të tjera për shkak të karakteristikave të ndryshme të procesit migrator dhe kushteve të caktuara historike (Zanfrini, 2004).

Analizat dhe diskutimet në nivel ndërkombëtar mbi këtë temë vazhdojnë të zhvillohen dhe ndryshojnë në varësi të kohërave dhe konteksteve. Disa nga studimet më të rëndësishme që përmenden në literaturën shkencore janë studimet e kryera në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga A. Portes dhe R. Rumbaut (2001), në Evropë nga E. Seifert, M. Crul, M. Tribalat, J. Veenman dhe së fundmi studimi i R. Aparicio Gómez.

Sot, në literaturën e fushës termi “gjenerata e dytë” është zëvendësuar dhe shtjellohet me emërtime të tjera dhe përkufizime të reja. Për të përcaktuar të rinjtë me origjinë emigrante, hasen termat “post emigrantër” (Zoletto, (2012), “gjenerata e pavullnetshme” (Jelloun, 1997), “gjenerata që pason” (Barbagli & Schmoll, 2011), “gjenerata e përzier” (Caneva, 2011), “gjenerata e urës” (Besozzi, Colombo &

Santagati, 2009), “gjenerata në lëvizje” (Cacciavillani & Leonardi, 2007), apo “të rinjtë nga tokat e ndërmjetme” (Favaro, 2004). Të gjithë këto emërtime, nga pikëpamja semantike tregojnë dinamikën dhe kompleksitetin e emigracionit dhe në mënyrë të veçantë tiparet dalluese të kësaj gjenerata që ndryshon dhe evoluon pa rreshtur.

Në kontekstin amerikan, studimi i sociologëve Portes dhe Rumbaut, i realizuar nëpërmjet projektit CILS, Children of Immigrants Longitudinal Study (Portes, Rumbaut, & Legacies, 2001), njihet si referencë shkencore në fushën e studimeve migratore. Humultiimi vendos në fokus moshën e fëmijëve të emigrantëve në momentin e mbërritjes në vendin e emigracionit - Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Moshë që ata kanë kur arrijnë në vendin pritës dhe përballen në vetë të parë me eksperiencën migratore, përbën elementin kryesor në rrugëtimin e tyre të emigracionit. Sociologu Ruben G. Rumbaut, për arsye studimore, e kategorizon brezin e dytë në pesë grupime:

Gjenerata 2.5 – përfshin fëmijët e çifteve të përziera;

Gjenerata 2.0 - përfshin fëmijët që kanë lindur në vendin e emigracionit të prindërve të tyre;

Gjenerata 1.75 - përfshin fëmijët që emigrojnë nga momenti i lindjes deri në moshën pesë vjeç dhe zhvillojnë të gjithë ciklet shkollore në vendin e emigracionit;

Gjenerata 1.5 – përfshin fëmijët e moshës nga 6 deri në 12 vjeç, të cilët kanë filluar procesin e socializimit dhe shkollën fillore në vendin e origjinës por që vazhdojnë ciklet shkollore në vendin e emigracionit;

Gjenerata 1.25 – përfshin të miturit që emigrojnë nga vendi i tyre i origjinës nga moshë 13 deri në 17 vjeç.

Grupimet e mësipërme, që futen tek gjenerata e dytë e emigracionit, kanë tipare dhe këndvështrime të ndryshme lidhur me konceptin e kulturës, komunitetit dhe identitetit të cilat ndikojnë në opinionet

dhe këndvështrimet e tyre për jetën dhe rrjedhimisht në marrëdhëniet e tyre me njerëzit e tjerë.

Më poshtë renditen disa karakteristika dalluese të grupimeve të gjeneratës së dytë.

Gjenerata 2.5

Në këtë kategori bëjnë pjesë fëmijët e çifteve të përziera. Këta fëmijë/adoleshentë gjenden në një pozicion shumë specifik në krahasim me fëmijët e tjerë të emigracionit; gjendja e tyre natyrale është pikërisht ajo midis dy realiteteve që përjetojnë në shtëpi. Ata konsiderohen si urë lidhëse natyrale mes dy realiteteve dhe bartës të natyrshëm të dialogut dhe krahasimit mes vendasve dhe të huajve.

Fakti që njëri prind është vendas i mundëson atyre të ketë të gjitha të drejtat e qytetarëve /moshatarëve vendas dhe i krijon ndjesinë e përkatësisë së plotë në vendin ku jetojnë që nga lindja, ndërsa zakonet, traditat, besimi fetar, rutina, ushqimi, muzika dhe elemente të tjerë që përbëjnë jetën e tyre të përditshme krijojnë të gjithë hapësirën kuptimore dhe identitare që i bën këta fëmijë të ngjashëm me moshatarët e tyre të huaj të gjeneratës së dytë.

Gjenerata 2.0

Këta janë fëmijët e emigrantëve të lindur në vendin pritës nga prindër të huaj. Ata mund të përkufizohen si “gjenerata e dytë” në kuptimin më të plotë dhe të mirëfilltë të fjalës. Kjo “kategori” përfshin fëmijët/ të rinjtë që edhe pse konsiderohen “të huaj” nuk perceptohen si emigrantë pasi ata kanë lindur në vendin pritës.

Gjenerata 1.75

Në këtë kategori bëjnë pjesë fëmijët nga mosha 0 deri në 5 vjeç, që kanë lindur në vendin e origjinës ose kanë ardhur në vendin pritës në moshën parashkollë. Këta fëmijë përjetojnë eksperiencën migratore gjatë fëmijërisë së tyre dhe kanë kujtime të turbullta dhe të zbehta nga vendi i tyre i

origjinës. Zakonisht, ata përshtaten shpejt me kontekstin e ri, zotërojnë të dy regjistrat e komunikimit gjuhësor, nuk hasin vështirësi të veçanta në shkollë dhe kanë rezultate shkollë të kënaqshme.

Gjenerata 1.5

Kjo kategori përfshin djemtë dhe vajzat që mbërrijnë në vendin pritës gjatë ciklit të shkollës fillore (6-13 vjeç). Këta fëmijë/adoleshentë ballafaqohen me eksperiencën migratore në një moshë delikate, shpesh të shoqëruar me një çorientim psikologjik të fortë. Ata në fakt braktisin vendin e origjinës, gjuhën, shkollën, miqtë e tyre dhe e gjejnë veten të katapultuar në një kontekst të ri ku duhet të njihin dhe të mësohen me një sistem të ri rregullash dhe zakonesh të reja. Këtyre fëmijëve u mungojnë vendet, njerëzit e dashur me të cilët kanë kaluar fëmijërinë e tyre, kujtimet e fëmijërisë dhe ndihen fillimisht të përhumbur në këtë kontekst të ri ku ndonjëherë edhe mund të humbasin “statusin e nxënësit të mirë” për shkak të gjuhës së re të studimit dhe mjedisit të ri shkollor.

Gjenerata 1.25

Kjo kategori u referohet të rinjve që mbërrijnë në vendin pritës në adoleshencë ose para-adoleshencë (13-17 vjeç) pasi kanë kaluar një periudhë të rëndësishme kohore në vendin e tyre të origjinës. Këta adoleshentë bashkohen me prindërit e tyre pas disa vitesh ndarjeje dhe hasin më shumë vështirësi për t'u integruar në kontekstin e ri sepse e gjejnë veten të detyruar të përballen me eksperiencën migratore dhe me bashkimin familjar në një fazë shumë delikate të jetës së tyre. Rrugëtimi i tyre i emigracionit është i ngjashëm me atë të emigrantëve të brezit të parë, pasi largimi nga vendi i origjinës përjetohet si një eksperiencë që lë shenjë në jetët e tyre. Ata largohen jo vetëm nga vendlindja, por edhe nga rrjeti familjar, shkolla dhe miqtë me të cilët janë rritur. Këta adoleshentë kanë disa karakteristika specifike

në krahasim me të tjerët sepse eksperiencia e tyre e jetës është e tillë. Ata kanë lindur në një tokë tjetër, janë edukuar dhe arsimuar për vite me radhë në një kontekst tjetër, dhe papritur, në një moment të caktuar të jetës së tyre këta adoleshentë e gjejnë veten të katapultuar në një vend tjetër, të detyruar të përballen me sfidat e adoleshencës në një kontekst të ri, krejtësisht të huaj, pa koordinata vetjake orientuese. Kësisoj, përveç ndarjes së papritur nga vendi i tyre i origjinës, ata shumë shpesh përjetojnë bashkimin familjar në një vend tjetër dhe në një kontekst tjetër ku nuk mungojnë përplasjet dhe tensionet me prindërit si rrjedhojë e rindërtimit të një formati të ri familjar. Vlen të theksohet se ky format familjar në kontekstin e ri shoqëror është shumë i ndryshëm nga ai i mëparshmi, i ndërtuar në vendin e origjinës. Të gjithë pjesëtarët e familjes kanë ndryshuar: emigranti në vendin pritës, bashkëshortja që ka jetuar në atdhe, fëmijët që tashmë janë rritur dhe mbi të gjitha kanë ndryshuar ekuilibrat dhe marrëdhëniet brenda dhe jashtë familjes. Vendimi për të jetuar përsëri së bashku në një realitet social thellësisht të ndryshëm nga ai në të cilin lindi dhe u krijua familja, mungesa e mbështetjes së rrjetit prindëror e bën këtë eksperiencë për të gjithë familjen një rrugëtim kompleks dhe delikat. Gjithsesi, ata që e vuajnë më shumë së të gjithë këtë ndryshim janë fëmijët. Studimet mbi këtë temë kanë nxjerrë në pah sesi këta adoleshentë/ të rinj përgjatë eksperiencës së migrimit përjetojnë një krizë të fortë identiteti, një ndarje të thellë të jetës së tyre midis “para” dhe “pas”, ndërmjet “atje - atëherë” dhe “tani - këtu” dhe rriten midis kujtimeve të përmallshme të vendit të origjinës dhe të dëshirës e projekteve në ndërtimin e të ardhmes së tyre në vendin pritës, si bashkëmoshatarët e tyre. Kjo lloj brishtësie identitare ndikon jo vetëm në rritjen e tyre psiko-fizike, por edhe në performancën dhe rezultatet shkollore. Ata shpesh hasin vështirësi me mësimin

e gjuhës së studimit me integrimin në shkollë dhe ndonjëherë shkojnë drejt marginalizimit social.

Nga kjo panoramë teorike rezulton qartë se gjenerata e dytë e emigracionit përfaqëson një realitet shumëplanësh, plural, me histori, eksperiencia dhe përjetime të ndryshme dhe të shumëfishta. Prandaj, shihet e arsyeshme që kur diskutohet për fëmijët e emigrantëve, duhet të jemi të vetëdijshëm që bëhet fjalë për një grupim plural njerëzish, që rriten dhe edukohen nëpërmjet dy botëve të përkatësisë, që formohen si individë në mënyrë shumë komplekse përmes kodeve të mbartura kulturore nga vendi i origjinës dhe nderveprimit aktiv në realitetin e vendit pritës me karakteristikat e tij specifike.

Formimi identitar i gjeneratës së dytë

Prezenca e gjeneratës së dytë të emigracionit në vendet pritëse është tregues i një stadi të caktuar të zhvillimit ekonomik dhe politik të vendeve të emigracionit dhe i zhvillimit dhe emancipimit shoqëror të tyre. Prezenca e emigrantëve të gjeneratës së dytë sinjalizon gadishmërinë sociale të këtyre vendeve për të pritur, për të bashkëndarë me Tjetrin, për të bashkëkrijuar një realitet të ri social më dinamik. Emigrantët e gjeneratës së dytë, ndryshe nga prindërit e tyre, në përgjithësi flasin në mënyrë të përsosur gjuhën e vendit ku jetojnë dhe gjuhën e vendit të origjinës dhe njëkohësisht janë njohës shumë të mirë të stilit të jetës së dy vendeve të përkatësisë. Prindërit e tyre, përpiqen të përcjellin gjuhën, kulturën dhe vlerat e vendit të tyre të origjinës, në mënyrë që ata të mos humbasin rrënjët dhe të ruajnë lidhjet me atdheun e tyre por në krahasim me ta, lidhja që emigrantët e brezit të dytë kanë me vendin e origjinës është krejt e një lloji tjetër. Emigrantët e gjeneratës së dytë, nga pikëpamja gjuhësore, sociale dhe psikologjike trashëgojnë një pasuri kulturore të dyfishtë, gjë që i bën ata që të jenë natyrshëm ura lidhëse midis dy kulturave

dhe shumë më të hapur dhe të predispozuar për të qenë qytetar global. Gjenerata e dytë, ka një vetëdije sociale më të qartë se sa gjenerata e parë e emigracionit, ka interesa, stil jetese dhe zakone të ngjashme me bashkëmoshatarët vendas ndaj e percepton veten si pjesë përbërëse e shoqërisë vendase me të drejta dhe detyra të barabarta dhe si e tillë, kërkon mundësi pune më prestigjioze nga pikëpamja sociale dhe ekonomike në krahasim me prindërit e tyre.

Formimi i tyre identitar i emigrantëve të brezit të dytë mund të kuptohet më mirë nëse studiohet i ndërlidhur me karakteristikat dalluese të secilit nëngrupim, nevojat dhe vështirësitë që përjetojnë në familje dhe hasin në shoqëri. Shumë prej tyre, duke jetuar mes dy kulturave të ndryshme, ndihen “pezull” dhe përjetojnë një dualizëm konstant brenda vetes, gjithmonë në përpjekje për të kuptuar se me cilën prej tyre identifikohen më shumë.

Adoleshenca përfaqëson një pikë të rëndësishme referimi për konstruktin identitar. Adoleshenca është faza vendimtare e formimit të identitetit njerëzor, është një nga fazat më traumatike që përjeton individi, sepse vështirësitë e përjetuara në këtë moment tranzicioni mund të zgjidhen në mënyrë konstruktive dhe dialektike ose, përkundrazi, mund të mbeten të pazgjidhura, të lënë pikëpyetje të hapura përgjatë gjithë jetës dhe të shkaktojnë probleme personale dhe profesionale.

Periudha e adoleshencës për gjeneratën e dytë është më e ndërlikuar se ajo e vendasve, sepse këta fëmijë/adoleshentë, përveç vështirësive normale të kësaj faze të jetës, përjetojnë edhe të tjera për shkak të prejardhjes së tyre të huaj. Veçanërisht, në këtë fazë emigrantët e gjeneratës së dytë manifestojnë brishtësi të spikatur emocionale dhe përhumbje identitare. Studiuesja G. Favaro, lidhur me identitetin e tyre shprehet se identiteti i emigrantëve të gjeneratës së dytë është “i dyfishtë dhe i shumëfishtë” (Favaro & Napoli, 2004). Fakti që këta

janë të rinj jetojnë ndërmjet dy kulturave të ndryshme, i bën ata të destinuar për të pasur një përkatësi identitare të dyfishtë, që harmonizon lidhjen ndërmjet kulturës dhe familjes së origjinës me traditat, kulturën, gjuhën e vendit pritës ku ata projektojnë të ardhmen e tyre.

Në disa raste, vërehet që vetë familja mund të shndërrohet në një burim problematikash që vështirëson lidhjet dhe rolet midis anëtarëve të saj. Grupmosha më problematike është 13-17 vjeç, pra *grupimi 1.25*, kur këta adoleshentë emigrantë bashkohen me prindërit e tyre pas disa vitesh ndarjeje dhe përjetojnë një tjetër ngjarje dramatike, kësaj radhe ndarjen nga rrjeti familjar në vendin e origjinës (nga gjyshërit, kushërinjtë, të afërmit) personat që u kujdesën për ta përgjatë fëmijërisë së tyre. Këta të rinj/adoleshentë janë të detyruar të rindërtojnë një marrëdhënie të re me /prindin/prindërit e tyre që i njohin pak dhe ndonjëherë edhe me vëllezër ose motra të lindur në vendin e emigracionit. Atyre u kërkohet të ndërtojnë një jetë të re, në një vend të ri me një familje të re, me një gjuhë dhe shkollë të re. Pra, u kërkohet të rinisin thuajse çdo gjë rishtas.

Edhe në lidhje me shkollën integrimi i tyre në vendin pritës nuk është aspak i thjeshtë. Njohja e kufizuar e gjuhës së studimit, mungesa e njohurive të përgjithshme lidhur me funksionimin e sistemit mësimor, të mënyrës së mësimdhënies dhe të nxënimit janë disa nga vështirësitë që ata hasin në arritjen e suksesit në shkollë. Ndodh që në këtë proces integrimi, mësuesit dhe edukatorët, të cilët pavarësisht përgatitjes së tyre profesionale, nuk kanë formimin e duhur dhe të mjaftueshëm për të kuptuar eksperiencën dhe implikimet psikologjike që emigracioni shkakton në jetën e këtyre adoleshentëve. Po ashtu, marrëdhëniet e tyre me bashkëmoshatarët janë gjithashtu të vështira dhe komplekse prandaj është e rëndësishme të adaptohet një qasje ndërkulturore në të gjitha mjediset shkollore

si mendësi e re edukuese dhe sociale për të gjithë nxënësit, vendas dhe të huaj.

Carmel Camilleri (1979), në lidhje me gjeneratën e dytë shprehet se këta të rinj, përballë konflikteve të tilla, adoptojnë një lloj sjellje të caktuar që autorja e quan *bricolage*, ku ata përzgjedhin vlerat dhe normat që rezultojnë më të favorshme, më të dobishme dhe më të përshtatshme në situata të caktuara.

Ndërsa sipas studiuesve Hanna Malewska-Peyre dhe Maryla Zaleska (1980) të rinjtë që bëjnë pjesë te ky grupim priren të ruajnë vlerat dhe normat e sjelljes që janë esenciale dhe thelbësore për identitetin e tyre, edhe kur kjo zgjedhje mund t'i ekspozojë ndaj rrezikut dhe vuajtjes.

Për të analizuar më hollësisht rritjen dhe formimin e emigrantëve të gjeneratës së dytë, më poshtë paraqiten disa nga përkufizimet e studiuesve të fushës lidhur me elementët përcaktues të identitetit të gjeneratës së dytë.

Manuel Castells (2004: 6) thekson se:

identiteti është procesi i të kuptuarit që bazohet në një atribut kulturor, ose në një sërë atributesh kulturore të ndërlidhur mes tyre dhe çdo individ mund të zhvillojë identitete të shumëfishta, por është pikërisht ky pluralitet identitar që shkakton stres dhe kontradikta.

Autori Niklas Luhman shprehet se:

identiteti është një përgjithësim simbolik që i imponohet eksperiencës jetësore dhe mundëson një referim kuptimor ndaj vetvetes për të zgjeruar kompleksitetin personal njerëzor (cit., Baraldi & Corsi, 1990: 90).

Eide Spedicato (2006: 152) e përkufizon identitetin si më poshtë:

identiteti prezantohet si një përzierje e komponentëve individualë dhe kolektivë dhe shënon kufirin midis sferës subjektive

dhe objektive; është një lloj lëkure/veshje pa të cilën nuk mund të bëjmë dot, e cila na përcakton, por edhe na mundëson të kemi në një marrëdhënie me botën. Në fakt, njeriu pa identitet nuk mund të vendoset në realitetin shoqëror, të bëjë zgjedhje koherente, të identifikojë linja të rëndësishme sjelljeje.

Erving Goffman (2004: 74), autor që ka trajtuar së shumti problemet e stereotipave dhe paragjykimeve sociale, lidhur me identitetin argumenton si më poshtë:

identiteti personal lidhet me supozimin se individ mund të diferencohet nga të gjithë të tjerët dhe se kjo mënyrë diferencimi ka të bëjë me historinë e vazhdueshme të fakteve shoqërore që përbëjnë substancën bazike në të cilën atashohen të gjitha faktet e tjera biografike. Është e vështirë të kuptohet mënyra se si identiteti personal interpreton, por në fakt identiteti interpreton një rol të strukturuar, të zakonshëm, të standardizuar në organizimin shoqëror, pikërisht për shkak të unicitetit të tij.

Nga përkufizimet e lartpërmendura vihet re se identiteti lidhet ngushtësisht me kulturën, eksperiencën jetësore, raportin me veten, rolin dhe pozicionin në shoqëri dhe komunikimin. Si rrjedhojë, mënyra të ndryshme të komunikimit, verbal, paraverbal dhe joverbal, që përdoren në vende të ndryshme mbartin kuptime dhe simbolika të caktuara dhe ndonjëherë shkaktojnë keqkuptime dhe/ose konflikte. Komunikimin ndërpersonal mes njerëzve me prejardhje të ndryshme gjuhësore-kulturore nuk është i thjeshtë dhe as i mirëqenë ndaj është krejt e natyrshme që të kërkojë aftësi specifike për të mundësuar të kuptuarit e ndërsjellë në lidhje me format e ndryshme të të shprehurit që janë të rrënjësura nga kultura e origjinës. Komunikimi luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin e identitetit, sepse i lejon individët të bashkëndajnë botëkuptimet e tyre dhe favorizojnë rritjen e personalitetit të tyre.

Sipas studiuesit Bernett Pearce-it, format e komunikimit konsiderohen si "kontejnerët" e personalitetit, të aspiratave dhe të besimeve (Pearce, 1993) ndërsa identiteti konsiderohet si rezultat i kombinimit të elementeve të ndryshëm, si memoria kolektive, feja, vlerat e përbashkëta morale, fantazitë personale, mënyrat e perceptimit të realitetit dhe ndërveprimit me të, etj., dhe instrumentet që përdor individi për krijuar një imazh përbushës për veten që i mundëson marrjen pjesë në shumë grupe shoqërore.

Ndikimi i faktorëve familjar lë gjurmë në formimin e tyre identitar. Struktura e familjes emigrante pëson shumë ndryshime në emigracion. Të dy brezave u kërkohet të rishikojnë rolet, dinamikat, modelet, rregullat, praktikat dhe qasjet e reja kulturore në vendin pritës. Gjithashtu edhe konfliktet që lindin midis prindërve dhe fëmijëve jo vetëm në fazën e adoleshencës, por edhe më vonë ndikojnë në formimin e tyre identitar.

Si rezultat, kur flitet për konstruktin identitar të gjeneratës së dytë, në studimet e fenomeneve migratore vlen të theksohet pluraliteti i faktorëve dhe aktorëve që ndikojnë në formimin dhe zhvillimin e emigrantëve të gjeneratës së dytë.

Perspektiva të reja edukuese

Prezenca e gjeneratës së dytë në vendin e emigracionit nënkupton që fenomeni i migrimit është bërë strukturor në këtë vend. Gjenerata e dytë simbolizon produktin përfundimtar të dy proceseve: zgjedhjen e prindërve për të jetuar në mënyrë definitive në vendin pritës dhe kapacitetin e shoqërisë vendase për të mirëpritur këta të rinj. Ndërthurja e këtyre dy proceseve përcakton si rrjedhojë integrimin e tyre në shoqërinë pritëse. Gjithashtu, prania e gjeneratës së dytë të emigracionit kryen një rol nxitës për politikën vendase, sepse bën të qartë që në panoramën sociale të vendit të tyre ka ndodhur një ndryshim i

pakthyesëm shoqëror që prodhon tipologji të tjera marrëdhëniesh me elementë të rinj kulturorë. Krijimi i kushteve të barabarta me vendasit për gjeneratën e dytë, respekti ndaj diversitetit kulturor dhe politikën specifike për integrimin dhe gjithëpërfshirjen e tyre në shoqëri, janë treguesit kryesorë që do të përcaktojnë shoqërinë e së ardhmes dhe kohezionin social në vendin pritës. Është detyrë e politikave arsimore të këtyre vendeve që të përcjellin ndryshimin e vizionit kulturor. Lidhur me këtë, studiuesi E. Besozzi (2009) thotë se në kohën e sotme është urgjente të kemi një perspektivë të re edukuese, transnacionale, që nënkupton një ndarje univoke nga përkatësia kulturore vetëm me një komunitet ose me një grup të caktuar dhe si rrjedhojë nevojitet një edukimi ri, i diktuar nga një sërë faktorësh dhe eksperiencash, nevojitet një identitet i shumëfishhtë dhe i hapur.

Ky këndvështrim nxjerr në pah limitet e konceptimit linear monokulturor dhe qartëson nevojën për edukim ndërkulturor për të gjithë individët, vendas dhe të huaj. Perspektiva e edukimit për një shtetësi të përbashkët evropian mundëson bashkëjetesën plurale të kulturave, respektin dhe tolerancën ndaj diversitetit dhe nxit bashkëpunimin midis palëve për një të ardhme më të mirë.

Edukimi luan një rol shumë të rëndësishëm në procesin e integritit të gjeneratës së dytë. Edukimi ndërkulturor dhe arsimimi gjithëpërfshirës i ndihmon këta të rinj të kapërcejnë pengesat gjuhësore dhe kulturore dhe i stimulon që të fitojnë aftësitë e duhura për të arritur suksesin profesional dhe integrimin në vendin pritës.

Në shoqëritë e sotme multikulturore nevojitet një mendësi edukuese gjithëpërfshirëse ndaj nevojave të emigrantëve të gjeneratës së dytë. Kjo mendësi e re edukuese bazohet në programe mbështetëse gjuhësore dhe kulturore në shkollë, në kontributin e mësuesve të trajnuar dhe mendjehapur ndaj kulturave të tjera, në trajnimin e personelit

pedagogjik administrativ nëpër shkolla si dhe në politika që promovojnë barazinë arsimore dhe aksesin e tyre të barabartë në burime dhe në mundësi formative. Edukimi ndërkulturor nuk duhet të kufizohet vetëm në dimensionin mësimor, por duhet të përfshijë ndërgjegjësimin për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore dhe aftësi sociale të nxënësve për të nxitur mirëkuptimin e ndërsjellë dhe respektin për diversitetin.

Pedagogjia ndërkulturore luan një rol thelbësor në suksesin arsimor dhe integrimin social të nxënësve ndaj kërkon një riformulim të vazhdueshëm që i përgjigjet nevojave të tyre dhe merr në konsideratë kontekstet e tyre kulturore, gjuhësore të prejardhjes. Pedagogjia ndërkulturore bazohet në këto linja edukuese:

Respekt i barabartë ndaj kulturave.

Mësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm për diversitetin kulturor në klasë dhe të adoptojnë qasje që respektojnë dhe vlerësojnë diversitetin kulturor të nxënësve. Kjo qasje mbështetet në përdorimin e materialeve të ndryshme mësimore që pasqyrojnë eksperiencat dhe këndvështrimet e kulturave të ndryshme të përfaqësuara në klasë.

Mbështetje gjuhësore. Shumë fëmijë/adoleshentë që i përkasin grupimeve të ndryshme të gjeneratës së dytë përballen me sfida gjuhësore serioze lidhur me gjuhën e studimit në kontekstin shkollor, veçanërisht nëse gjuha e folur në shtëpi është gjuha e origjinës. Mësimdhënia duhet të përfshijë strategji për mbështetjen e gjuhës së studimit si gjuhë e dytë, përdorimi i metodave të të mësuarit të bazuar në komunikim dhe inkurajimi për përdorimin e gjuhës amtare si një burim të pashtershëm dije.

Përfshirje e familjes. Përfshirja aktive e familjeve të emigrantëve të gjeneratës së dytë në aktivitete të ndryshme jashtëshkollore është thelbësore për suksesin e tyre shkollor. Takimet prindër-mësues -nxënës dhe zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta për të gjithë klasën shërbejnë për njohjen dhe respektin reciprok.

Diversifikim i metodologjive të mësimdhënies.

Për shkak se stilet e të nxënimit mund të ndryshojnë midis nxënësve dhe kulturave, është e rëndësishme të përdoren një sërë metodologjish mësimore që marrin parasysh diversitetin. Për të nxitur të gjitha stilet e të nxënimit nevojitet përdorimi i teknologjisë, i instrumenteve multimediale, promovimi i aktiviteteve ndërvepruese dhe bashkëpunuese për t'iu përgjigjur dhe përshtatur nevojave individuale të nxënësve.

Promovim i vetëvlerësimit dhe identitetit kulturor. Mësimdhënia duhet të inkurajojë nxënësit të njohin dhe të vlerësojnë identitetin e tyre kulturor, të perceptojnë dhe interpretojnë diversitetin e tyre si një vlerë të shtuar; përdorimi i materialeve mësimore që vënë në fokus diversitetin dhe diskutimet e hapura rreth diversitetit kulturor duhet të jenë pjesë aktive e komunitetit shkollor dhe komunitar.

Formulimi i koncepti pedagogjik ndërkulturor përfshin rishikimin e kurrikulave, stileve llojshmërinë e komunikimit, menaxhimin e klasave multikulturore, modernizimin e shkollës për krijimin mundësive të barabarta, njohjen dhe respektin e ndërsjellë me në fokus nxënësin si individ.

Si rrjedhojë, pedagogjia ndërkulturore bëhet reflektimi i pedagogjisë aktive dhe ndëraktive që pasqyron nevojat e decentralizimit, shqyrton këndvështrime të ndryshme dhe nxit aftësitë e komunikimit dhe të dëgjimit aktiv dhe krijues. Kjo perspektivë e re arsimore përfshin edhe disa elemente specifike të të nxënimit si më poshtë vijojnë:

Të mësuarit praktik. Prezanton të mësuarit praktik dhe eksperimental, si pjesë integrale e kurrikulës shkollore nëpërmjet aktivizimit të projekteve kërkimore, vizitave në terren, praktikave dhe bashkëpunimeve me organizatat e komunitetit. Të mësuarit eksperimental u ofron nxënësve mundësinë që të zbatojnë në jetën reale njohuritë teorike që kanë marrë në klasë, për të zhvilluar aftësi praktike dhe të transferueshme.

Zhvillimi i aftësive ndërkulturore. Integrimi i temave për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore të nxënësve në kurrikulat shkollore për të vlerësuar diversitetin kulturor, organizimi i seminare/konferencave /aktiviteteve për edukimin ndërkulturor, intervista /takime me qytetarë të huaj që dëshmojnë eksperiencën e tyre migratore.

Qasjet multikulturore. Te pasurit e një qasje multikulturore ndaj mësimdhënies dhe të nxënësve në fokus diversiteti kulturor. Një qasje e tillë nënkupton integrimin e këndvështrimeve të ndryshme kulturore nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të larmishëm mësimorë, organizimin e festave dhe traditave kulturore të grupeve të ndryshme etnike në një mjedis gjithëpërfshirës.

Partneritet me komunitetet e huaja. Bashkëpunim me komunitetet e huaja në territor për të përmirësuar eksperiencën shkollore të nxënësve. Bashkëpunimi me qendrat kulturore, shoqatat e emigrantëve, biznese dhe institucione të tjera vendase mund të ofrojnë mundësi dhe mbështetje për nxënësit e huaj dhe familjet e tyre.

Risi teknologjike. Përdorimi i risive teknologjike për të përmirësuar aksesin në arsim dhe për të personalizuar mësimin për nevojat individuale të nxënësve. Kjo mund të përfshijë përdorimin e platformave të mësimdhënies në internet, burimeve dixhitale shumëgjuhëshe për të mbështetur nxënësit në sfidat e tyre gjuhësore dhe kulturore.

Përfundime

Në shekullin e 21-të, njerëz me kultura, besime, vlera dhe gjuhë të ndryshme

bashkëjetojnë dhe të ndërveprojnë në vende, kontekste dhe modalitete të paeksploruara më parë. Edukimi ndërkulturor në sistemet arsimore evropiane, tanimë, nuk perceptohet si një specializëm i mirëfilltë dhe i ngurtëzuar, as si një lëndë mësimore e shtuar e programeve mësimore që zhvillohet në një kohë të paracaktuar ose të përcaktuar të orarit shkollor, por si një qasje konstante për të shqyrtuar të gjitha proceset didaktike, kurrikulat shkollorë, stilet komunikuese, diversitetin, identitetet dhe nevojat e ndryshme të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces. Edukimi ndërkulturor ka në fokus transformimin social të nxënësit si individ dhe pedagogjinë ndërkulturore si studim kompleks teorik dhe praktik të mësimdhënies në të gjitha ciklet shkollore. Kjo qasje edukuese i përgatit nxënësit me njohuri dhe aftësi që nesër kur të dalin në jetë, të ndërveprojnë natyrshëm me kultura dhe kontekste të ndryshme sociale, me dëshirën dhe kuriozitetin për të njohur vende dhe njerëz të tjerë, duke zgjeruar dhe zgjedhur hapësira të reja gjeografike. Pedagogjia ndërkulturore, e lindur si përgjigje edukuese për nxënësit e huaj në shkollat perëndimore tanimë përfaqëson një mentalitet të ri edukues, një “*forma mentis*” të përbashkët për një bashkëjetesë paqësore në nivel global. Prania e shtuar e gjeneratës së dytë në vendet pritëse, roli i tyre i natyrshëm si urë lidhëse ndërmjet kulturave mbart një peshë të rëndësishme për të transformuar shkollat perëndimore në vendin dhe audiencën ku zhvillohen mundësi të barabarta arsimore dhe sociale të qytetarisë së përbashkët globale.

REFERENCAT

- Ambrosini, Maurizio, and Stefano Molina. 2004. *Seconde Generazioni. Un'introduzione al futuro dell'immigrazione in Italia*, Torino: Fondazione Giovanni Agnelli.
- Ambrosini, Maurizio. 2004. *Tra Problemi Sociali*

e Nuove Identità: I Figli dell'immigrazione, Torino: Fondazione Migrantes.

Ambrosini, Maurizio. 2005, *Sociologia Delle Migrazioni*, Bologna: Il Mulino.

Aparicio Gómez, Rosa. 2007. “Las “Segundas

- Generaciones” de Origen Inmigrante “Asimilación o Integración?”, *Puntos de Vista. Cuadernos del Observatorio de las Migraciones y la Convivencia Intercultural de la Ciudad de Madrid*, No. 10, pp. 7-24.
- Baraldi, Claudio, Giancarlo Corsi, and Elena Esposito. 1990. *Glossario dei termini della teoria dei sistemi di Niklas Luhman*, Urbino: Montefeltro.
- Barbagli, Marzio, and Schmoll Camille. 2011. *Stranieri in Italia. La generazione dopo*, Bologna: Il Mulino.
- Besozzi, Elena, Maddalena Colombo, and Mariagrazia Santagati. 2009. *Giovani Stranieri. Nuovi Cittadini. Le Strategie di una generazione ponte*, Milano: Franco Angeli.
- Bolognari, Velleda, and Klaus Kühne. 1997. *Povertà, migrazione, razzismo. Il lavoro sociale ed educativo in Europa*, Bergamo: Ed. Junior.
- Cacciavillani, Giovanni, and Erika Leonardi. 2007. *Una Generazione In Movimento. Gli Adolescenti e i Giovani Immigrati*. Milano: Franco Angeli.
- Camilleri, Carmel. 1979. “Crise socio-culturelle et crise d’identité dans des sociétés du Tiers-Monde: l’exemple des sociétés maghrébines”, *Psychologie Française*, pp. 259-268.
- Caneva, Elena. 2011. *Mix generation. Gli adolescenti di origine straniera tra globale e locale*, Milano: FrancoAngeli.
- Caritas/Migrantes. 2009. *Immigrazione Dossier Statistico 2010 XX Rapporto sull’immigrazione*, Roma: Idos.
- Castells, Manuel. 2014. *Il potere delle identità*, Milano: Università Bocconi.
- Consiglio d’Europa. 1984. *Raccomandazione N.R. (84) 18 agli stati membri sulla formazione degli insegnanti ad una educazione per la comprensione interculturale in particolare in un contesto di emigrazione*. (adottata dal Comitato dei Ministri del Consiglio d’Europa il 25 settembre 1984).
- Crul, Maurice. 1994. “Springen over je eigen schaduw: De onderwijsprestaties van Marokkanen en Turken van de tweede generatie.” *Migrantenstudies*, Vol.10, No.3, pp.168 - 186.
- Favaro, Graziella, and Monica Napoli. 2002. *Come un pesce fuor d’acqua. Il disagio nascosto dei bambini e dei ragazzi immigrati*, Milano: Guerini Associati.
- Favaro, Graziella, and Monica Napoli. 2004. *Ragazze e Ragazzi nella migrazione*, Milano: Guerini Associati.
- Goffman, Erving. 2004. *Stigma. L’identità negata*, Verona: Ombre Corte.
- Jelloun, Tahar Ben. 1997. *Hospitalité française. Racisme et immigration maghrébine*, Parigi: Editions du Seuil.
- Lannutti, Vittorio, and Ennio Pattarin. 2007. *I Rapporti familiari, amicali e di genere, fuori dalla linearità delle cose semplici*, Milano: Franco Angeli.
- Moro, Marie Rose. 2005. *Bambini di qui venuti da Altrove. Saggio Di Transcultura*, Milano: Franco Angeli.
- Portera, Agostino. 1997. *Tesori Sommersi. Emigrazione, Identità, Bisogni Educativi Interculturali*, Milano: Franco Angeli.
- Portes, Alejandro, and Rumbaut, Rubén G. 2001. *Legacies: The Story of the Immigrant Second Generation*. Berkeley and New York: University of California Press and Russell Sage Foundation.
- Portes, Alejandro, and Rumbaut, Rubén G. 2005. “The Second Generation and the Children of Immigrants Longitudinal Study”. *Ethnic and Racial Studies*, Vol. 28, No. 2, pp. 983-999.
- Rumbaut, Rubén. 1997. «Assimilation And Its Discontents: Between Rhetoric And Reality», *The International Migration Review*. Vol. 31, No. 4, pp. 923-960.
- Seifert, Wolfgang. 1992. “Die zweite Ausländergeneration in der Bundesrepublik: Längsschnittbeobachtungen in der Berufseinstiegsphase”, *Kölner Zeitschrift für Soziologie und Sozialpsychologie*, Vol. 44, No. 4, pp. 677-696.
- Sirna-Terranova, Concetta. 1997. *Pedagogia Interculturale. Concetti, Problemi, Proposte*, Milano: Guerini Studio.
- Spedicato Iengo, Eide. 2006. *Per incontrare la Sociologia, Definizioni, concetti, tendenze, paradigmi*, Lanciano: Rivista Abruzzese.

- Tribalat, Michèle. 1995. *Faire France Une enquête sur les immigrés et leurs enfants*. Paris: Découverte.
- Thomas, William Isaac, and Florian Znaniecki. 1927. *The Polish Peasant in Europe and America*, New York : Knopf.
- Zanfrini, Laura. 2004. *Sociologia delle migrazioni*, Bari: Laterza.
- Zoletto, Davide. 2012. *Dall'interculturalità ai contesti eterogenei. Presupposti teorici e ambiti di ricerca pedagogica*, Milano: FrancoAngeli.

ABSTRACT

The Second Generation of Immigration and New Educational Perspectives

The second generation of immigration represents de - jure and de - facto the consolidation of immigration in the hosting country. The presence of children of immigrants at school, in the territory, in common environments, and activities with their local coevals brings out the need to review the monocultural educational models, which turn out to be insufficient to represent cultural pluralism in western societies. As a normal consequence of immigration the phenomenon, the presence of the second generation of immigration coincides with a certain stage of economic, political and social development of the hosting country and is related to the development of new educational models in all educational environments. Second generation immigrants are the most exemplary representatives of the world that is changing at a very fast rate, and which symbolize the connecting bridges between the educational models of the country of origin and the host country.

Intercultural education initially came out as a response to the linguistic needs of foreign students, but over time, it took the form of a new pedagogical reflection, which places diversity at the center of the development of new educational theories. Intercultural education today represents an educational mindset in multicultural society, and it includes all factors and actors in dynamic interaction for a wider social cohesion. This article aims to analyze some general characteristics of the second generation of immigrants, the challenges they face in their growth and education between the two worlds of belonging and the need for a continuous revision of educational models in today's global society.

Keywords: *immigrants, second generation, education, identity, language.*

AUTHORITARIANISM AND DEMOCRATIZATION IN ALBANIA: THE ROLE OF SOCIAL MOVEMENTS

Florian ÇULLHAJ
European University of Tirana (UET)
E-mail: florian.cullhaj@uet.edu.al

ABSTRACT

This paper examines the dynamics of protest participation in contemporary Albania, focusing on how the state mobilizes measures to either promote or suppress social movements. Analysing Albania's post-communist political landscape reveals the complex relationship between protest participation, authoritarianism, and democratization. Drawing on a range of theoretical perspectives, including the works of Charles Tilly, Pierre Rosanvallon, and others, the paper highlights how protests have historically influenced democratic development and how, in Albania, they have often been manipulated or stifled by the state. The analysis sheds light on Albania's current political environment, characterized by a hybrid-autocratic regime where democratic institutions coexist with authoritarian practices. This research contributes to a deeper understanding of post-communist countries' challenges in achieving democratic consolidation, emphasizing the importance of citizen participation in this process.

Keywords: *Authoritarianism, Democratization, Albania, Social Movement*

Florian ÇULLHAJ, Ph.D., is a political scientist with over a decade of teaching experience. He is a full-time lecturer at the European University of Tirana and a visiting lecturer at the University of Rome "Tor Vergata" and the University of Teramo, Italy. Florian is the author of two monographs and several articles in impact factor journals.

This paper aims to explore the dynamics of protest patterns in contemporary Albania. We will examine Albanian politics and show how the state mobilizes measures to promote or prevent social movements. Many authors stressed the unique value of citizens' participation in public activities. Charles Tilly (2004, p. 125) has underlined the existence of "a broad correspondence

between democratization and social movements. Social movements originated in partial democratization, which, during the 18th century, pitted British subjects and North American settlers against their rulers. Throughout the 19th century, social movements generally flourished and grew where there was further democratization and declined when authoritarian regimes impeded democracy. This path has continued throughout the twentieth and twenty-first centuries; the development maps of institutions and social movements overlap widely". The democratic state is based on a conception of democracy representative, but not only. As Pierre Rosanvallon (2013: 11) recently noted, "the history of real democracies cannot be dissociated from a permanent tension and contestation." At the same time, theorists range from participatory democrats (Pateman, 1970; Barber, 1984; Mansbridge-Parkinson, 2012) to democratic realists (Schumpeter, 1952; Sartori, 1987), share the same opinion about citizen participation as a central characteristic of democracy. More to the point, according to Inglehart and Welzel (2007), protest participation is one of the prerequisites for an effective democracy. From a normative perspective, a protest plays a significant part in the cultural, civil, and political life of citizens. It encourages the spread of engaged and informed citizens and aims to strengthen democracy by enabling direct participation in public affairs. (Inglehart and Welzel, 2007). Pierre Rosanvallon, therefore, rightly speaks of the "pluralization of the temporalities of democracy" as a normative postulate (Rosanvallon, 2006, p. 206). In a democracy, he states, "our awareness of time must be attentive in the case of memory, long in constitutionalism, variable for the different institutions, short in the formation of opinion; and all these, in turn, must adapt to each other" (Rosanvallon, 2006, p. 207).

In contrast, defining the concept of protest in a post-communist country demands reviewing the broader picture of political participation. Here, it is understood as 'enabling individuals and groups to express dissent and grievances, share views and opinions, expose flaws in governance and publicly demand that the authorities rectify problems and are accountable for their actions.' (Inglehart, 1997; Inglehart and Catterberg, 2002). When participating on the streets, citizens indicate their dissent and, even more importantly, put politicians under pressure to consider these dissents when formulating policies. On the other hand, what about political participation in an exceptional environment like a post-communist country?

Sidney Verba and Norman Nie (1972) were the first authors to conceptualize political participation as 'activities by private citizens that are more or less directly aimed at influencing the selection of governmental personnel and their actions (Verba & Nie, 1972, p. 2). This conceptualization was mostly restricted to actions to influence the government and was too "thick" to describe the multitude of political engagements in consolidated democracies, let alone political activities in post-communist countries. Soon after, Kaase and Marsh (1979a) introduced a significant distinction between political participation, separating it into two categories: "conventional" and "unconventional" political participation. However, even this conceptualization is unfitting for a post-communist country. Employing such a concept would be short of inconsistency. Because, as Greskovits has put it, '[there] is no exaggeration to think about their entire [communist] political realm as unconventional almost by definition.... the assumption [is] that political participation has been an evolution from the unconventional to the conventional in new post-communist democracies' (Greskovits, 1998, pp. 73-74).

More concretely, in communist Albania, the regime shows elevated levels of political participation, characterized by mass political gatherings and almost absolute voter participation rates. This participation was worthless since it was obligatory and did not allow citizens to communicate beliefs about their political preferences. As the regime began to open up to political expression and competition, this process involved massive demonstrations, student strikes, and other forms of collective protest that brought the system change. According to Dalton and Klingemann, "In new democracies, the challenge is to engage the citizenry in meaningful participation after years of a ritualized engagement or actual prohibitions on participation. In some cases, this experience is a mirror image of old democracies. In old democracies, citizens are moving from conventional to unconventional politics; in new democracies, citizens often toppled authoritarian regimes by revolutionary upheavals and now learn the routines of conventional participation" (Dalton & Klingemann, 2007, p. 15). The demobilization of movements characterizes Albania's post-communist period, which was out of state control as the state institutionalized politics as a hard-to-die old-system legacy. For a highly repressive closed regime, firstly, liberalize, then strive harder for democratization since political liberalization is not an inevitable transition phase to democracy. However, it can ensue in a hybrid system that blends liberalization with autocracy. Protest levels rose and then fell as the state remained in its old-fashioned activity as an all-controlling inhibitor apparatus.

This paper draws on qualitative methods employing an interpretive analysis of the state of protest participation and its effect on democratic consolidation. In this analysis, we consider it appropriate to avoid complex debates about concept definitions

and the uses and misuses of methods but clarify the country's current political deeds. The article begins with a brief presentation of a conceptual framework, followed by in-depth analyses of the country's experience with protest actions as prerequisites toward democratic consolidation and the state's role in this endeavor. However, from a standard methodological viewpoint, the question "What causes what?" could be addressed: How does the state commit itself to mobilizing measures that promote or prevent social movement?

The literature review is normative-oriented and might give the impression of being detached from the specificity of cases. Furthermore, this choice of literature was forced by the irrelevance and the lack of domestic studies on the role of protests in post-communist countries, the capture of protests by specific movements at specific points in time, the negative and often chaotic part of protests, and their role in state collapse. We mean normative arguments about protests as a clear indicator of mobilization of the powerless and evolving democratization are difficult for a clear-cut in a chaotic post-communist environment. Here, protests can have ideals but often represent the traits of post-authoritarian societies and politics. Thus, they can be a form of resistance towards real change rather than movements triggering change. Politics can also use and capture them for specific daily interests, such as protests that aim to protect illegally built constructions in the context of an infrastructure project in Tirana since 2018 and until our days. In these cases, people who have occupied others or public property and several territories have mobilized to protect their illegal buildings, with support from opposition parties. Nevertheless, on the other hand, the state displays no transparency on the area development, raising suspicions of corruption affairs for the private interest

of the construction industry and leaving the affected people with no alternative for a vital commodity such as the home. Therefore, this article attempts to shed light and clarify the threefold nexus of protests, state, and democratization in this exceptional political environment.

Democracy's Predicament in Post-Communist Albania

Uprisings against authority transpired in Albania throughout history, but with the installation of the Communist regime, Albania's political orientation shifted toward isolation. Along with the Enver Hoxha era, the politics of violence slanted towards anyone who dared to challenge the regime's power. This statecraft was the veiled political culture Albanian citizens internalized during those years. Liberal values such as tolerance, intersubjective trust, and pluralism of ideas were eradicated decade after decade (Rose, 1994, pp. 18-30). In the vocabulary of the civic culture approach, Albanian citizens can be characterized under subject grouping, or as Almond and Verba put it, "the law is something he [the subject] obeys, not something he helps shape" (Almond & Verba 1963, p. 118).

Nevertheless, mobilizing a socialization process coexisted with participatory elements in Communist political culture, such as high-level popular participation in façade elections and forced 'public activity.' These participation elements declined as Enver Hoxha became uneasy about Marxism-Leninism ideology losing its hold over the Albanian people. The second constitution, enacted in 1976, classifies freedom of speech, press, and assembly as inferior to individual duties towards society. This classification has opened the door to punishing people for criticizing the government's goal or actions under the pretext of maintaining

a peaceful community. As Ekiert & Kubik (1999) put it, "The most important social legacy of the pre-1989 system was a specific structure of social cleavages. Due to the ontological uniqueness of state socialism, the main protagonist in the struggle between "the state" and "society" (the main collective actors in this system) was constituted through a cultural-political rather than economic-political process". Therefore, as we said elsewhere, the Albanian Communist legacy destroyed any precondition for internalizing democratic ethos (Ferrara, 2014) in the abstract sense, let alone political behavior.

Due to the long systemic oppression exercised by the Communist regime, mobilization in Albania reached its peak between 1990 and 1992. Citizens, workers, and students dominated the bulk of protests in the 90s, marching, striking, and hunger striking in pursuit of freedom and democracy. In the elections of March 91, the Democratic Party (here and after DP) did not win the majority in parliament. Due to internal and external pressure, the elections were held the following year, and the DP won the majority of seats in the newly constituted parliament. The DP governed until 1997. The DP's government conducted a series of reforms to liberalize the country, build a free-market economy, ensure the rule of law, and consolidate the democratic electoral system. Albania signed vital cooperation agreements with European countries and beyond during this opening to the Western world.

Sali Berisha's Presidency outside Albania resembles a nascent democracy, marked by the common shortcomings that one would imagine seeing in a developing country. Whereas, internally, the situation was out of the ordinary for a nascent Democracy. Since the system changed, social tension, political conflict, and the oppression of opposition voices and actions

characterized Berisha's governing. This political style showed that tension and confusion were more suitable adjectives for Berisha's era than typical for a nascent democracy.

Pyetësi online i shpërndarë në rrjetet sociale mori 767 përgjigje. Pyetje të rëndësishme të pyetësit online për memet, në këndin e teorive të kënaqësive mbi audiencat, janë edhe ato të shkaqeve pse ndiqen memet, tematikat e memeve që ndiqen, reagimi i parë kur shihet një meme, koha e ndjekjes, komunikimi me miq nëpërmjet memeve, varësia ndaj memeve dhe ndryshimi i mendimit, rritja e popullaritetit të personazheve që bëhen meme si dhe si audiencia i do memet në të ardhmen. Megjithëse vihet re një shpeshi e memeve të lidhura me politikën në Shqipëri, audiencat përgjigjen se tematika kryesore për të cilën janë të interesuar të ndjekin është ajo nga jeta e përditshme (50.5%), aktualiteti (25.3%) dhe politika (17.9%). Sjelljet e audiencave në raport me përdorimin e memeve tregojnë se kryesisht ata i kuptojnë menjëherë dhe se ose i shohin memet sa herë t'u jepet rasti, ose se nuk e vënë re kohën kur i shohin. Ata thonë se nuk kanë krijuar varësi nga memet. Ajo që vihet re në dëshirën e audiencave për mënyrën se si duhet të zhvillohen memet në të ardhmen, është se kërkohet që të nxisin të menduarin më shumë (33.1%) dhe në radhë të dytë të shkaktojnë më shumë humor (26.8%). Si arsye e tretë është të demaskojnë politikën më shumë (14.7%), gjë që lidhet edhe me sensin e rebelimit ndaj politikës në sjelljet e konsumimit të memeve. Audiencat

janë përgjigjur se kohët e fundit kanë qeshur më shumë me meme ku personazh ka qenë Lulzim Basha, ish-kreu i PD-së me 29.2% të përgjigjeve. Pas tij renditen të tjerë personazhë të paspecifikuar, ndërsa në vendin e tretë renditen memet me në qendër personazhin Edi Rama, kryeministri i vendit me 18.2%. Më tej renditen memet me në qendër personazhin Erion Veliaj, kryebashkiak i Tiranës me 10.4% të 767 përgjigjeve.

Përfundime

Audiencat shqiptare i përdorin memet në rrjetet sociale më shumë se sa një video, foto ose tekst. Këto audiencia ndërveprojnë me njëra-tjetrën për memet dhe përmes memeve në hapësirat digjitale. Ndonëse arsyeja kryesore që audiencat thonë se i përdorin memet është argëtimi, efektet shtrihen më gjerë te to pasi edhe pse thonë se mendimi i tyre nuk ndryshon ndërsa shohin një meme, ata shfaqin kuriozitet për të kërkuar informacion të mëtejshëm mbi temën. Audiencat mendojnë se personazheve që trajtohen në këto meme u rritet popullariteti.

Ajo që vihet re në dëshirën e audiencave për mënyrën se si duhet të zhvillohen memet në të ardhmen, është se kërkohet që të nxisin të menduarin më shumë dhe në radhë të dytë të shkaktojnë më shumë humor. Si arsye e tretë është të demaskojnë më shumë politikën, gjë që lidhet edhe me sensin e rebelimit ndaj politikës në sjelljet e konsumimit të memeve.

REFERENCAT

- Dawkins, R., (2006). *The Selfish Gene*, Oxford: Oxford University Press
- Katz, E., Blumler, G.J, Gurevitch, M. 1974. *Uses and Gratifications Research*, The Public Opinion Quarterly, Winter, 1973-1974, Vol. 37, No. 4 (Winter, 1973- 1974), Oxford University Press on behalf of the American Association for Public Opinion Research
- Katz, E., Lazarsfeld, F.P. (2017), *Personal Influence-The Part Played by People in the Floe of Mass Communications*, Routledge
- Shifman, L. (2014). *Memes in Digital Culture*, MIT Press
- Walther, B. J. (2015). *Social Information Processing Theory (CMC)*, <https://doi.org/10.1002/9781118540190.ebeic192>

ABSTRACT

In this study, the goal is not only to learn about memes as a media product, but above all to know the Albanian social media audiences and the ways in which these audiences use memes and participate in the process of their creation and distribution. For this reason, several research questions were raised: 1-What is the effect of memes on audiences? Are audiences influenced by memes? 2-What do audiences have to do with memes? 3-What are the main reasons why they like it? 4-Who creates memes: the audience itself, media, politics, individuals-authors and how is the topic of memes generated? 5-Why is communication through memes used? (Do memes increase the popularity?) 6-What needs does the audience have that the media must fulfill? To answer these questions, in 6 months (January-June 2020) a mixed methodology was used with methods such as: focus group, monitoring, semi-structured interviews with meme creators and online questionnaire. In conclusion, Albanian audiences use memes in social networks more than a video, photo or text. These audiences interact with each other about memes and through memes in digital spaces. While the main reason audiences say they use memes is entertainment, the effects extend beyond them as even though they say their opinion doesn't change after seeing a meme, they show curiosity to seek further information on the topic. Audiences feel that the characters featured in these memes increase their popularity.

Keywords: *Memes, Albanian Audiences, Albanian Media, Social Networks, Audience Interaction*

ORIENTALIZMI DHE BALLKANIZMI: BALLKANI SI TJETËRSI FETARE E EVROPËS DHE AUTO-ORIENTALIZMI SHQIPTAR

Murat ALIU

Universiteti "Nënë Tereza"-Shkup

E-mail: murat.aliu@unt.edu.mk

PËRMBLEDHJE

Ndarja e botës në Lindje dhe Perëndim ka qenë një realitet që nga kohërat e lashta. Megjithatë, me shfaqjen e orientalizmit si disiplinë shkencore dhe diskurs politik, ky dallim është bërë edhe më i mprehtë dhe pashmangshmërisht ka prodhuar edhe pasoja politike. Kjo ngase orientalizmi institucionalizoi dhe normalizoi ndarjen e botës në Lindje dhe Perëndim dhe rrjedhimisht edhe mitin e epërsisë së Perëndimit ndaj Lindjes, gjë që rezultoi me stigmatizimin e kësaj të fundit si primitive, barbare, fanatike etj. Ndërkaq Ballkanizmi qoftë si një variacion i orientalizmit qoftë si i pavarur nga ai është një nocion që i ngarkon kuptime negative Ballkanit dhe popujve ballkanik. Në këtë kontekst Ballkani nga perëndimi imagjinohet si një botë e kundërt me atë të Perëndimit. Duke qenë kështu popujt ballkanik në fillim të procesit të modernizimit dhe përbrendësimit të vlerave perëndimore filluan procesin e de-orientalizimit dhe de-ballkanizimit. Parë nga ky këndvështrim përpjekjet e para të shqiptarëve për "arratisje nga Lindja" filluan në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX, atëherë kur filloi edhe procesi i modernizimit shqiptar dhe kombformimit. Kësaj fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX është edhe datëlindja e orientalizmit shqiptar. Rilindësit të ndikuar nga diskursi orientalist theksuan origjinën dhe identitetin evropian të shqiptarëve me qëllim të orientimit vleror të kombit shqiptar drejtë Europës. Duke u nisur nga kjo në këtë studim do të analizohet auto-orientalizmi shqiptar si një përpjekje e "tjetrizimit" apo "stigmatizimit" të një pjesë të kombit shqiptar si lindorë nga një pjesë tjetër e cila e përfytyron veten si "europiane" dhe bartëse e procesit të evropianizimit të shqiptarëve. Në këtë kontekst shqiptarët e Shqipërisë konsiderojnë vetën më "europian" se sa shqiptarët e Kosovës, ndërkaq Shqiptarët e Maqedonisë janë "lindorët" si në optikën e shqiptarëve të Shqipërisë ashtu edhe në atë të shqiptarëve të Kosovës.

Fjalë kyçe: *orientalizmi, ballkanizmi, auto-orientalizmi, religjioni, auto-orientalimi shqiptar*

Murat ALIU është lektor në Universitetin “Nënë Tereza”-Shkup. Studimet master dhe të doktoraturës i ka kryer në Universitetin e Stambollit, departamenti Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. Murat Aliu është autori i një monografie dhe punimeve të ndryshme shkencore nga lëmia e shkecape dhe teorisë politike. Ideologjitë politike, teoritë bashkëkohore politike, filozofia politike, identiteti janë fushat e studimit në të cilat jep kontribut autori në fjalë.

Në mesin e shekullit 19 gjithkund nëpër shkollat europiane mësohej një histori e çuditshme sipas së cilës të gjitha zhvillimet e rëndësishme në historinë njerëzore u shpërfaqen në kontinentin i cili quhej “Europë”. Në tekstet e historisë që pasqyrojnë karakteristikat e kësaj periudhe, por jo vetëm, Kopshti i Edenit përmendej si pikënisja e historisë njerëzore dhe në këta libra Kopshti i Edenit gjendej në Europë, gjë që kishte për qëllim Europën ta vendos në qendër të historisë njerëzore. Në mënyrë të ngjashme, nëpër librat e gjeografisë të mesit të shekullit të 19-të, popujt që jetonin në Afrikë dhe Azi do të përshkruheshin jo vetëm si inferiorë, por edhe si demonikë në disa mënyra. Ata përshkruheshin si njerëz që refuzuan të pranonin hirin e Perëndisë dhe kështu ata ngelën jashtë mëshirës së tij. Disa nga mësuesit europianë përgjatë shekullit XIX do të pretendonin se vetëm njerëzit e Evropës ishin vërtet njerëzorë. Popujt e vendeve të tjera imagjinoheshin si specie të ndryshme, jo njerëzore.

Rrënjët e kësaj qasje përjashtuese ndaj të gjithë “jo europianëve” nga europianët ose e kësaj dialektike në mes europianëve dhe joeuropianëve mbase shkojnë thellë në histori. Por artikulimi shkencor i kësaj qasjeje eurocentrike, pra një botëkuptim sipas së cilit “gjithçka filloi në Europë” dhe “gjithçka vërtitet” rreth saj, kryesisht u bë nga filozofët, shkrimtarët, udhëpërshkruesit, politikanët të cilët theksuan superioritetin e racës së bardhë ndaj racave tjera. Ndërkaq me lindjen e orientalistikës si disiplinë shkencore orientalistët profesionistë, pra shkencëtarët që merreshin me studimin e Lindjes pikëpamjet ose botëkuptimet eurocentrike u sistematizuan, kategorizuan

dhe argumentuan në mënyrë shkencore.

Një nga përfundimet thelbësore të orientalistëve, qoftë atyre “joprofesional” qoftë atyre që punonin në institutet të specializuara për studimin e Lindjes ishte se ekzistonte një dallim ndërmjet dy botëve: Perëndimit dhe Lindjes. Orientalistët dhe orientalizmi nuk hezitoj që këtyre dy botëve të ndryshme, absolutisht të papajtueshme t’u ngarkoj kuptime të cilët shpesh herë nuk përkonin me realitetin objektiv. Kësisoj Perëndimit iu ngarkuantribute dhe kuptime pozitive, ndërkaq Lindja u përfytyrua si anti-tezë e gjithë asaj që ishte apo përfaqësonte Perëndimi. Perëndimi u identifikua me qytetërimin, progresin, zhvillimin, teknologjinë, demokracinë etj., ndërkaq Lindja u bë sinonim i primitives, barbarisë, të shëmtuarës, despotizmit etj.

Duke u nisur nga raporti dije-pushtet të artikuluar nga Michel Foucault, kjo dije e prodhuar mbi Lindjen dhe përfytyrimi i saj si barbare, primitive, mistike etj., përligji vendosjen e hegjemonisë politike, ekonomike dhe kulturore të Perëndimit mbi Lindjen. Pas “zbulimit” të Lindjes dhe pas orientalizimit të saj filloj të marrë formë edhe ideja mbi misionin që i takonte Perëndimit për të “qytetëruar” Lindjen dhe pjesën tjetër të botës. Thënë ndryshe ishte pikërisht dija e prodhuar që legjitimoi kolonializmin dhe imperializmin perëndimor. Nga ana tjetër, është pushteti ai që përligj dijen. Kësisoj në saje të dominimit politik, ekonomik dhe kulturor diskursi orientalist u përhap dhe u bë i pranueshëm edhe për shoqëritë jo-europiane. Sot e kësaj dite dija eurocentrike dhe orientaliste ruan hegjemonin e saj si një paradigmë e vlefshme shkencore për të përshkruar dhe shpjeguar “botën”.

Kështu diskursi orientalist shoqëroi

procesin e modernizimit dhe formimit të kombit edhe në Ballkan, rrjedhimisht edhe procesin e modernizimit dhe kombformimit shqiptar. Diskursi orientalist i cili u përhap në të gjithë pjesët e Europës dhe në shoqëritë koloniale shërbeu si një instrument i fuqishëm për rivlerësimin dhe ripërcaktimin e orientimit vleror të shqiptarëve. Rilindësit dhe të tjerët para dhe pas pavarësisë të shtetit shqiptar theksuan se Perëndimi ishte e vetmja rrugë për shpëtimin e kombit nga errësira dhe prapambetja orientale në të cilin kombi shqiptar ngeli i ngujuar për më shumë se pesë shekuj. Kështu edhe shqiptarët përbrendësuan orientalizmin si një diskurs i gatshëm pa asnjë vlerësim kritik. Ndërkaq për të dëshmuar europianitetin e tyre edhe shqiptarët (elitët politike dhe kulturore) krijuan orientin brenda botës shqiptare. Pra, ajo pjesë e kombit e cila nuk ndan të njëjtat pikëpamje me elitat në fjalë përkarshi Lindjes, religjionit, vlerave dominuese etj., u orientalizua dhe identifikua me Lindjen, barbarinë, primitivën, dhunën etj.

Orientalizmi dhe ballkanizmi

Orientalizmi është një disiplinë akademike e cila për herë të parë u shfaq në fillim të shekullit të 14, atëherë kur këshilli i Kishës së Vjenës morr vendimin të krijoj katedra në një numër universitetesh me qëllim për të promovuar të kuptuarit e gjuhëve dhe kulturave orientale ose lindore. Shtysa kryesore për njohjen e Lindjes buronte nga tregtia, rivaliteti dhe konflikti ushtarak. Prandaj, dija mbi Lindjen nuk mund të izolohet nga historia e ekspansionit evropian në Lindjen e Mesme dhe Azi. Zbulimi i rrugës për në Azi nga Kepi i Shpresës së Mirë nga Vasco de Gama në 1498 ndihmoi shumë në zgjerimin e fushës së orientalizmit. Megjithatë, vetëm në shekujt e 18 dhe 19 në Evropë do të botohen një numër i konsiderueshëm studimesh serioze dhe të hollësishme me qëllim të njohjes së shoqërive lindore

në mënyrë më objektive. Themelimi i Shoqërisë Aziatike (Bengal) në Britani në 1784 dhe i Shoqërisë Mbretërore Aziatike në 1823 ishin momente të rëndësishme në zhvillimin e perspektivave perëndimore. Zhvillime të ngjashme ndodhën në Francë në 1821 me Institut d’Egypte dhe Societe Asiatique të Napoleonit. Shoqata e parë orientaliste në Gjermani u themelua në vitin 1845. Nëpërmjet këtyre dhe institucioneve të ngjashme, u zhvilluan dhe u institucionalizuan njohuritë për shoqëritë lindore, kërkimet filologjike dhe njohja e gjuhëve orientale (Turner, 2002, f. 67).

Nocioni orientalizëm fjalë për fjalë do të thotë shkenca mbi Lindjen. Parë nga këndvështrimi etimologjik origjina e tij bazohet në fjalën latine orient, që do të thotë agim ose vendin ku lind dielli. Shprehja orient përdoret për të shënjuar Lindjen në kuptimin gjeografik. Si koncept ideologjik dhe politik, orientalizmi është një formë e gjykimit që përfshin institucione kulturore, fjalë, disiplina shkencore, përshkrime, doktrina, koncepte, diskurse. Orientalizmi është një disiplinë akademike dhe diskurs që studion, njeh, kritikon, gjykon dhe disiplinon Lindjen. Orientalizmi shënjon “rrjetin e njohurive mbi Lindjen”. Orientalizëm është emri i një strukture të madhe njohurish në të cilën përshkruhen dhe thuhën fjalët e thëna, studimet, libra e udhëtimit, kujtimet për botën e quajtur “Lindje”. Këto të dhëna për njohjen e Lindjes janë të dhënë të pasqyruar përmes thjerrëzave të Perëndimit (Arlı, 2023, f. 30).

Orientalizmi është një mënyrë e të menduari, e mbështetur në dallimin ontologjik dhe epistemologjik që bëhet ndërmjet “Lindjes” dhe “Perëndimit”. Autor, poetë, romancierë, udhëpërshkrues, filozofë, teoricien të fushave të ndryshme, e kanë pranuar këtë dallim ndërmjet këtyre dy botëve si pikënisje për teori të përpunuara, për epose, romane, përshkrime shoqërore dhe raporte politike lidhur me Orientin, me njerëzit e tij, zakonet, “mendësinë” etj. (Said,

2009, f. 24). Në këtë kontekst sipas Edward Said-it, orientalizmi parashpreh gjithash është një diskurs. Said argumenton që orientalizmi si një diskurs ka prodhuar Orientin, politikisht, sociologjikisht, ushtarakisht, ideologjikisht shkencërisht dhe artistikisht gjatë periudhës pas Iluminizmit. Kështu Lindja është hapësira e kolonive më të mëdha, më të pasura e më të vjetra të Evropës, burimi i qytetërimit dhe i gjuhëve të saj, kundërvënsi kulturor i saj si dhe një nga imazhet më të shpeshta e më të thella për Tjetrin (Said, 2009, fv. 23-24). Turner argumenton që duke marr për bazë trinomin dije-diskurs-pushtet të Foucault-së, orientalizmi është një diskurs që krijon tipologji në të cilat mund të shpërndahen personazhet; njeriu energjik perëndimor kundrejt orientalit epshor, i bardhi i butë kundrejt njeriut të verdhë mizor, perëndimori racional kundrejt lindorit të paparashikueshëm. Lindja është thelbësisht e çuditshme, ekzotike dhe misterioze, por edhe sensuale, irracionale dhe potencialisht e rrezikshme. Këtë çudi orientale mund ta kuptojnë vetëm ekspertët e kulturave lindore, veçanërisht ata me ekspertizë në filologji, gjuhë dhe letërsi. Funkzioni i orientalizmit është të reduktojë këtë kompleksitet mahnitës të shoqërive dhe kulturave lindore në një nivel të menaxhueshëm dhe të kuptueshëm (Turner, 2002, f. 77).

Sipas Saidit, pikënisja e orientalizmit ishte orientalizmi i Lindjes dhe këtë e bëri në kontekstin e pabarazive themelore koloniale. Në këtë kuptim, orientalizmi zbulon marrëdhëniet institucionale dhe historike midis njohurive të shoqërive dhe kulturave lindore dhe fuqive imperialiste e koloniale. Së këndejmi orientalizmi është një instrument politik që shërben për të vendosur hegjemonin e gjithanshme të perëndimit ndaj Lindjes. Marrëdhënia ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes është një marrëdhënie pushteti, sundimi dhe shkallësh të ndryshme të një hegjemonie komplekse. Lindja u lindorizua jo vetëm sepse u zbulua

se ishte “oriental” në të gjitha ato mënyra të vështruar si gjëra të zakonshme nga njeriu i zakonshëm evropian, por edhe sepse ai mund të bëhej, domethënë nënshtruar për t’u bërë oriental (Said, 2009, f. 28). Duke u nisur nga këtu duhet thënë që orientalizmi është diçka më shumë se sa diskurs apo ligjëratë mbi lindjen.

Said duke ndjekur Foucault orientalizmin e ndërton si një aparat i dijes dhe pushtetit. Në këtë kontekst dija orientaliste është ngushtë e lidhur me pushtetin politik, ekonomik dhe imperialist. Pra imperializmi politik dhe ekonomik perëndimor u bë i mundur vetëm përmes prodhimit të dijes orientaliste. Kështu dija orientaliste është ajo që legjitimoi imperializmin dhe kolonializmin perëndimor mbi pjesën tjetër të botës. Duke u nisur që dija prodhon pushtetin dhe pushtin dijen, orientalizmi është një pushtet politik, ekonomik dhe kulturor. Është një proces hegjemonist, një proces qendërkrijues; është qendërzim. Thelbi i kësaj hegjemonie është: letrare, shkencore, politike etj. Riprodhuar në stile të ndryshme ligjërimi dhe me një lëvizje komplekse strategjike që artikullohet në nivele të ndryshme institucionale të pushtetit politik, ekonomik, akademik, moral etj., Perëndimi vendos identitetin e tij duke e dalluar atë nga një hapësirë që e shënjon si “tjetri”. Lindja shënjohej si e ndryshme dhe e vendosur si një vend “tjetër” që kërkon një fushë të veçantë ekspertize. Me fjalë të tjera, orientalizmi, përveçse një disiplinë akademike, është edhe një mjet për të menaxhuar, kontrolluar, disiplinuar dhe nënshtruar Lindjen. Në këtë kuptim, dija mbi Lindjen përbën bazën e kolonializmit perëndimor. Ky akt dominimi zhvillohet brenda një marrëdhënieje komandë-urdhër. Lindja është emocionale, irracionale, e paaftë të shprehet, e paaftë të përfaqësojë vetveten e paaftë të udhëheq veten dhe duke qenë kështu ajo duhet të përfaqësohet/udhëhiqet (Mutman, 1996, f. 30).

Si lindja ashtu edhe Perëndimi janë

vepër e përfytyrimit. Lindja është tjetri imagjinar i Perëndimit. Ndërkaq Perëndimi është një vend që mbush zbraçëtitrat e mendjes; është një vend fantazie, ku mendja perëndimore ka qejf të dal në piknik. Është një fikcion. Lindja ka ndihmuar për të përcaktuar Evropën si imazhin, idenë personalitetin dhe përvojën kontrastuese të saj (Said, 2009, f. 23). Perëndimi, që në kohën kur nuk ekzistonte ndarja e botës në Lindje dhe Perëndim, e shënoi Lindjen, më pas e përkufizoi vetën si Perëndim, ose si jo-Lindje. Kështu Perëndimi identitetin e tij e përfytyron si antipod i identitetit të lindjes. (Metin, 2022, f. 56). Meqenëse në thelb diskursi orientalist krijon ndasi dhe thekson dallimet, prodhimi i Lindjes është gjithmonë rezultat i një procesi ndarjeje dhe tërheqjeje vijash, referimi ndaj një “tjetri”. Në këtë kuptim, orientalizmi është mënyra ose diskursi për të krijuar apo ndërtuar subjektin imperialist perëndimor (Mutman, 1996, f. 30). Orientalizmi është një proces i prodhimit të identitetit. Ky identitet ndërtohet në formën e “Ne” (perëndimorët) dhe “Ata” (lindorët). Si çdo konstrukt identiteti edhe orientalizmi në ndërtimin e subjektit vë në funksion logjikën e përfshirjes/përfshatimit. Orientalizmi shërben si një pasqyrë për vetëpërkufizimin a vetëidentifikimin e Perëndimit. Perëndimi duke vendosur kufijtë simbolik mes tij dhe Lindjes dhe duke i portretizuar si dy botë krejtësisht të ndryshme, identitetin perëndimor e imagjinoi si një kundrinë absolute e Lindjes. Kur Lord Cromer-i fliste për njerëzit lindorë, ai argumentonte se lindorët veprojnë, flasin dhe mendojnë në një mënyrë krejtësisht të kundërt me mënyrën evropiane. Por nga ky këndvështrim, me diskursin e orientalizmit, Evropa përshfaq identitetin e vet modern duke tjetërsuar apo përjashtuarin të ndryshim. Sipas Saidit, në periudhën e pas-Iluminizmit, kultura evropiane identitetin dhe pushtetin e vet e krijoi duke u pozicionuar kundër pozicionit identitar të përcaktuar si Orient.

Orientalizmi është procesi i vendosjes së dominimit mbi botën nga Perëndimi dhe kjo hegjemoni u krijua duke e ndërtuar në mënyrë diskursive Lindjen dhe duke e prodhuar atë si një identitet tradicional antiperëndimor. Përfytyrimi dhe ndërtimi i “tjetrit” përbën thelbin e qytetërimit dhe kulturës evropiane. Pikërisht ideja e tjetërsisë, në këtë rast Lindja si “tjetri” i Europës bëri të mundur konsolidimin e identitetit evropian. Ndërsa Perëndimi e imagjinoi veten si modern, progresiv, demokratik, zhvillimor dhe individualist, ai i atribuon Lindjes cilësi të kundërta: tradicionale, fanatike, të pazhvilluara, kolektivistike, autoritare (Keyman, 2002, f. 21).

Por jo vetëm Lindja, edhe Ballkani dhe Europa Lindore kanë qenë objekt i tjetërsimit dhe stigmatizimit të Europës dhe Perëndimit pikërisht duke u bazuar në dallimet, mos epistemologjike dhe ontologjike, atëherë kulturore dhe fetare. Ballkani ose vendet e Ballkanit ndonëse gjeografikisht pjesë e Europës, për shkak të së kaluarës së tyre të gjatë nën sundimin e qytetërimeve lindore janë trajtuar një mish i huaj në trupin e Europës dhe Perëndimit. Këtë fenomen të tjetërsimit të Ballkanit nga Evropa dhe Perëndimi, studuesja Maria Todorova e analizon dhe shpjegon përmes nocionit të Ballkanizmit/Ballkanizimit.

Ballkanizimi jo vetëm që përdoret për të përshkruar copëzimin e njësive politike të mëdha e të qëndrueshme, por është bërë edhe sinonim i kthimit në gjendje tribale, të prapambetur, primitive dhe barbare. Ballkanizmi fitoj peshë në qarqet akademike dhe politike Evropiane dhe Perëndimore në fillim të shekullit XX, kryesisht përgjatë luftërave Ballkanike. Lajmet mbi barbaritë që po kryheshin në Ballkan vërshonin duke sfiduar lëvizjet për paqe jo që ishin vetëm duke u forcuar, por edhe duke u institucionalizuar në Europë (Todorova, 2013, f. 15). S’ka asnjë dyshim që në fillim të shekullit XX Ballkani identifikohet me dhunën rrjedhimisht edhe një kulturë, vlera

dhe parime të kundërt me ato të Europës. Historiani Mark Mazower argumenton që shprehja Ballkan nuk asoconte një përkufizimin gjeografik, ashtu siç kishte ndodhur para shekullit XX, por përdorej si nocion i ngarkuar me kuptime negative. Kur përmendej Ballkani në imagjinatë zgjonte imazhet e dhunës, barbarisë dhe primitivitetit. Kështu gazetari Harry de Wind në pyetjen pse librin e tij të botuar në vitin 1907 e kishte pas titulluar *Europa e Egër*, sigurisht duke iu referuar Ballkanit me këtë emër, ai ishte përgjigjur se ky përkufizim ose ky mbiemër i përshkruan më së miri vendet midis Adriatikut dhe Detit të Zi, karakteristik kryesore e të cilave është mos ekzistenca e ligjit. Rebecca West në udhëpërshkrimin e saj *Black Lamb and Grey Falcon* thotë që “kur përmendet Ballkani nuk më vjen në mendje asgjë përveç barbarisë.” Vazhdon ajo duke thënë që, “kjo është e vetmja gjë që di në lidhje me rajonin Jugor të Sllavëve” (Mazower, 2017, fv. 29-33). Ndërkaq udhëtarja dhe shkëmbimtarja angleze, Edith Durham, shkruan që:

Masat ballkanase jetojnë jetën e kohëve të kaluara aq shumë sa ne të Perëndimit e kemi të vështirë t'i kuptojmë. Është një tokë e mbuluar me shtresa perandorish të vdekura, popuj ndjekur njeri-tjetrin, ndërlikohen me njeri-tjetrin, ngrihen dhe rrëzohen, gjatë shekujve të mugët e barbarë, të përlyer e të vezulluar me shkëlqimin e madhështive të kohëve të moçme, duke u munduar secili për vete, në përpjekje të egra për ekzistencë... (Durham, 2009, f. 18)

Sigurisht shembujt e këtyre mundë të dhjetë e qindfishohen. Këto shembuj u pasqyruan me qëllim për të ilustruar atë që u tha më lartë se Europa dhe Perëndimi në përgjithësi Ballkanin e përfytyronin si një botë pothuajse absolutisht e ndryshme me atë të tyre. Në këtë kontekst parë nga pikëvështrimi ligjërimit dhe të teksteve të “perëndimorëve” se si e përshkruajnë

Lindjen dhe Ballkanin, fitohet përshtypja që nuk ekziston asnjë dallim në mes tyre. Pikërisht ky diskurs kjo ka bërë që shumë kush ballkanizmin ta interpretoj si një variacion i orientalizmit.

Por përkundër kësaj, Maria Todorova argumenton që ballkanizmi nuk është një variacion i orientalizmit. Pa hyrë në dallimet specifike të cilat i thekson Todorova për ta argumentuar këtë tezë, do të mjaftohemi duke thënë se dallimi thelbësor ndërmjet orientalizmit dhe ballkanizmi është se Lindja paraqet “tjetrin absolut” dhe të papajtuashëm të Perëndimit. Ndërkaq kjo nuk është rast me Ballkanin. Nisur nga këtu sipas Todorovës ajo çka në pothuajse të gjitha përshkrimet e Ballkanit jepet si karakteristik e tij qendrore është gjendja e tij transitore. Përderisa Perëndimi dhe Lindja zakonisht paraqiten si entitete të papajtuashme, si antibiotë, si antibiotë të kompletuara, Ballkani, nga ana tjetër, gjithmonë ka përfituar imazhin e një ure ose të një udhëkryqi. Ballkani është një urë ndërmjet Perëndimit dhe Orientit, ndërmjet Europës dhe Azisë. Ballkani, gjithashtu është urë ndërmjet stadeve të zhvillimit, gjë që ndjell etiketime të tilla si gjysmë i zhvilluar, gjysmëkolonial, gjysmë i qytetëruar, gjysmëoriental. Në këtë kontekst Ballkani është tjetri i paplotë i Europës. Pra ai nuk konstruktohet si tjetër absolut, por si vetvetja e paplotë e Europës (Todorova, 2013, fv. 15-41).

Duke qenë gjeografikisht i pandashëm nga Europa, e megjithatë kulturalisht i konstruktuar si “tjetri” i brendshëm, Ballkani ka qenë në gjendje të absorbojë ashtu siç duhet një sërë frustrimesh politike, ideologjike e kulturore të projektuara jashtë saj, të cilat burojnë nga tensione e kontradikta inhere të rajoneve e shoqërive joballkanike. Me kohë, ballkanizmi u bë një zëvendësues i përshtatshëm për shkëmbimin emocional që sillte orientalizmi, duke e liru Perëndimin nga akuzat për racizëm, kolonializëm,

eurocentrizëm dhe intoleranc të krishterë kundrejt Islamit. Gjithsesi, Ballkani është në Europë; është i bardhë; është kryesisht i krishterë... (Todorova, 2013, f. 274)

Ajo që me ngulm duhet nënvizuar është fakti që edhe orientalizmi edhe ballkanizmi janë diskurse përjashtuese ndër të tjerash edhe mbi baza fetare. Pra edhe orientalizmi dhe ballkanizmi “tjetërsinë” ose lindorinë e “tjetrit” e ndërtojnë duke marrë si pikënisje identitetin fetarë të Lindjes, përkatësisht Ballkanit; identitet ky që domosdoshmërisht ndikon në formimin e botëkuptimeve dhe kulturës së popujve.

Një pjesë e madhe e studimeve të orientalistëve Perëndimorë kanë si objekt studimi shoqëritë myslimane dhe Islamin. Pra, tema kërkimore e orientalizmit është Lindja, kurse në veçanti Islami dhe shoqëritë myslimane. Në këtë kontekst përkatësia fetare e ndryshme e Perëndimit dhe Lindjes, përkatësisht botës myslimane përbën bërthamën e kësaj ndarjeje ontologjike dhe epistemologjike ndërmjet këtyre dy botëve. Këto dallime të botës myslimane me atë të botës perëndimore të krishterë, në masë të madhe kanë formësuar mendimin orientalist dhe përfytyrimet mbi Lindjen. Për të qenë më të saktë, luftërat ose përplasjet shumë shekullore ndërmjet Perëndimit si një qytetërim i popujve të krishterë dhe Lindjes së Afërt si një qytetërim i popujve mysliman përbëjnë themelin e orientalizmit.

Sa do që në rastin e ballkanizmi përkatësia fetare nuk paraqitet fuqishëm si pikë ndarjeje ndërmjet Europës dhe Ballkanit, prap së prap edhe në këtë marrëdhënie duket se dallimet fetare luajnë një rol të rëndësishëm formësimin e ballkanizmit. Pra ashtu siç religjioni ose përkatësia fetare e Perëndimit dhe Lindjes paraqet një motiv i fuqishëm i formësimin të diskursit orientalist, po ashtu fakti që Europa është katolike ndërkaq pjesa më e madhe e popujve Ballkanik janë ortodoks dhe mysliman ka luajtur një rol thelbësor

në krijimin e imazhit të Ballkanit si “tjetri” jashtëm i Europës.

Perandoria Osmane pothuajse në të gjithë tekstat Perëndimore është identifikuar me Lindjen dhe si rrjedhim bota osmane si e huaj për Perëndimin. Kësisoj fakti që Ballkani për gati se për pesë shekuj sundohej nga Perandoria Osmane bëri që Europa dhe Perëndimi Ballkanin ta përfytyrojnë si tjetri i saj Turqit në mendjet e evropianëve përfytyroheshin si një popull aziatik, barbar dhe nomad. Kështu Lord John Russel, argumenton se “Turqit ishin të ndryshëm nga kombet e tjera evropiane në pothuajse çdo aspekt.” R.G. Latham, një nga etnografët më të mirë të epokës viktoriane, thoshte se turqit nuk mund të jenë evropianë, jo vetëm sepse ishin aziatik, por edhe sepse ishin mysliman. Perëndimorët gjithmonë kanë menduar se myslimanët janë të prirur ndaj barbarizmit, ishin barbarë. Gazetari amerikan Frederick Moore do të shkruajë: “Turqit janë myslimanë. Dhe për shkak se ata janë myslimanë, ideja e përparimit është e huaj për ta” (Mazower, 2017: 37).

Ishte perandoria osmane e cila kishte njiçlloshur karakterin evropian të popujve të Ballkanit dhe e cila i kishte shkëputur ata nga historia dhe kultura evropiane, rrjedhimisht nga krishterimi ose katolicizmi si identifikuesi kryesorë i Europës. Janë osmanët ata që Ballkanin e shkëputën nga Europa dhe kthyen në errësirën e mesjetës së hershme. Analizuar nga ky këndvështrim Perandoria Osmane gjithmonë është parë si një element i huaj për kulturën dhe qytetërimin Evropian. Dhe një nga arsyt kryesore për këtë është pikërisht fakti se ajo i përkite qytetërimin islam. Kjo ngase historia e Europës është vetë historia e krishterimit. Ndërkaq nga ana tjetër, fakti që një pjesë e madhe e popujve Ballkanik ishte e krishterë, kryesisht ortodokse nuk ka ndihmuar shumë në përmirësimin imazhit të tyre karshi evropianëve. Siç argumenton historiani polak Oscar Halecki Ballkani para pushtimit Osman ishte nën sundimin bizantin dhe

europianët gjithmonë Perandorinë Osmane e kanë parë me një përçmim (Mazower, 2017, f. 43).

Auto-orientalizmi

Kulmi i rrëfimit orientalist është kur orientalizmi nuk është më vetëm një dominim dhe përfaqësim i Lindjes nga jo-lindorët (perëndimorët), por kur rolin e orientalizimit e marrin përsipër vetë orientalët, të orientizuarit apo vetë të stigmatizuarit nga perëndimorët. Në dekadat e fundit, studiues të ndryshëm kanë propozuar disa terma të ndryshëm që i referohen orientalizimit të orientit nga orientalët: “etno-orientalizëm”, “auto-orientalizëm”, “orientalizëm i brendshëm”, “orientalizëm i kundërt” etj., (Dervišević, 2021). Në kontekstin e temës të cilën po trajtojmë, ne kemi përzgjedhur të përdorimin termi auto-orientalizëm si më i përshtatshëm.

Nocioni auto-orientalizëm (self-orientalism) u përdor për herë të parë nga Antonio Chuffat Latour në vitin 1927 në veprën e tij *“Apunte historico de las chinas en Cuba”* me qëllim të përfaqësimit të komunitetit kinez. Literalisht, shprehja auto-orientalizëm do të thotë “orientalizim i vetvetes”. Parë nga ky aspekt, shpërfaqja e auto-orientalizmit është e kushtëzuar nga ekzistenca e idesë perëndimore dhe botëkuptimeve moderne. Bartës të idesë së auto-orientalizmit është një pjesë e shoqërisë, avangardë e mendimit social dhe politik perëndimor. Auto-orientalizmi shpërfaqet “në prag të kontaktit” në shoqëritë moderne vullnetare ose shoqëritë që janë objekt i kolonializmit. Auto-orientalizmi është shtrembërimi i përfaqësimit të kulturës së vet duke shpjeguar/përfaqësuar “veten” sipas Perëndimit, brenda sistemit të vlerave perëndimore. Auto-orientalizmi lind në kushtet kur një “lindor” (ajo që në të vërtetë nënkuptohet këtu është segmenti social/politik që ne e quajmë elita bartëse)

imagjinatën kulturore dhe referencat lindore të tij i interpreton përmes rrethit hermeneutik perëndimor. Auto-orientalizmi është një strategji politike e përdorur nga elitat modernizuese në procesin e formimit modern të shteteve-kombe në shoqëritë joperëndimore dhe bazohet kryesisht në përbrendësimin e orientalizmit perëndimor (Çiftçi, 2012, fv. 141-143).

Proceset politike dhe shoqërore të komb-formimit përfshijnë trajta të kolonizimit të brendshëm, që nënkupton se kulturat apo traditat e pakicave që nuk arrijnë të përfshihen në kulturën kombëtare, emërtohen të prapambetura ose “lindore” dhe përjashtohen nga kultura kombëtare. Auto-orientalizmi apo orientalizmi i brendshëm kryesisht aplikohet brenda një shteti apo shoqërie të caktuar. Ky nuk është plotësisht i njëjtë me orientalizmin e “jashtëm”, sepse ky i fundit vendos një pengesë të pakalueshme ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, orientalizmi i brendshëm, përderisa vepron brenda një shteti, mundë të pranojë një shkallë të asimilimit dhe integritetit të “lindorëve” në trupin e kombit (Sulstarova, 2019).

(Auto)Orientalizmi shqiptar

Është vështirë të flitet për orientalizmin shqiptar në kuptimin e një disiplinë akademike ku orientalistët shqiptarë shkruajnë mbi Lindjen me autoritetin e kredencialeve akademike apo përvojës në terren. Në vend të studiuesve të mirëfilltë mbi Lindjen, janë shkrimtarë, poetë, gazetar, opinionist të cilët duke marrë për të mirëqenë ndarjen ontologjike dhe epistemologjike ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit përpiqen që identitetin kombëtar shqiptar ta rindërtojnë si modern (Sulstarova, 2019, f. 36).

Sipas Enis Sulstarovës, orientalizmi shqiptar është një diskurs modernizues i elitave politike dhe kulturore, që realitetet shqiptare i ndërton mbi dallimin ndërmjet Perëndimit dhe Orientit, i cili

supozon si dy qytetërime të ndara dhe në dialektik të vazhdueshme me njëri-tjetrin. Orientalizmi shqiptar ka vepruar në kuadër të modernizimit të shoqërisë nga elitat politike dhe intelektuale të disa periudhave, që nga fundi i shek. XIX e deri tani. Ai klasifikohet si orientalizëm i jashtëm kur e përkufizon identitetin kombëtar shqiptar si të kundërt me Lindjen, Orientin e Azinë, dhe klasifikohet si orientalizëm i brendshëm atëherë kur emërton si “orientale” apo “lindore” atë pjesë të shoqërisë, trajtat të organizimit shoqërorë, nënkultura apo “mendësi” brenda shoqërisë shqiptare, të cilat konsiderohen nga elitat si të papranueshme apo të pamjaftueshme për kohën moderne (Sulstarova, 2019, f. 36).

Është me rëndësi të bëhet një dallim midis auto-orientalizmit i cili shfaqet si rrjedhimi i një gjendjeje post-koloniale dhe si rrjedhim i modernitetit vullnetar. Shikuar brenda këtij kuadri (auto) orientalizmi shqiptar është manifestim i modernitetit vullnetar apo procesit të modernizimit shqiptar që filloj bashkë me modernizimin e Perandorisë Osmane nga gjysma e dytë e shekullit XIX. Sigurisht ideja e oksidentalizmit e cila shënjonte aspiratën për modernizimin dhe zhvillimin e Shqipërisë sipas modeleve të shteteve europiane dhe perëndimore u formulua dhe etablua pas krijimit të shtetit shqiptar, gjegjësisht pas Luftës së Parë Botërore. Qytetërimi europain dhe ideja e Europës në këtë periudhë nga elitat politike dhe intelektuale shqiptare u konceptua si kundrinë ose negacion i Lindjes. Prandaj elitat politike dhe intelektuale i ngarkuan vetës detyrën dhe misionin e orientimit të shqiptarëve kah Europa dhe Perëndimi (Sulstarova, 2012).

Shfaqja e konceptit të auto-orientalizmit në kontekstin kombëtar është më dominues sesa konteksti rajonal. Sepse ndoshta ideja më e përhapur e paradigmës moderne ka qenë ideja e zgjimit kombëtar. Në këtë kontekst, në shtetet e krijuara gjatë

kolonializmit dhe post-kolonializmit (nga elitat e zonës së kontaktit) ose në shtetet e krijuara nga një kuadër themelues (elitë bartëse), të gjithë ata që veprojnë jashtë projektit kombëtar dhe kundërshtojnë vetëdijen homogjene përsa i përket gjuhës/fesë/racës/kulturës janë bërë objekte të logjikës auto-orientaliste (Çiftçi, 2012, f. 145). Shikuar nga ky këndvështrim, auto-orientalizmi shqiptar është ngushtë i lidhur me projektin ndërtimit të kombit shqiptar dhe me procesin e europeizimit. Sepse ai stigmatizon, orientizon dhe përjashton të gjithë ato grupe apo kolektivitete ideologjike të cilët rezistojnë ndaj botëkuptimeve, ideologjisë dhe vlerave të prodhuara dhe përbrendësuar nga elitat bartëse.

Në thelb të auto-orientalizmit shqiptar qëndron vetë-perceptimi i të mosqenurit europian apo i të qenurit lindor. Ky gjykim për veten përbën arsyen primare për prodhimin e (auto)orientalizmit shqiptar. Meqenëse elitat politike dhe kulturore shqiptare, njësoj sikur me rastin elitave të tjera në Ballkan, ishin perceptuar si pjesë e botës lindore dhe ballkanike, pra si pjesë e shoqërive jo-perëndimore, edhe ato kërkuan që bashkësia e tyre t'u ngjaje shoqeve perëndimore, të cilat konsideroheshin si burimi referent i modernizimit dhe progresit gjatë procesit të modernizimit në shekullin XVIII dhe XIX (Hetemi, 2016, f. 144). Edhe pse shqiptarët gjeografikisht gjendeshin në Europë, ata nuk ndjeheshin se janë pjesë e saj dhe kjo dukej në mënyrën se si ato flisnin për Europën, si një hapësirë pak e njohur për ta. Faik Konica, më 1922 shkruante se megjithëse shqiptarët gjithë kohën flasin për Europën, ata besojnë që ajo është një vend i çuditshëm larg Shqipërisë (Sulstarova, 2012, f. 145). (Auto)orientalizmi shqiptar në esencë paraqet një përpjekje siç e quan studiuesi Enis Sulstarova për “arratisje nga Lindja”. Një përpjekje për të hequr njollën e të qenurit lindor, njollë kjo që u ishte imponuar shqiptarëve me dhunë

nga sundimi osman pesë shekullorë. Ndërkaq e vetmja mënyrë për tu arratisur nga Lindja ishte identifikimi me Europën dhe orientalizimin e Lindjes, e në rastin e orientalizmit shqiptar Lindja shpesh herë identifikohet me perandorinë Osmane dhe turqit.

Riprodhimi i orientalizmave brenda “botës shqiptare”

Milica Bakic-Hayden ve Robert Hayden janë të mendimit që Ballkani mundë të perceptohet si variacion i temës orientaliste në bazë të së cilës ky rajon dallohet si pjesë e Evropës, por që për një periudhë të gjatë ka qenë nën pushtimin osman. Duke qenë kështu dhe nga ana tjetër si pasojë e politikave për tu identifikuar sa më shumë me Europën popujt Ballkanik hynë në një proces të orientalizmit të fqinjëve të tyre ose pakicave etnike dhe kulturore brenda shteteve të tyre. Milica Bakic Hayden këtë fenomen e shpjegon përmes “riprodhimit të orientalizmave” (ang. “nesting orientalisms”). Përmes këtij nocioni, Bakic-Heyden tenton të përcaktojë probabilitetin e secilit komb që kulturat dhe kombet më në Lindje t’i stigmatizojë si më lindorë, rrjedhimisht me konservatore dhe primitive. Sipas skemës së këtij koncepti, Azia është me “Lindje” dhe më “tjetër” se sa Evropa Lindore, ndërkaq për Eruopën Lindore Ballkani është më “lindor” se sa ajo vetë. Ky fenomen i prodhimit të orientalizmit të brendshëm shihet qartë në ish-Jugosllavi dhe shtetet pasardhëse të saj. Popujt që janë orientalizuar nga të tjerët orientalizojnë ata që janë të ndryshëm prej tyre me qëllim të kamuflimit të imazhit i të qenurit “lindor”. Serbi është lindor për sllovenin dhe kroatit, porse boshnjaku dhe shqiptari për shkak edhe të përkatësisë fetare myslimane do të ishte “lindor” për serbin ortodoks. Greqia, për shkak të statusit të saj unikal në Bashkimin Europian, nuk konsiderohet si “lindore” nga fqinjët e

saj të Ballkanit, ndonëse ka një rol prej “lindori” në kuadrin institucional europian. Për të gjithë popujt ballkanik, “lindori” i përbashkët është turku (Todorova, 2013, f. 92; Hayden, 1995; Hetemi, 2016).

Duke ndjekur këtë hierarki të orientalizmave ballkanik do të mundohemi që të hedhim dritë mbi riprodhimin e orientalizmave brenda botës shqiptare. Thënë ndryshe ne do të mundohemi të argumentojmë që shqiptarët e Maqedonisë së Veriut në perceptcionin e atyre të Kosovës janë më Lindorë se ata, ndërkaq Kosova dhe Maqedonia përbëjnë orientin e Shqipërisë. Parë në këtë kuptim (Auto)orientalizmi shqiptar mundë të definohet si një ligjërim që stigmatizon si lindor një pjesë të kombit shqiptar për arsye të dallimeve kulturore dhe botëkuptimore.

Perceptimi i shqiptarëve jashtë kufijve të Shqipërisë londineze si “më pak europian” ka ekzistuar që nga fillimi, pra menjëherë pas shpalljes së pavarësisë. Por riprodhimi i orientalizmave brenda botës shqiptare kryesisht është një fenomen pas viteve 90-ta të shekullit të kaluar. Në periudhën e pas rënies së komunizmit ashtu si në të gjithë Europën Lindore edhe ndër shqiptarët lindi nevoja e identifikimit të fuqishëm me Europën dhe Perëndimin. Kjo nevojë dhe nga ana tjetër kjo mungesë legjitimiteti i të qenurit europian ishte aq e madhe sa që një pjesë e shqiptarëve orientalizuan pjesën tjetër me qëllim për të dëshmuar identitetin europian të tyre. Kështu në një periudhë të dominuar nga moderniteti perëndimor, në një periudhë të dëshirës së flaktë për tu integruar në strukturat më të avancuara euro-atlantike siç është NATO dhe BE çdo komb është i prirur të krijoj Orientin e vet. Orientalizimi i një pjese të kombit nga pjesa tjetër vërtitet rreth idesë se nuk jemi të gjithë njësoj, se “ne” që s’jemi si “ata”, distancohemi nga ata. Kështu, për nevoja të dominimit të perëndimorizimit, një komb pra krijon Orientin të një tjetër ose edhe brenda vetes, e në proces e sipër, mund të

krijojë edhe kombe të tjera nga vetja: në rastin shqiptar, kosovarët dhe “shqiptaromaqedonasit” e ndonjë plus, në ngjizje e sipër (Hatibi, 2012).

Sulstarova argumenton që në disa artikuj të shtypit shqiptar të periudhës post-komuniste ndarja Perëndim-Lindje përkon me atë midis Republikës së Shqipërisë dhe shqiptarëve që jetojnë jashtë saj, kryesisht në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, të cilët portretizohen si primitiv, fanatik dhe “lindorë”. Kështu Max Velo në një ese të tijen në vitin 2006 të titulluar, *(Lexoni e (mos) besoni!: Qosizmi, ose teoria e urrejtjes* duke kritikuar qëndrimet e Rexhep Qoses në debatin e tij me Kadarenë dhe kritikant ndaj Kadaresë, thotë që Rexhep Qosja është një dijetar tipik islamik dhe lindor. Ndërkaq sa i përket raporteve të Shqipërisë me Kosovën, Velo shprehet që shqiptarët e Shqipërisë duhet të kenë kujdes me Kosovën dhe kosovarët, pasi që siç thotë ai, kosovarët janë:

Akoma primitivë dhe do të na hapin probleme pa fund; le të rrinë të rregullohen vetë njëherë. Mbas pavarësisë, nuk do të dinë ç'të bëjnë me të. Ka mundësi të bëjnë nja dhjetë “REVOLUCIONE DEMOKRATIKE TË VONUARA” ala Qose, si ai i joni i 97-ës. Janë qaramanë dhe duan gjithmonë që të projektojnë fajet që i bëjnë tek të tjerët. Mos faktorët e ardhshëm janë shqiptarët? Mjerë ata popuj që kanë të tillë “udhërrëfyes” si Qosja, tipikë për vendet islamike dhe të botës së tretë (Velo, 2007).

Në po të njëjtin shkrim Velo, trajton edhe një ese të studiuesit shqiptar nga Maqedonia, Zeqirija Ibrahim, të titulluar “Goran Bregoviçi dhe Ibrahim Tatlisizi” në të cilën ky i fundit shkruan se “...Shqiptarët e ish-Jugosllavisë ngadalë po e ndërrojnë epigendrën e tyre etnike dhe kulturore drejt Prishtinës...” (Ibrahimi, 2006) Si reagim ndaj këtij shkrimi, ku ndër të tjerash Ibrahim kritikon edhe Kadarenë, Velo shprehet

se kritika ndaj Kadaresë është e motivuar nga qarqet fundamentaliste myslimane në Prishtinë dhe në Shkup, që kohët e fundit kanë marrë barrën që të na tërheqin zvarrë drejt lindjes:

Nëse ata quajnë epigendër etnike dhe kulturore etnitetin arab dhe kulturën islamike, sigurisht Tirana nuk u a siguron dot më këtë qendër. Tirana është kryeqytet evropian dhe i tillë do të mbetet. Tetova është bërë një nga qendrat kryesore islamike në Ballkan. Ibrahim thotë se osmanët kanë qenë superfuqi. Po kanë qenë superfuqi e masakrave, e thirrjeve dhe e prerjes së kokave; e jeniçerëve dhe e hallvës. Superfuqi është një atribut që nënkupton vlera jo vetëm ushtarake (Velo, 2007).

Publicisti nga Shqipëria Mustafa Nano, në një intervistë e dhënë në vitin 2015 lidhur me një pyetje rreth faktit që për shqiptarët e Maqedonisë më me rëndësi është identiteti fetar se sa ai kombëtar, thotë që ndër shqiptarët e Maqedonisë identiteti fetar luan rolin e një karoceje mbrojtëse.

Shqiptarët e Maqedonisë kanë pasur e kanë ndjesinë e vetëdijën e të qenët të margjinalizuar. Në fakt, kanë qenë e janë të margjinalizuar. Të margjinalizuar në botën shqiptare, e të margjinalizuar në shtetin maqedonas. Janë të harruar prej shqiptarëve e të shtypur prej maqedonasve. Fanatizmi i tyre fetar është një koracë mbrojtëse. Isha para disa javësh në Shkup. Dhe atje pashë qendrën e Shkupit, ku ishin ngritur monumente kolosale të Aleksandrit të Madh e të Filipit, të atit të Aleksandrit (vetëm një mendje e sëmure mund të ngrinte monumente të tilla të çmendura, do thosha). E në anën tjetër, ishte lagja shqiptare e zhytur në një mjerim biblik. Çfarë mund të presësh në këto rrethana. Në këto rrethana edhe unë do isha bërë fanatik e ekstremist. Në mos ekstremist fetar, me siguri ndonjë ekstremist i ndonjë lloji tjetër (Nano, 2015).

Ashtu siç mundë të vërehet në këto reshta, sa do që Nano thotë se identiteti fetar për shqiptarët e Maqedonisë luan rolin e mbrojtësit të identitetit kombëtar për shkak të antagonizmit me maqedonasit dhe në një farë mënyrë e përligj këtë situatë, nuk mundë të shpërfilllet fakti që ai flet nga pozicioni i një të “huaji” që e mëshiron këtë pjesë të kombit për shkak të fanatizmit dhe dogmatizmit të tyre fetar. Sipas tij pjesa në të cilën jetojnë shqiptarët në Shkup është një “mjerim biblik”, kështu duke aluduar në frymën dhe monumentet fetare që mbisundojnë në Shkup (Nano, 2015).

Shkupi, Tetova, Maqedonia, pra shqiptarët e Maqedonisë janë thelbi i Orientit ndërshqiptar – pasojë e pandehmave më të forta këtu të “arabizmit” përmes praktikimit “revolucionar” të fesë ose të “turqizmit” diakronik, sa të ngulitur prej zakoneve osmane, aq edhe të prejardhur prej kolonizimit – këtej edhe qasja raciaizuese, tjetërsuese, ndaj shqiptarëve të Maqedonisë. Pikërisht për këtë shkak, Maqedonia shqiptare më tepër mbetet një vend i pavizituar, i padëshirueshëm për t’u njohur, i montuar në fraza të gatshme, të përgjithshme të përforcimit të dallimit “me ne të tjerët” që jemi emancipuar nga zakonet e vjetra ose që nuk ndajmë me ta ose të njëjtën fe ose, aq më pak, të njëjtin entuziazëm për të. Kështu përshkruhej qyteti i Tetovës në një reportazh të gazetës “Shekulli” nga Shqipëria:

Në qendrën e Tetovës vërehet një shesh i madh, jo shumë i pastër. Disa kafene jo shumë të bukura dhe luksoze, të thjeshta. Syri të zë mjaft dyqane me mall oriental, kryesisht turk. (...) Ky është një qytet ku dominon së tepërmi feja myslimane. Në rrugët e qytetit gjenden shumë gra të mbuluara me shami, të cilat i ndjekin ritet e feve në maksimum, si falja e namazit, agjërimi apo dhe detyrime të tjera të fesë së tyre, që e adhurojnë dhe mbrojnë me fanatizëm (Hatibi, 2012).

Me rastin e botimit të enciklopedisë problematike maqedonase, ku shqiptarët portretizoheshin si popull malësor dhe ardhacak në Maqedoni, studiuesi dhe publicisti Ardian Ndreca do të theksonte asimilimin kulturor të shqiptarëve si rrjedhim i “arabizimit” të tyre:

Njerzve të thjeshtë me të drejtë u ngjallin revoltë dhe indignatë tezat e Akademisë maqedonase, po pse nuk u ngjallë po aq revoltë dhe indignatë arabistanizimi i ethshëm i këtyne 20 viteve të fundit i një pjese shumë të madhe të shqiptarëve të Maqedonisë? (...) Por ajo që duhet të shqetësonte politikanët e intelektualët e Maqedonisë dhe të Shqipnisë asht fakti se shqiptarët e Maqedonisë po bjerrin përditë e ma tepër gjuhën e tyne amtare, veshjet tradicionale, emnat, zakonet e lashta, vetë specifikën e islamit shqiptar e si rrjedhojë këtyne humbjeve po zbehët gjithnjë e ma tepër vetë ndërgjegjja kombëtare. Në qoftë se punët kanë me ec me këtë ritëm, çka kanë me shkruë mbas 50 vjetësh akademikët maqedonas? Si do t’i trajtojnë shqiptarët e Maqedonisë: si pakica turke apo si refugjatë palestinez (Hatibi, 2012).

Publicisti Kastriot Myftaraj në një ese të tijën argumenton që shqiptarët e Maqedonisë dhe përgjithësisht të Jugosllavisë deri në vitet e 70-ta të shekullit XX ishin të prirur që Perëndimin ta identifikojnë me Serbinë dhe Jugosllavin dhe rrjedhimisht ta konceptojnë si armikun e tyre. Ndërkaq islami, i cili ishte toleruar dhe stimuluar me kast nga Jugosllavia para dhe pas Luftës së Dytë Botërore, shihej prej shqiptarëve të Jugosllavisë si një nyje socializuese më e sigurt se institucionet e Jugosllavisë komuniste. Kjo ishte edhe arsyeja që shqiptarët e Jugosllavisë të kishin prirjen për ta parë Perëndimin edhe si armikun fetar, meqenëse ai ishte i krishterë, ashtu si edhe sllavët. Ndërkaq pas viteve 70-ta atëherë kur shqiptarët e Maqedonisë filluan të shkojnë masivisht në Perëndim, për të punuar, panë

se Perëndimi nuk ishte ajo mbretëri e së keqes që ata e patën imagjinuar. Por edhe përkundër kësaj, pra edhe përkundër të mirave që u ofronte Perëndimit shqiptarëve të Maqedonisë, ata nuk e panë të arsyeshme të lënë fenë islame, madje ata akoma më fuqishëm u lidhën më atë. Për më tepër, Myftaraj thotë se:

Por kur shqiptarët e Maqedonisë panë se Perëndimi, megjithëse ata e urrenin, u tregua bujar me ta, duke i pranuar që të punonin atje dhe të fitonin mirë, ata e perceptuan këtë si naivitet të Perëndimit, dhe u bënë arrogant ndaj Perëndimit (Myftaraj, 2010).

Nënteksti i këtyre vargjeve të Myftaraj është i qartë: ai shqiptarët e Maqedonisë i portretizon edhe si mosmirënjohës, duke ia kthyer shpinën atij dhe duke u lidhur akoma më fuqishëm me islamit dhe botën arabe. Është shumë e qartë islami përbën antipodin e Perëndimit.

Blerim Latifi, një intelektual dhe pedagog nga Kosova, shpesh herë ka shtruar tezën e “arabizimit” të shqiptarëve të Maqedonisë. Latifi duke marrë për bazë fetarizmin e shqiptarëve të Maqedonisë, është i mendimit që kjo pjesë e kombit rrezikon ta humb identitetin kombëtar, në kurriz të atij fetar. Kështu në fitin 2020 ai shkruante se:

Shqiptarëve në Maqedoni po iu ndodh ajo që më herët u ka ndodhur shqiptarëve myslimanë në Mal të Zi dhe Novi Pazar: po e humbin identitetin kombëtar, për shkak se fenë e kanë vendosur mbi kombin” (Blerim Latifi: Shqiptarët e Maqedonisë, 2020).

Një tjetër publicist nga Kosova, Ibrahim Kelmendi, në vitin 2010 në një shkrim të tij të titulluar, “Fanatizmi fetar mysliman dhe pasojat e tij për lirinë e besimit dhe të komprometimit të shqiptarëve “theksonte se shqiptarët e Maqedonisë janë bartësit kryesorë të fanatizmit fetar ndër shqiptarët.

Sipas tij ishte pikërisht fanatizmi fetar i myslimanëve të Maqedonisë i cili mund t'i komprometoj shqiptarët përballë faktorit ndërkombëtar, pikërisht në kohërat kur shqiptarëve më së shumti u duhej Perëndimi. Kelmendi duke drejtuar gishtin tek islami, argumenton që kombi shqiptar, historikisht ka pësuar nga keqpërdorimi i fesë islame për qëllime pushtuese, sunduese dhe asimiluese:

Gati pesë shekuj osmanlinjtë dhe turqit na kanë shtypur, shfrytëzuar e tjetërsuar në përmasa të tmerrshme, duke e keqpërdorur edhe fenë islame si mjet. Dhe ky tjetërsim ishte i atyre përmasave, sa ata shqiptarë, që përballuan tjetërsimin (asimilimin), në shekullin e 19-të nuk njihnin as Flamurin e tyre kombëtar (Kelmendi, 2010).

Ashtu siç mundë të vërehet pothuajse i gjithë diskursi auto-orientalist shqiptar vërtitet rreth religjionit dhe përkatësisë fetare të shqiptarëve të Kosovës dhe Maqedonisë. Nëse shqiptarët e Kosovës përfaqësojnë diçka të “ndrmjetme” ose “udhëkryqin”, shqiptarët e Maqedonisë përfytyrohen si fetar fanatik dhe kësajsoj përfaqësojnë skajin e botës shqiptare dhe lindorin absolut. Pra karakteristika kryesore e auto-orientalizmit shqiptar është fakti i të qenurit i kufizuar kryesisht me një diskurs që thekson dallimet fetare ose botëkuptimet mbi religjionin. Është identiteti fetar mysliman dhe shkalla e praktikimit të tij ai që përcakton lindorinë e tyre. Përfytyrimi i Europës si anti-tezë e Islamit dhe identifikimi i saj me krishterimin ndanë kombi shqiptarë në dysh: një pjesë që është europiane dhe pjesë tjetër që bie ndesh me Europën. Kur kihet parasysh se shumica e shqiptarëve janë mysliman kjo nënkupton që kjo pjesë kombit “është joeuropiane” dhe rrjedhimisht paraqet “orientin” shqiptar. E vetmja rrugë për rievropeizimin e shqiptarëve do të ishte rikatolicizimi i tyre, ose rikthimi i tyre në rrënjët e të parëve (Maliqi, 2023, f. 231).

Raporti i Shqipërisë me Kosovën

dhe Maqedoninë ndërtohet si një raport midis qendrës dhe periferisë. Edward Shils, i cili i pari përdori konceptet e qendrës dhe periferisë në analizën sociale, argumenton se çdo shoqëri ka një zonë qendrore dhe se kësaj zone i ngarkohet një shenjtëri të caktuar. Fuqia e qendrës konsiston në vlerat dhe besimet e saja të cilët përfytyrohen si të pranueshme edhe për periferinë. Qendra përfytyrohet si epiqendra e simboleve, vlerave dhe besimeve që orientojnë shoqërinë. Në konceptimin e Shils-it qendra i referohet edhe një fushë veprimi. Kjo fushë veprimi është një fushë e përbërë nga individë, role dhe aktivitete të institucioneve të ndryshme si sistemi i statusit, sistemi farefisnor, organizimi politik etj. Me fjalë të tjera, është fusha ku mishërohen vlerat, besimet dhe rolet. Vlerat e përfshira në sistemin qendror të vlerave kanë njëfarë “shenjtërie” sepse përmbajnë shembuj të veçantë të kulturës dhe kjo zonë është në pronësi të pushtetarëve të shoqërisë. Kjo shenjtëri përbën burimin e autoritetit të qendrës, si në nivel vlerash ashtu edhe në nivel institucional, dhe krijon dëshirën për t’u vlerësuar që buron nga ky autoritet. Megjithatë, kjo tërësi nuk nënkupton që të gjithë anëtarët e asaj shoqërie i përvetësojnë ato vlera qendrore (Shils, 1975, fv. 87-88).

Auto-orientalizmi shqiptar paraqet një diskurs i cili orientazon një pjesë të kombit e që kjo është pjesa periferike apo skajore e kombit. Kjo pjesë e kombit llogaritet si i vonuar në përbrendësimin e vlerave, botëkuptimeve, besimeve të cilat burojnë nga qendra. Kjo vonesë ka të bëjë me vlerat dhe botëkuptimet që e identifikojnë Europën dhe qytetërimin perëndimor. Çdo vlerë a botëkuptim që është në shpërputhje me habitusin evropian stigmatizohet si primitiv dhe lindor. Në këtë kontekst Shqipëria imagjinohet si qendra përkarshi periferive kulturore dhe intelektuale Kosovës dhe Maqedonisë. Qendra është ajo që prodhon kulturën e lartë dhe përcakton

vlerat, botëkuptimet dhe rrjedhimisht trason rrugën se ku duhet të shkojë kombi shqiptar në të ardhmen. Shkrimtari dhe publicisti Ben Blushi në një intervistë të vitit 2014 shprehet se Shqipëria për gati se një shekull, megjithatë ka qenë qendra rreth së cilës janë vërtitur shqiptarët jashtë saj:

Është e vërtetë se Shqipëria ka dominuar mendimin kulturor të shqiptarëve për të paktën 100 vjetët e fundit, prej që është bërë shtet. Duke qenë shteti amë, duke qenë shtet i pavarur, pavarësisht se ishim shtet komunist, ne kishim institucione, bënim kulturë, nuk na pengonte kush të flisnim shqip... Sigurisht kjo ka ndikuar tek të gjithë shqiptarët, veçanërisht tek shqiptarët e Kosovës. Pra, ne kemi qenë dhe jemi qendra rreth së cilës sillen gjithë diaspora shqiptare, përfshirë dhe Kosovën (Intervistë me Blushin, 2014).

Të gjithë ato të cilët kundërshtojnë apo përvetësojnë vlera, botëkuptime dhe besime të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe normalizuara nga qendra përfytyrohen si lindor, të huaj e të ndryshëm nga shqiptari i vërtetë. Së këndejmi një nga karakteristikat e auto-orientalizmit shqiptar është se “lindorit” shqiptar i vendoset në dyshim edhe identiteti kombëtar. Pra auto-orientalizmi shqiptar është i prirur të mohojnë shqiptarinë atyre që sfidojnë hegjemonin kulturore dhe vlerore të qendrës. E në këtë rast shqiptari i vërtetë në mos i krishterë, është indiferent ndaj religjionit dhe gjithçkaje që ka të bëjë me Lindjen. Religjioni është njolla e pashlyeshme e Lindjes.

Në shoqëritë jo-perëndimore auto-orientalizmi shpërfaqet atëherë kur procesi i modernizimit ose evropëizimit është i pasuksesshëm ose gjysmak. Atëherë kur një pjesë e shoqërisë, veçmas elitat politike dhe intelektuale kanë ose mendohet se kanë mishëruar në plotni vlerat evropiane dhe një pjesë tjetër e shoqërisë ose në rastin e studimit tonë një pjesë e kombit ose është indiferente ose armiqësore ndaj këtyre

vlerave. Thënë ndryshe auto-orientalizmi paraqitet atëherë kur ekzistojnë pikëpamje dhe praktika të cilat dallojnë nga ato të përcaktuara nga qendra, bartës e të cilave janë elitat. Porë nga ky këndvështrim auto-orientalizmi shqiptar përfytyron krijimin e një qerthulli ideologjik e botëkuptimor rreth së cilit do të përbashkohet i gjithë kombi. Ndërkaq parë nga pikëpamja e marrëdhënies qendër-periferi, auto-orientalizmi shqiptar është pasqyrim i konfliktit ndërmjet qendrës dhe periferisë. Kjo nënkupton që qendra nuk arin dot që vlerat e saja ti shtrij në periferi dhe t'i imponoj si të gjithpranueshme.

Megjithatë auto-orientalizmi shqiptar nuk është diskurs që ndanë kombin në dy pjesë të papajtueshme dhe absolutisht të ndryshme. Për dallim nga Perëndimi dhe Lindja që imagjinojnë si dy botë ontologjikisht dhe epistemologjikisht të ndryshme, pra antibiotë, në rastin shqiptar këto dallime përkarshi disa vlerave, botëkuptimeve a besimeve duken të tejkalueshme. Siç argumenton Sulstarova, nëse orientalizmi i jashtëm vendos një barrierë të pakalueshme ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes, orientalizmi i brendshëm (auto-orientalizmi), mundë të pranojë një shkallë të asimilimit dhe integritit të “lindorëve” në trupin e kombit. Thënë më fjalë tjera, mundë të lejoj apo të kërkoj “deorientalizimin” e plotë apo të pjesshëm të kombit (Sulstarova, Arratisje nga Lindja, 2019, f. 19).

Përfundim

Orientalizmi dhe ballkanizmi shënjojnë “tjetrin” e Europës, ndonëse orientalizmi “tjetrin” absolut të saj, kurse ballkanizmi “tjetrin” e brendshëm, ose “veten” e paplotë të saj. Edhe pse Todorova insiston që ballkanizmi është i motivuar nga nacionalizmi agresiv i popujve Ballkanik, duhet thënë që në përfytyrimin e Ballkanit si i ndryshëm nga Europa, përkatësi fetare dhe antagonizmat përgjatë historisë ndërmjet të krishterëve

europianë dhe myslimanëve luan një rol të rëndësishëm. Për më tepër Ortodoksizmi dhe Islami, si religjione të shumicës së popujve në Ballkan padysim kanë luajtur një rol thelbësor në perceptimin e Ballkanit si “tjetri” i Europës.

Ashtu si orientalizmi ashtu edhe auto-orientalizmi shqiptar paraqet një përpjekje për “deorientalizim” të vetes dhe së kaluarës së popullit shqiptar. Është një përpjekje që duke portretizuar një pjesë të kombit, kryesisht me përkatësi fetare myslimane si “lindor” të dëshmoj identitetin kulturor europian të pjesës tjetër të kombit që veten e përfytyron si qendër. Sa do që auto-orientalizmi shqiptar pjesërisht mundë të përkoh me realitetin objektiv, në thelb paraqet një diskurs reduktues, përjashtues dhe i stërngarkuar me stereotipa ose paragjykime për një pjesë të caktuar të kombit. Për më tepër në këtë diskurs është mishëruar edhe racizmi kulturor dhe islamofobia. Islamofobia paraqet një motiv i rëndësishëm për artikullimin e auto-orientalizmit shqiptar.

Nga ana tjetër, brenda kombit shqiptar, që prej viteve 90-ta të shekullit të kaluar u shpërfaqën fenomene të cilët duket se “përligjin” auto-orientalizmin shqiptar. Pas rënies së komunizmit në botën shqiptare u paraqitën ideologji dhe botëkuptime, kryesisht fetare të cilët duket se janë shumë të ndryshme nga ajo se si e kanë përjetuar dhe kuptuar religjionin shqiptarët të paktën këto njëqind vjetët e fundit. Këto ideologji kryesisht u importuan nga jashtë, kryesisht nga vendet arabe. Porë nga ky këndvështrim auto-orientalizmi shqiptar paraqet një reaksion ndaj këtyre ideologjive të cilat, rrezikojnë orientimin vleror europian dhe identitetin kombëtar shqiptar. Pra, në këtë kontekst auto-orientalizmi shqiptar duhet parë si një diskurs që ka për synim ruajtjen e identitetit kombëtar dhe vlerave europiane, vlera këto të mishëruara tani më tek shqiptarët për më shumë se një shekull.

REFERENCAT

- (2020, 12 02). Retrieved 10 10, 2024, from <https://www.vushtrriaonline.net/2020/02/blerim-latifi-shqiptaret-e-maqedonise-po-e-humbin-identitetin-kombetar-fene-e-kane-vendosur-mbi-kombin/>
- Arlı, A. (2023). *Orientalizmi-Oksidentalizmi dhe Sherif Mardini*. (L. L. Xhanari, Përkth.) Shkup: Logos A.
- Çiftçi, B. B. (2012). Self Oryantalizm: İçimizdeki Modernite ve/veya İçselleştirdiğimiz Modernite. *Akademik İncelemeler Dergisi*, 7(1), 139-166.
- Dervišević, H. (2021). From Orientalism to Self-Orientalism. *Znakovi Vremena*(89/90), 139-155.
- Durham, E. (2009). *Brenga e Ballkanit*. (H. Thanasi, Përkth.) Tiranë: Argeta.
- Hatibi, E. (2012, 05). Shqiptarët tanë: (Vetë) arratisja kombëtare. *Shenja*(13).
- Hayden, M. B. (1995). Nesting Orientalisms: The Case of Former Yugoslavia. *Slavic Review*, 54(4), 917-931.
- Hetemi, A. (2016). Parë me sytë e të tjerëve: riprodhimi i orientalizmit dhe ballkanizimi i brendëshëm midis shqiptarëve dhe sllavëve të jugut në ish-Jugosllavi. Në A. P. Rigels Halili (Re.), *Figura e armikut* (fv. 139-159). Prishtinë: Printing Press.
- Ibrahimi, Z. (2006). Retrieved from <https://shqiperia.yahogroups.narkive.com/9sUNoonx/paralele-goran-bregovici-dhe-ibrahim-tatlisesi>
- Kelmendi, I. (2010, 01 02). Retrieved 10 08, 2024, from Zemra Shqiptare: <https://www.zemrashqiptare.net/news/12201/ibrahim-kelmendi-fanatizmi-fetar-mysliman-dhe-pasojat-e-tij-par-lirina-e-besimit-dhe-ta-komprometimit-ta-shqiptarave.html>
- Keyman, F. (2002). "Globoleşme, Oryantalizm ve Öteki Sorunu: 11-Eylül Sonrası Dünya ve Adalet. *Doğu Batı Dergisi*, 4(20).
- Maliqi, S. (2023). *Mbi fajin kolektiv serb*. Prishtinë: Koliqi.
- Mazower, M. (2017). *Balkanlar*. (A. Ozil, Përkth.) İstanbul: Alfa.
- Metin, A. (2022). *Oksidentalizmi*. (A. Pajaziti, Përkth.) Shkup: Logos A.
- Mutman, a. (1996). Oryantalizmin Gölgesi Altında: Batı'ya Karşı İslam. Në M. M. Fuat Keyman (Re.), *Oryantalizm, Hegemonya ve Kültürel Fark* (fv. 25-71). İstanbul: İletişim Yayınları.
- Myftaraj, K. (2010, 07 20). *Zemra shqiptare*. Retrieved 10 14, 2024, from Zemra shqiptare: <https://www.zemrashqiptare.net/news/16084/kastriot-myftaraj-shqiptaret-e-maqedonise-ne-epoken-para-dhe-pas-lindjes-salajdinit.html>
- Nano, M. (2015, 04 19). Mustafa Nano: Maqedonia më e brishtë ndaj fanatizmit fetar. (A. Bardhyli, Intervistuesi) Gjetur 10 11, 2024, nga <https://fjala.info/2009-2015/mustafa-nano-maqedonia-me-e-brishte-ndaj-fanatizmit-fetar/>
- Said, E. (2009). *Orientalizmi: Koncepte perëndimore për Orientin*. (X. Lloshi, Përkth.) Shkup: Logos A.
- Shils, E. (1975). *Center and Periphery Essays in Macrosociology*. Chicago and London: University of Chicago Press.
- Shqiptarja*. (2014, 04 15). Retrieved 14 2024, 10, from Shqiptarja: <https://shqiptarja.com/lajm/interviste-me-blushin-shqiptaret-br-ne-rrezik-serioz-nga-islami-politik>
- Sulstarova, E. (2012). *Jam Evropë!* Shkup: Logos A.
- Sulstarova, E. (2019). *Arratisje nga Lindja*. Tiranë: Pika pa Sipërfaqe.
- Todorova, M. (2013). *Ballkani Imagjinar*. (B. Shehu, Përkth.) Tiranë: IDK.
- Turner, B. (2002). *Oryantalizm, Postmodernizëm ve Globalizëm*. (İ. Kapaklıkaya, Përkth.) İstanbul: Anka.
- Velo, M. (2007, 12 20). *Shqipëria Etnike*. Retrieved from Shqipëria Etnike: <https://revista-shqiperiaetnike.blogspot.com/2007/12/lexoni-e-mos-besoni-qoseizmi-ose-teoria.html>

ABSTRACT

The division of the world into East and West has been a reality since ancient times. However, with the emergence of Orientalism as a scientific discipline and political discourse, this distinction has become even sharper and has inevitably produced political consequences. This is because Orientalism institutionalized and normalized the division of the world into East and West. Therefore, the myth of superiority of the West over the East resulted in the stigmatization of the latter as primitive, barbaric, fanatical, etc. Meanwhile, Balkanism, either as a variation of Orientalism or as independent from it, is a notion that imposes pejorative meaning in the Balkans and the Balkan people. In this context, the Balkans from the West????? is imagined as a world opposite to that of the West?????. Consequently, the Balkan people at the beginning of the process of modernization and internalization of Western values began the process of de-Orientalization and de-Balkanization. From this point of view, the first attempts of Albanians to “escape from the East” began at the end of the 19th century and the beginning of the 20th century, when the process of Albanian modernization and national formation began. Thus, the end of the 19th century and the beginning of the 20th century is also the birth date of Albanian Orientalism. The revivalists influenced by the orientalist discourse emphasized the European origin and identity of Albanians in order to orient the value of the Albanian nation towards Europe. As a result, this study analyses Albanian self-orientalism as an attempt to “otherize” or “stigmatize” a part of the Albanian nation as eastern by another part which imagines itself as “European” and the bearer of the Europeanization process of Albanians. In this context, Albanians of Albania consider themselves more “European” than Albanians of Kosovo, while Albanians of Macedonia are “easterners” both in the eyes of Albanians of Albania and Albanians of Kosovo.

Keywords: *orientalism, Balkanism, self-orientalism, religion, Albanian self-orientalism*

VACCINATION PATTERNS: CAN FLU TESTING NUDGE COVID-19 VACCINE BEHAVIOR?

Max CHARNEY

Byram Hills High School, USA

E-mail: maxcharney07@gmail.com

ABSTRACT

This paper investigates whether being tested for the flu can act as a “nudge” for individuals to also obtain the COVID-19 vaccine, applying nudge theory within the context of healthcare. Nudge theory, proposed by Thaler and Sunstein, suggests that small changes in decision environments can influence behavior while preserving freedom of choice. The research investigates the link between flu testing, a common seasonal health behavior, and COVID-19 vaccine uptake, assessing whether flu testing could serve as a “nudge” to remind individuals to obtain vaccination against COVID-19. Using datasets from the World Health Organization FluNet and COVID-19 vaccine administration records, the study analyzed weekly flu specimen testing and COVID-19 vaccinations from 2021 to 2023. The Pearson correlation coefficient between flu specimens tested and COVID-19 vaccinations was calculated, revealing a strong positive correlation ($r=0.7105$). This suggests that flu testing behavior may indeed serve as a nudge, encouraging the uptake of COVID-19 vaccines. Visualizations, including a line graph, highlight this correlation, with synchronized peaks in flu testing and COVID-19 vaccine administration. This finding contributes to understanding how seasonal health behaviors can influence responses to new health interventions and offer insights for public health strategies aimed at improving vaccine uptake. Future research should investigate causal factors and the role of socioeconomic and healthcare access variables in shaping vaccination behaviors.

Keywords: *Nudge theory, flu testing, COVID-19 vaccine, public health, sociology, vaccination behavior*

Max CHARNEY is an award-winning student researcher interested in using computational methods to analyze real-world phenomena and is advised by faculty at Memorial Sloan Kettering.

Nudge theory, developed by Richard Thaler and Cass Sunstein, emphasizes the power of small, strategic changes in decision environments to influence behavior without removing freedom of choice (Thaler and Sunstein, 2009). Rooted in behavioral economics, this theory suggests that people often make decisions based on mental shortcuts, biases, and the way choices are framed. A well-placed “nudge” can guide individuals toward better outcomes, whether in personal finance, education, or health, without overt pressure or mandates.

In healthcare, the potential of nudge theory is particularly pronounced. Many health outcomes are influenced by individual behaviors, such as medication adherence, lifestyle choices, and participation in preventive care (Gast and Mathes, 2019; Hautekiet et al., 2022; Larsen et al., 2018). Traditional health interventions often rely on educating or incentivizing patients, but these approaches sometimes fall short (Klein, 2013). Nudges, on the other hand, can subtly reshape environments to promote healthier decisions—whether it’s by adjusting the default options for medical treatments, making healthy foods more visible in hospital cafeterias, or sending personalized reminders for vaccinations or screenings (Halpern et al., 2020; Thorndike et al., 2019; Stockwell., 2019). These gentle prompts are designed to work with human psychology, encouraging better choices while maintaining patient autonomy.

Despite the growing body of literature on nudge theory in healthcare, there remains a gap in understanding how the timing and nature of health behaviors, particularly in relation to seasonal and non-seasonal vaccines and viruses, can influence one another (Liu et al., 2024). Sociologically, the act of being tested for the flu is often shaped by cultural norms and annual routines, whereas obtaining non-seasonal vaccines, like the COVID-19 vaccine, involve different

social and psychological drivers. However, little research has explored whether a well-established seasonal behavior, such as flu testing, can act as a nudge for receiving a newer, non-seasonal vaccine. This raises questions about how the predictability and familiarity of one behavior could influence uptake of another, especially during a global health crisis.

This study aims to investigate whether flu testing, a familiar seasonal health behavior, serves as a nudge for people to also obtain the COVID-19 vaccine, a less routine action. By analyzing patterns of flu testing, this research will explore whether the flu testing—through its regularity and established presence—nudges individuals toward accepting the COVID-19 vaccine. Understanding this correlation could reveal important insights into how seasonal and non-seasonal health behaviors interact and what this might mean for public health strategies moving forward. Ultimately, this study contributes to both the application of nudge theory in healthcare and to the sociological understanding of how ingrained behaviors influence responses to new health interventions.

Methods

Data Collection and Preprocessing

This study utilized two primary datasets: COVID-19 vaccine administration data and flu testing data from the World Health Organization (WHO) FluNet system. The COVID-19 dataset contained information on daily vaccine doses administered, while the WHO dataset provided weekly flu specimen testing data.

To ensure consistency across the datasets, all date-related fields were first converted into a standardized format using the `pd.to_datetime()` function. COVID-19 vaccine data was processed to provide weekly totals by grouping daily records into weekly bins, with the first day of each week

representing the start date. The number of new vaccines administered each week was then calculated by taking the difference between consecutive weekly totals. The WHO data was aggregated by week, and missing values were filled via mean imputation for weeks without reported data.

Data Integration and Alignment

To facilitate comparison across datasets, a common weekly time frame that spanned the shared period of reporting between the two data sources was generated. This full date range was created using `pd.date_range()`, from the earliest available date across datasets to the latest. The COVID-19 vaccination data was then reindexed to align with this time frame. All data were merged into a single DataFrame, with columns representing WHO flu specimens tested and COVID-19 vaccines administered on a weekly basis. Outliers and gaps in the dataset were handled by filling weeks 37 and 38, which contained incomplete data, via mean imputation and recalculating continuous week numbers for analysis.

Statistical Analysis

To investigate potential correlations between flu testing behaviors and COVID-19 vaccination, Pearson correlation coefficients were calculated among two variables: the number of WHO flu specimens tested and COVID-19 vaccines administered per week from October 4th, 2021 to May 8th, 2023.

Visualization

To illustrate trends over time, the number of WHO flu specimens tested and COVID-19 vaccines administered per week were plotted using line graphs. The y-axis was plotted on a logarithmic scale to accommodate the differences in magnitude between flu cases and vaccine doses. Data were visualized using Matplotlib, with custom axis labels and a legend to distinguish between flu and COVID-19 trends.

Limitations

One limitation of the dataset is the need to use mean imputation for weeks 37 and 38 due to incomplete data. Additionally, since flu testing results are often underreported, particularly during overlapping flu and COVID-19 seasons, the flu-related data may not fully capture the true incidence of flu-like illness during the studied period. Nonetheless, this study provides a robust preliminary analysis of the interaction between flu testing behaviors and COVID-19 vaccination.

Results

The analysis focused on the correlation between the weekly administration of COVID-19 vaccines and the total number of flu tests reported by the World Health Organization (WHO). The correlation coefficient calculated between these two variables was found to be 0.7105, indicating a strong positive relationship. This suggests that as the number of COVID-19 vaccines administered increases, there is a corresponding increase in the number of WHO influenza specimens tested.

This result highlights the potential interaction between influenza testing and COVID-19 vaccination efforts. The strong correlation may imply that receiving the seasonal flu testing “nudges” or reminds individuals to obtain the non-seasonal COVID-19 vaccine, reflecting a broader trend in health-seeking behavior.

Figure 1 illustrates this relationship, depicting the trends in COVID-19 vaccine administration alongside the weekly counts of WHO influenza specimens. The similar trajectory of both variables over the observed period suggests that individuals who engage in flu testing may also be nudged, or inclined to obtain COVID-19 vaccination.




Figure 1. Weekly trends of WHO flu specimens tested and COVID-19 vaccines administered (October 4th, 2021–May 8th, 2023). The y-axis is plotted on a logarithmic scale to account for differences in magnitude between flu testing and vaccine administration. Flu specimens (orange) represent weekly totals of specimens tested for influenza by WHO, while COVID-19 vaccines (green) represent weekly totals of new vaccine doses administered. The graph highlights fluctuations in flu testing and vaccine uptake over time.

Discussion

This study explored the relationship between influenza testing and COVID-19 vaccination, specifically assessing whether the administration of flu testing could act as a nudge for individuals to seek out the COVID-19 vaccination. The findings reveal a strong positive correlation between the number of COVID-19 vaccines administered and the number of influenza specimens tested by the World Health Organization, with a correlation coefficient of 0.7105. This suggests that efforts to

increase flu testing and vaccination not only address the public health threat of the influenza but may also enhance engagement in COVID-19 vaccination.

The implications of these findings are noteworthy for public health strategies. As vaccination campaigns evolve, understanding how they influence related health behaviors can inform more effective messaging and outreach. By leveraging the increased awareness and participation associated with COVID-19 vaccination, public health officials can promote seasonal influenza vaccinations and testing, ultimately improving community health outcomes.

However, this study also acknowledges the presence of confounding variables that may influence the observed correlation. Factors such as seasonal variations in public health messaging, increased awareness of respiratory illnesses during flu season, and the societal emphasis on health maintenance during colder months can significantly impact individuals’ likelihood of obtaining the COVID-19 vaccine. Additionally, socioeconomic status and access to healthcare play critical roles in vaccination behavior, as individuals from different backgrounds

may have varying levels of access to both flu testing and vaccinations. Moreover, underlying health conditions and prior experiences with the healthcare system can affect a person's willingness to seek vaccinations during this period. Lastly, the overall declining trend observed in both flu testing and COVID-19 vaccination rates over time may lead to a higher correlation coefficient; while this increase in correlation

does not imply a causal relationship between flu testing and the uptick in COVID-19 vaccinations, future research can evaluate this causation further. In other words, future work should aim to control for these confounding factors to more accurately assess the relationship between flu testing and COVID-19 vaccination behavior, ensuring a clearer understanding of how these dynamics interact in a public health context.

REFERENCES

- Gast, A. and Mathes, T. (2019). Medication Adherence Influencing Factors—an (updated) Overview of Systematic Reviews. *Systematic Reviews*, 8(1). doi:<https://doi.org/10.1186/s13643-019-1014-8>.
- Halpern, S.D., Small, D.S., Troxel, A.B., Cooney, E., Bayes, B., Chowdhury, M., Tomko, H.E., Angus, D.C., Arnold, R.M., Loewenstein, G., Volpp, K.G., White, D.B. and Bryce, C.L. (2020). Effect of Default Options in Advance Directives on Hospital-Free Days and Care Choices Among Seriously Ill Patients. *JAMA Network Open*, 3(3), p.e201742. doi:<https://doi.org/10.1001/jamanetworkopen.2020.1742>.
- Hautekiet, P., Saenen, N.D., Martens, D.S., Debay, M., Van der Heyden, J., Nawrot, T.S. and De Clercq, E.M. (2022). A healthy lifestyle is positively associated with mental health and well-being and core markers in ageing. *BMC Medicine*, 20(1). doi:<https://doi.org/10.1186/s12916-022-02524-9>.
- Klein, E.P. (2013). Patient Health Incentives: Ethical Challenges and Frameworks. *International Journal of Behavioral Medicine*, 21(6), pp.995–1004. doi:<https://doi.org/10.1007/s12529-013-9373-3>.
- Larsen, L.B., Sonderlund, A.L., Sondergaard, J., Thomsen, J.L., Halling, A., Hvidt, N.C., Hvidt, E.A., Mønsted, T., Pedersen, L.B., Roos, E.M., Pedersen, P.V. and Thilging, T. (2018). Targeted prevention in primary care aimed at lifestyle-related diseases: a study protocol for a non-randomised pilot study. *BMC Family Practice*, 19(1). doi:<https://doi.org/10.1186/s12875-018-0820-8>.
- Liu, S., Durantini, M.R., Calabrese, C., Sanchez, F. and Albarracin, D. (2024). A systematic review and meta-analysis of strategies to promote vaccination uptake. *Nature Human Behaviour*, [online] pp.1–17. doi:<https://doi.org/10.1038/s41562-024-01940-6>.
- Stockwell, M. (2019). PRISM: Personalized Reminders for Immunization Using Short Messaging Systems Principal Investigator. [online] Available at: <https://digital.ahrq.gov/sites/default/files/docs/citation/r01hs022677-stockwell-final-report-2019.pdf> [Accessed 19 Oct. 2024].
- Thaler, R.H. and Sunstein, C.R. (2009). *Nudge: Improving Decisions about health, wealth, and Happiness*. New York: Penguin Books.
- Thorndike, A.N., Gelsomin, E.D., McCurley, J.L. and Levy, D.E. (2019). Calories Purchased by Hospital Employees After Implementation of a Cafeteria Traffic Light–Labeling and Choice Architecture Program. *JAMA Network Open*, [online] 2(7). doi:<https://doi.org/10.1001/jamanetworkopen.2019.6789>.

Social Studies Journal: Author's guide

Social Studies Journal (SSJ) is the official Journal of Albanian Institute of Sociology (AIS), and Department of Sociology, University Aleksander Moisiu Durres Albania (UAMD), based on the institutional agreement of AIS-UAMD, date 8 October 2018. SSJ is indexed with code ISSN (2309-3455, print & 2309-3471, online)

Founded in 1997, SSJ is certified as scientific journal by the High Commission of the Assessment of Academic Titles, with decision No. 170, 20. 12. 2010.

SSJ is also classified as Scientific Journal by ANVUR, the National Agency for the Evaluation of the University System and Scientific Research of Italy - Ministry of Education, Universities and Scientific Research of Italy (MIUR), by decision no. 298, dated 21 December 2021.

“Social Studies” is a bilingual Journal. The articles can be written either in English or Albanian.

How to submit an article?

The article can be submitted to: studime.sociale@gmail.com; albsa@sociology.al;
The submitted article will be select for publishing by the anonymous reviewers, though a blind review process.

Organize the manuscript in the following order:

Title, author(s), name(s) and institution(s), e-mail address(es), abstract (150-250 words), text, references (Harvard System of references), notes on contributor/s (a short CV of a maximum of 10 lines, including both academic and organizational experience, and listing up to three selected publications).

Short references in text

Weber (1998); (Weber, 1998: 156); or Weber (1998: 156); (Lazesfeld and Berelson, 1990); (Olzak, Shanahan & West, 1986); (Larsen et al., 1989); (Blau, 1980; Kadare, 1995; Uçi, 2003; Pëllumbi, 2004; Omari, 1999); 2011a, 2011b; (Tocqueville [1835] 2010), etc.

References following the text

List authors alphabetically, by surname.

Merton, Robert. [1949] 1968. *Social Theory and Social Structure*, New York: Free Press.

Buss, Loreta. 2010. “Childhood in Sociology and Society; the US Perspective”, *Currant Sociology*, Vol. 58, No. 2, pp. 355-350.

© Copyright: the author(s) of the articles

For more details, contact the Secretary of the International Editorial Board...

www.sociology.al

Kriteret e botimit në revistën “Studime Sociale” [Social Studies]

Revista “Studime Sociale” [Social Studies] është revistë e Institutit Shqiptar të Sociologjisë (Albanian Institute of Sociology, AIS - associated with ALBSA) dhe Departamentit të Sociologjisë (UAMD) bazuar në marrëveshjen e datës 8 tetor 2018.

Ajo është certifikuar si revistë shkencore nga KVTA/MAS me vendim Nr. 170, datë 20. 12. 2010. Ajo, gjithashtu, është klasifikuar si revistë shkencore nga ANVUR - Agjencia Kombëtare e Vlerësimit të Sistemit Universitar dhe Kërkimit Shkencor i Ministrisë së Arsimit, Universiteteve dhe Kërkimit Shkencor të Italisë (MIUR) me vendim Nr. 298, datë 21 dhjetor 2021.

Revista “Studime Sociale” [Social Studies] botohet pa ndërprerje nga viti 1998. Ajo drejtohet nga bordi botues ndërkombëtar dhe botohet me kod ISSN, në dy forma: ISSN 2309-3455 (print) dhe ISSN 2309-3471 (online).

Artikujt mund të botohen në shqip ose anglisht. Parimi bazë i botimit është rigoroziteti shkencor. Çdo studim që dërgohet për t’u botuar revistën “Studime sociale”, i nënshtrohet një recensionimi të verbër (blind review). Ai u jepet për recension studiuesve të fushave ku bën pjesë studimi dhe artikulli botohet nëse recensat janë pozitive. Pra, detyra e përzgjedhjes së artikujve shkencorë është kompetencë ekskluzive e recensentëve anonimë. Kostoja e revistës përballohet nga kontribuuesit sipas vëllimit të çdo artikulli. Nëse ndonjë numër, apo artikull i veçantë i revistës, financohen nga ndonjë subjekt (individ apo institucion) në çdo rast bëhet shënimi përkatës.

Çdo artikull duhet të jetë në përputhje me standardet gjuhësore. Artikujt mund të jenë shkencorë ose recensionues, krijime origjinale ose përkthime. Çdo artikull duhet të dërgohet në word dhe të ketë këtë strukturë:

- (1) titulli, deri në 15 fjalë;
- (2) autori/autorët (emri mbiemri); institucioni ku është/janë; adresat elektronike – për çdonjërin prej tyre;
- (3) të dhëna për autorin/autorët, 4-6 rreshta, si tekst;
- (4) përmbledhje (shqip), me 200-250 fjalë dhe 4-6 fjalë kyçe;
- (5) teksti, si rregull me 7-9 faqe kompjuterike, me nga 2200 karaktere;
- (6) Referencat e plota, sipas rendit alfabetik të mbiemrave të autorëve;
- (7) abstract në anglisht (varianti anglisht i përmbledhjes).

Artikulli mund të shoqërohet me shënime në fund të faqes (footnotes). Por përparësi në përzgjedhjen për botim kanë artikujt me referenca sipas sistemit të Harvardit (referenca të shkurtuara përgjatë tekstit dhe lista me referenca të plota në fund të tij, sipas rendit alfabetik të mbiemrave të autorëve).

Referencat duhet të përbëjnë pesë elemente, që janë:

a. Referencat e librave: 1. autori/ose autorët; 2. viti i botimit; 3. titulli i librit (në kursiv); 4. qyteti/vendi ku është botuar; 5. botuesi (për shembull: Merton, Robert. 1968. *Social Theory and Social Structure*. New York: Free Press).

b. Referencat e artikujve nga revistat shkencore, ose përmbledhjet: 1. autori/autorët; 2. viti i botimit; 3. titulli i artikullit (në thonjëza); 4. titulli i revistës/përmbledhjes ku është botuar (në kursiv); 5. vëllimi, numri dhe faqet (për shembull: Buss, Loreta. 2010. “Childhood in *Sociology and Society*; *The US Perspective*”, *Currant Sociology*, Vol. 58, No. 2, pp. 355-350).

Referencat e plota, të listuara në fund të tekstit, duhet të korrespondojnë me referencat e shkurtuara nëpër tekst, të cilat vendosen si në shembujt: Për një autor: Weber (1998); (Weber, 1998: 156); ose Weber (1998: 156); Për dy dhe tre autorë: (Lazesfeld & Berelson, 1990) e (Olzak, Shanahan & West, 1986); Për më shumë se tre autorë: (Larsen ed al., 1989); për seritë e referencave (Blau, 1980; Kadare, 1995; Uçi, 2003; Pëllumbi, 2004; Omari, 1999). Në qoftë se për të njëjtin autor ka më shumë se një referencë në të njëjtin vit, atëherë shënohet: 2011a, 2011b.